Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

6M2-2017

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 270 kopje
Shtypur nga Botimet IDEA sh.p.k.

P Ë R M B A J T J A

HYRJE 7

SQARIME 8

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2017 10

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR 17
1.1 Rreziku sistemik 20

2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE 22
2.1 Zhvillimet në tregjet financiare dhe të lëndëve të para 25
2.2 Zhvillimet në grupet bankare të huaja që operojnë në Shqipëri 26

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË VEND 30

4. POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE 32
4.1 Pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve 32
4.2 Tregu i pasurive të paluajtshme 41

5. TREGJET FINANCIARE 45
5.1 Tregu i letrave me vlerë 45
5.2 Tregu ndërbankar 47
5.3 Tregu i këmbimeve valutore 48

6. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE 49

7. SISTEMI FINANCIAR 51
7.1 Zhvillimet në sektorin jobankar 52
7.2 Vlerësimi i rreziqeve dhe ekspozimeve të sektorit jobankar 55

8. ZHVILLIMET NË SEKTORIN BANKAR 57
8.1 Ecuria e aktivitetit bankar 57
8.2 Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve 59
8.3 Zhvillimet në kreditim 60
8.4 Depozitat dhe rreziku i likuiditetit 70
8.5 Rreziqet e tregut dhe ai operacional 74
8.6 Rezultati financiar dhe eficienca e burimeve 79
8.7 Kapitalizimi i veprimtarisë 83

9. VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS 87
9.1 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve makroekonomike 87
9.2 Prova e rezistencës së likuiditetit 93

ANEKS 95

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1.1	*Përbërësit e Hartës së Stabilitetit Financiar*	*19*
Hapësirë informuese 4.1	*Rezultatet e vrojtimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve*	*35*
Hapësirë informuese 4.2	*Rezultatet e vrojtimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve*	*38*
Hapësirë informuese 4.2.1	*Vlerësimi i persistencës në planifikimin e huamarrjes*	*39*
Hapësirë informuese 4.3	*Përmbledhje e rezultateve të vrojtimit "Tregu i pasurive të paluajtshme" dhe ecuria e indeksit të çmimit të banesave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017*	*43*
Hapësirë informuese 8.3	*Përafrim mbi koston e kapitalit (CoE) në sektorin bankar shqiptar*	*82*
Hapësirë informuese 9.1	*Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut që lidhet me pronat e marra në pronësi në përfundim të procesit përkatës ligjor*	*90*
Hapësirë informuese 9.2	*Ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj lëvizjeve në normën e interesit*	*91*

PËRMBAJTJA E TABELAVE

2. Zhvillimet ndërkombëtare

Tabela 2.1	*Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën*	*24*
Tabela 2.2	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor*	*24*
Tabelë 2.3	*Zhvillimet në grupet e huaja bankare që operojnë në Shqipëri*	*27*

4. Pozicioni financiar dhe ekspozimi ndaj rreziqeve i individëve dhe bizneseve

Tabela 4.1.	*Aktivet e individëve rezidentë në sistemin financiar*	*33*

7. Sistemi financiar

Tabelë 7.1	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite*	*51*

8. Zhvillimet në sektorin bankar

Tabelë 8.1	*Struktura e bilancit të bankave, dhjetor 2017*	*58*
Tabelë 8.2	*Ecuria e kredisë*	*61*
Tabelë 8.3	*Tregues kryesorë të depozitave në sektorin bankar*	*70*

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

1. Vlerësimi i përgjithshëm i rreziqeve kryesore të stabilitetit financiar

Grafik 1.1	Harta e stabilitetit financiar	18
Grafik 1.2	Akumulimi dhe materializimi i rrezikut sistemik	20
Grafik 1.3	Indeksi i Stresit Financiar	20
Grafik 1.4	Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike	21

2. Zhvillimet ndërkombëtare

Grafik 2.1	Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve	25
Grafik 2.2	Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera	25
Grafik 2.3	Ekspozimi i grupeve bankare ndaj rajonit EQLJ	28
Grafik 2.4	Strategjitë afatgjata (mbi 12 muaj) ndaj rajonit EQLJ	28
Grafik 2.5.	Potenciali i tregut në 6MII-2017 (peshat e përgjigjeve, në %)	29
Grafik 2.6.	Pozicionimi i bankave në treg (peshat e përgjigjeve, në %)	29
Grafik 2.7	Potenciali i tregut shqiptar në 2 vitet e fundit	29
Grafik 2.8	Pozicionimi i grupeve bankare në tregun shqiptar	29

4. Pozicioni financiar dhe ekspozimi ndaj rreziqeve i individëve dhe bizneseve

Grafik 4.1	Pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve, në miliardë lekë	33
Grafik 4.2	Struktura e kredisë për individë sipas afatit të maturimit dhe monedhës	34
Grafik 4.3	Ndryshimi vjetor i Raportit të Kredive me Probleme për individët, pikë përqindje	34
Grafik 4.4	Struktura e kredisë për bizneset sipas afatit të maturimit dhe monedhës	36
Grafik 4.5	Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë	37
Grafik 4.6	Ndryshimi vjetor i Raportit të Kredive me Probleme për bizneset, në pikë përqindje	37
Grafik 4.7	Indeksi i persistencës në planifikimin e huamarrjes së ndërmarrjeve	40
Grafik 4.8	Indeksi Theil	40
Grafik 4.9	Kredia për blerje të pasurisë së paluajtshme dhe kosto e pagesës së kredisë	42
Grafik 4.10	Raporti i kredive me probleme	42

5. Tregjet Financiare

Grafik 5.1	Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë (në %)	45
Grafik 5.2	Përbërja e borxhit të emetuar gjatë 2015-6M II-2017	45
Grafik 5.3	Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për 6M II-2017	46
Grafik 5.4	Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për 6M II-2017	46
Grafik 5.5	Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e bonove të thesarit në tregun primar	47
Grafik 5.6	Vëllimi dhe norma mesatare e obligacioneve në tregun primar	47
Grafik 5.7	Huamarrja e brendshme në euro	47
Grafik 5.8	Normat e interesit në tregun ndërbankar	48
Grafik 5.9	Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor	48

6. Zhvillimet në sistemet e pagesave

Grafik 6.1	Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH për gjashtëmujorin e dytë 2017	49
Grafik 6.2	Ecuria e instrumenteve të pagesave në sasi dhe në vlerë	49

7. Sistemi Financiar

Grafik 7.2	Rritja vjetore e aktiveve të segmenteve përbërëse të sistemit financiar	51
Grafik 7.3	Struktura e IFJB-ve sipas llojit të aktivitetit që kryejnë	52
Grafik 7.4	Struktura e aktivit të IFJB-ve	52
Grafik 7.5	Struktura e aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit	53
Grafik 7.6	Struktura e aktiveve të shoqërive të sigurimit	53
Grafik 7.7	Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve	54
Grafik 7.8	Struktura e investimeve të fondeve të pensioneve private suplementare	54
Grafik 7.9	Ekspozimi i institucioneve kryesore jobankare ndaj sektorit bankar, në raport me totalin e aktiveve të tyre	55
Grafik 7.10	Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në titujt e qeverisë, ndaj totalit të aktiveve të tyre	55

8. Zhvillimet në sektorin bankar

Grafik 8.1	Treguesi Herfindahl për produktet kryesore bankare	59
Grafik 8.2	Kontributi i zërave në rritjen vjetore të aktiveve me jorezidentët (në pp)	60

Grafik 8.3	*Përbërësit e detyrimeve jorezidente*	*60*
Grafik 8.4	*Ecuria e kredisë sipas afatit, rritje vjetore*	*61*
Grafik 8.5	*Ecuria e kredisë sipas monedhës, rritje vjetore*	*61*
Grafik 8.6	*Ecuria e kredisë sipas qëllimit të përdorimit, rritje vjetore dhe ndryshimi mujor i stokut*	*63*
Grafik 8.7	*Ecuria e kredisë për jorezidentët*	*63*
Grafik 8.8	*Kredia e re sipas qëllimit të përdorimit*	*64*
Grafik 8.9	*Shpërndarja e kredisë së re sipas afatit të maturimit dhe monedhës*	*65*
Grafik 8.10	*Raporti i kredive me probleme*	*65*
Grafik 8.11	*Kontributi në ndryshimin gjashtëmujor të stokut të kredive me probleme (mld lekë)*	*65*
Grafik 8.12	*Struktura e kredive me probleme*	*66*
Grafik 8.13	*Portofoli i kredive me probleme sipas grupeve bankare*	*66*
Grafik 8.14	*Huatë me probleme në sektorin bankar shqiptar*	*67*
Grafik 8.15	*Ecuria e treguesve të cilësisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*	*67*
Grafik 8.16	*Ecuria e cilësisë së kredisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, sipas qëllimit të përdorimit (majtas) dhe ecuria e kredive me probleme për subjektet jorezidente (djathtas)*	*68*
Grafik 8.17	*Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit*	*69*
Grafik 8.18	*Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme sipas llojit të kolateraleve*	*69*
Grafik 8.19	*Kontributi në ecurinë e depozitave dhe rritje vjetore*	*71*
Grafik 8.20	*Ecuria e depozitave sipas llojit dhe rritja vjetore*	*71*
Grafik 8.21	*Përbërja e depozitave të reja me afat sipas monedhës dhe afatit të maturimit, flukset gjashtëmujore*	*72*
Grafik 8.22	*Tregues të likuiditetit*	*73*
Grafik 8.23	*Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve*	*73*
Grafik 8.24	*Maturimi mesatar i mbetur*	*74*
Grafik 8.25	*Pozicioni i hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë*	*74*
Grafik 8.26	*Mospërputhja valutore sipas përbërësve*	*75*
Grafik 8.27	*Mospërputhja valutore sipas monedhave*	*75*
Grafik 8.28	*Mospërputhja valutore sipas grupeve dhe monedhave*	*76*
Grafik 8.29	*Mospërputhja valutore, sipas grupeve*	*76*
Grafik 8.30	*Rreziku i riçmimit për normat fikse (FIR) dhe variabël (VIR) të interesit, në % ndaj kapitalit rregullator*	*77*
Grafik 8.31	*Hendeku sipas maturitetit, në % ndaj kapitalit rregullator*	*77*
Grafik 8.32	*Pozicioni neto i peshuar ndaj kapitalit rregullator sipas monedhave dhe madhësisë së bankave*	*77*
Grafik 8.33	*Pozicioni neto i ponderuar sipas madhësisë së bankave*	*78*
Grafik 8.34	*Aktive të peshuara me rrezik /totali i aktiveve (%)*	*78*
Grafik 8.35	*Afati mesatar i maturimit të mbetur të aktiveve dhe detyrimeve të sektorit bankar (në muaj)*	*78*
Grafik 8.36	*Përbërësit e rezultatit financiar*	*80*
Grafik 8.37	*ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit*	*80*
Grafik 8.38	*Marzhi neto nga interesi*	*81*
Grafik 8.39	*Treguesit e përfitueshmërisë*	*81*
Grafik 8.40	*Shpenzimet ndaj të ardhurave të veprimtarisë*	*81*
Grafik 8.41	*Ecuria e kthimit nga kapitali RoE e sektorit bankar kundrejt kostos së kapitalit CoE, para dhe pas krize*	*82*
Grafik 8.42	*Euria e kthimit nga kapitali RoE në nivel banke kundrejt kostos së kapitalit CoE, para dhe pas krize*	*83*
Grafik 8.43	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit*	*84*
Grafik 8.44	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas madhësisë dhe origjinës së kapitalit*	*84*
Grafik 8.45	*Shpërndarja e aktiveve të sektorit sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit*	*84*
Grafik 8.46	*Koeficientët e ponderimit dhe madhësia e klasave kryesore të portofolit të kredisë*	*85*
Grafik 8.47	*Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas madhësisë së aktivitetit dhe origjinës në kapitalit, dhjetor 2017*	*85*
Grafik 8.48	*Treguesi i levës financiare, në herë*	*85*

9. Vlerësim i qëndrueshmërisë së sektorit bankar sipas ushtrimit të provës së rezistencës

Grafik 9.1	*Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës*	*88*
Grafik 9.2	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve të provës së rezistencës*	*89*
Grafik 9.3	*Ecuria e zërit në aktiv të sektorit bankar që lidhet me pronat e përftuara me proces ligjor*	*90*
Grafik 9.4	*Pronë e përftuar me proces ligjor ndaj totalit të aktiveve (majtas) dhe ndaj kapitalit rregullator (djathtas)*	*91*
Grafik 9.5	*Vlerësimi i të ardhurave neto nga interesi për sektorin bankar, sipas skenarëve*	*92*

HYRJE

Ky është numri i 19-të i Raportit të Stabilitetit Financiar, një dokument i Bankës së Shqipërisë që publikohet dy herë në vit. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Në hyrje të dokumentit është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, e cila, sipas kërkesës së ligjit, duhet të publikohet çdo gjashtë muaj.

Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar të dhënat që disponohen në Bankën e Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar informacione dhe analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Të dhënat dhe analizat e paraqitura përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2017 (më tej, "periudha"). Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë kohe deri në 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga vetë veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e vendeve të zhvilluara e ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punësimit, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimeve specifike, është vlerësuar gjendja financiare e bizneseve dhe e individëve, si edhe ndikimi mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

Në raport janë përfshirë, në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës, i cili ka përfshirë edhe skenarë të stresit të likuiditetit.

SQARIME

Në fund të muajit dhjetor të vitit 2017, sektori bankar shqiptar ndahet si vijon.

(1) Sipas madhësisë së aktivitetit, bankat e sektorit bankar shqiptar grupohen në:

- banka të Grupit 1, ku secila zotëron 0-2% të totalit të aktiveve të sektorit: Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. (BBSH), Veneto Banka sh.a. (VB), Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a. (BNT), Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. (BPI), Banka e Kredititi të Shqipërisë sh.a. (BKSH). Këto banka përbëjnë rreth 4.9% të totalit të aktiveve të sektorit;
- banka të Grupit 2, ku secila zotëron 2-7% të totalit të aktiveve të sektorit: Banka Procredit sh.a. (BPC), Banka NBG Albania sh.a. (NBG), Banka Société Générale Albania sh.a. (BSG), Banka Alpha Albania sh.a. (BA), Banka Union sh.a. (BU), Banka Tirana sh.a. (BT), Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (BAI). Këto banka përbëjnë rreth 26.9% të totalit të aktiveve të sektorit;
- banka të Grupit 3, ku secila zotëron mbi 7% të totalit të aktiveve të sektorit: Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (BKT), Banka Raiffeisen sh.a. (BR), Banka Credins sh.a. (BC), Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. (BISP). Këto banka përbëjnë rreth 68.2% të totalit të aktiveve të sektorit.

(2) Sipas origjinës së kapitalit, bankat e sektorit bankar shqiptar grupohen në:

- me kapital të huaj[1]: Banka Raiffeisen sh.a. (Austri); Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. – Shqipëri, Veneto Banka sh.a. (Italì); Banka Alpha Albania sh.a., Banka Tirana sh.a., Banka NBG Albania sh.a. (Greqi); Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (Turqi); Banka Société Générale Albania sh.a. (Francë); Banka Procredit sh.a. (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. (Bullgari); Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a. (Malajzi); Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. (Banka Islamike e Zhvillimit - Arabia Saudite); Banka e Kredititi të Shqipërisë sh.a. (Kuvajt). Këto banka përbëjnë rreth 81.4% të totalit të aktiveve të sektorit;

- me kapital shqiptar: Banka Credins sh.a., Banka Union sh.a, Banka Amerikane e Investimeve sh.a. Këto banka përbëjnë rreth 18.6% të totalit të aktiveve të sektorit.

[1] *Sipas origjinës së kapitalit, kur kapitali i huaj përbën më shumë së 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.*

(3) Sipas shtrirjes së aktivitetit jashtë vendit:

Shtrirje të rrjetit të degëve jashtë vendit paraqet vetëm Banka Kombëtare Tregtare, me degën e saj në Kosovë.

(4) Në këtë raport, termat "hua" dhe "kredi" kanë të njëjtin kuptim dhe mund të përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit; në të njëjtën mënyrë përdoren edhe termat "ndërmarrje" dhe "biznese".

(5) Në këtë raport, teprica e kredisë i referohet gjendjes së llogarisë "marrëdhënie me klientët", siç është raportuar nga bankat në bilancet e periudhave që analizohen. Ajo përfshin tepricën e kredisë së dhënë nga sektori bankar për subjektet jofinanciare, private dhe publike, rezidente dhe jorezidente. Kjo tepricë ndikohet nga largimi i kredive me probleme nga bilanci i bankës gjatë periudhës raportuese. Si rezultat, teprica e kredisë në këtë raport është një koncept i ndryshëm nga ai i kredisë për ekonominë. Tek kjo e fundit, krahas kredisë së dhënë nga bankat, përfshihet edhe kredia e dhënë nga institucionet financiare jobankare. Gjithashtu, në vlerën e kësaj kredie përfshihet vetëm sektori privat rezident dhe vlera e saj nuk ndikohet nga fshirjet e kredive me probleme nga bilancet e bankave (këto kredi janë përfituar tashmë nga subjektet ekonomike dhe kanë ndikuar në vlerën ekonomike të tyre; fshirja e tyre e mëvonshme nga bilancet e bankave nuk e ndikon këtë fakt). Dallimi në këto koncepte të kredisë duhet pasur parasysh edhe kur bëhet interpretimi i analizës përkatëse të treguesve të kredisë (normë rritjeje, raporte të cilësisë, shpërndarje sipas sektorëve, sipas monedhës etj.) në raportet e ndryshme të Bankës së Shqipërisë.

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2017

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Në raportin e stabilitetit financiar dhe në këtë deklaratë që e paraprin, vlerësohet ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve që burojnë prej ndërveprimit të tij me zhvillimet ekonomike, të jashtme dhe të brendshme, me agjentët e ekonomisë reale, me tregjet financiare në vend, si edhe ndaj rreziqeve që lidhen me mënyrën se si sektori bankar zhvillon veprimtarinë e tij. Në vijim, këto rreziqe përballen me gjendjen financiare të sektorit bankar dhe stresohen nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Banka e Shqipërisë vlerëson se zhvillimet në ekonominë reale dhe tregjet financiare gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2017 (më tej, 'periudha'), mbështetën zgjerimin e veprimtarisë së sistemit financiar në vend. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të veprimtarisë ishte më i kufizuar, ku evidentohet përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë së portofolit të kredisë në të gjithë elementet përbërëse. Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera është në nivele të administrueshme, por ka nevojë të vlerësohet në mënyrë të kujdesshme në vijimësi. Si rezultat, mundësitë e sektorit bankar për të zgjeruar më tej ndërmjetësimin financiar dhe përmirësuar treguesit e eficiencës së veprimtarisë, janë përmirësuar. Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet e veprimtarisë, në kushtet e niveleve të larta të likuiditetit, kapitalizimit dhe përfitueshmërisë, mbetet e plotë. Në vijim të këtyre zhvillimeve, Banka e Shqipërisë vlerëson se sektori bankar mbetet i qëndrueshëm.

Zhvillimet në mjedisin ekonomik dhe financiar

Gjatë periudhës, zhvillimet në *ekonominë botërore* kanë qenë pozitive dhe të qëndrueshme. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik ka qenë me bazë të gjerë dhe i harmonizuar mes rajoneve. Rritja është mbështetur nga kushtet e favorshme të financimit dhe vijimi i politikave stimuluese, ndërsa rikuperimi i çmimeve

të naftës ka ndihmuar rigjallërimin ekonomik të vendeve eksportuese. Kushtet në tregjet financiare kanë qenë të favorshme, pavarësisht divergjencave në politikat monetare të bankave kryesore qendrore. *Presionet inflacioniste* në nivel botëror kanë qenë përgjithësisht të ndrydhura, por kanë shfaqur herë pas here prirje rritëse, mbështetur edhe nga rikuperimi i çmimeve të naftës. Në tregjet financiare, titujt e kapitalit kanë vijuar të rriten, ndërsa ecuria e titujve të borxhit ka qenë më e luhatshme. Edhe në rajonin e Ballkanit, është vënë re një rritje më e shpejtë ekonomike dhe përmirësim i treguesve të papunësisë. Kreditimi mbetet përgjithësisht i ulët, ndonëse është shënuar përparim i dukshëm në drejtim të uljes së nivelit të kredive me probleme. Kushtet monetare lehtësuese dhe investimet kryesisht private, pritet të mbështesin rritjen ekonomike botërore edhe gjatë vitit 2018. Rreziqet kryesore për rritjen ekonomike në nivel global, vijnë nga tensionet gjeopolitike, mundësitë e zbatimit të politikave mbrojtëse në marrëdhëniet tregtare veçanërisht në ekonomitë e zhvilluara, si edhe mundësia që tregjet të përballen me korrektime të shpejta e të papritura.

Në *ekonominë e vendit,* ritmi i rritjes ruajti nivele të mira gjatë vitit 2017. Në fund të tremujorit të katërt, norma vjetore e rritjes ekonomike shënoi vlerën 3.36%, me kontribut pozitiv nga degët e sektorëve të shërbimeve dhe prodhimit. Kërkesa agregate vijoi të mbështetet në zgjerimin e konsumit final të popullatës dhe në formimin e kapitalit fiks. Në tremujorin e fundit të vitit, kontributi pozitiv në rritjen ekonomike nga ngushtimi i deficitit të llogarisë gjatë tre tremujorëve të mëparshëm, u ndërpre. Në tregun e punës, norma e papunësisë zbriti më tej, në nivelin 13.4%. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë mbeti akomoduese gjatë gjithë periudhës në kushtet kur presionet inflacioniste mbetën të moderuara. Ndonëse në vlerë absolute, deficiti buxhetor për 2017 rezultoi më i lartë se një vit më parë, pesha e borxhit publik ndaj prodhimit të brendshëm bruto (PBB) ka rënë. Në *tregjet financiare*, normat e interesit reflektuan përgjithësisht gjendjen e qëndrueshme të likuiditetit. Në tregun primar të titujve të borxhit të qeverisë, norma mesatare e interesit tregoi ndryshime të vogla gjatë periudhës, por e përfundoi atë në nivele disi më të larta se një vit më parë, me kontributin kryesor nga ecuria e normës mesatare të interesit për bonot e thesarit. Megjithë rritjen e vëllimeve në tregun ndërbankar, norma mesatare e interesit qëndroi pranë nivelit të normës bazë të politikës monetare. Në tregun e pasurive të paluajtshme, vrojtimet tregojnë se vlerësimet e pjesëmarrësve të tregut janë më optimiste. Norma mesatare e interesit për kredinë për pasuri të paluajtshme ka shënuar një rënie të lehtë. Gjatë periudhës, në tregun e këmbimit të monedhave, u vu re një mbiçmim i Lekut ndaj Dollarit amerikan dhe një nënçmim i lehtë i tij ndaj Euros.

Gjendja e likuiditetit të *individëve dhe ndërmarrjeve* (bizneseve) u përmirësua gjatë periudhës. Pozicioni neto kreditor i individëve është rritur në kushtet e rritjes më të shpejtë të depozitave në valutë, ndërsa pozicioni neto debitor i ndërmarrjeve është ulur, për shkak të rritjes më të shpejtë të depozitave në Lek. Në terma vjetorë, ndryshe nga prirja gjashtëmujore, individët shfaqin një ngushtim të lehtë të pozicionit kreditor me kontribut nga pozicioni kreditor në monedhën vendase. Ndërsa, ndërmarrjet regjistrojnë sërish ngushtim të

pozicionit debitor, në sajë edhe të rënies së kredisë në monedhë të huaj. Tek individët, rritja e kredisë gjatë periudhës është realizuar pothuaj vetëm në Lek dhe cilësia e kredisë është përmirësuar në të dyja monedhat. Raporti i kredive me probleme për individët ka zbritur me 2.6 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit të kaluar, duke shënuar nivelin 7.6% në fund të vitit 2017. Për ndërmarrjet, portofoli i kredisë ka shënuar një rënie të lehtë vjetore, e diktuar nga largimet e kredive të humbura nga bilancet e bankave, kryesisht në valutë. Si rezultat, në strukturën e stokut të kredisë për ndërmarrjet, pesha e kredisë në monedhën vendase është rritur. Edhe për ndërmarrjet, cilësia e kredisë është përmirësuar ndjeshëm gjatë periudhës. Raporti i kredive me probleme për ndërmarrjet, zbriti në nivelin 16.9% në fund të vitit, rreth 6 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Për të vlerësuar në mënyrë më të plotë gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve dhe të ndërmarrjeve, Banka e Shqipërisë kryen dy vrojtime të posaçme me frekuencë gjashtëmujore, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave. Për periudhën, përgjigjet e ndërmarrjeve të mëdha e të mesme tregojnë për një përmirësim të aksesit të tyre në financim, ndërsa për ndërmarrjet e vogla ky vijon të jetë një proces më i vështirë. Në përgjithësi, si ndërmarrjet ashtu edhe familjet tregojnë se kanë aktualisht një oreks të ulët për të marrë borxh.

Veprimtaria e *sistemit financiar* është zgjeruar gjatë periudhës. Raporti i aktiveve të sistemit financiar ndaj PBB-së vlerësohet të jetë ngjitur në 102.6%, duke qenë rreth 0.5 pikë përqindje më i lartë se në qershor të 2017-ës, por më i ulët në krahasim me një vit më parë. Rritja e peshës së sistemit financiar ndaj PBB-së ka ardhur si pasojë e zgjerimit të aktivitetit të pothuaj të gjitha segmenteve përbërëse, duke përfshirë: bankat; institucionet financiare jobanka; shoqëritë e sigurimit; dhe fondet e investimeve. Struktura e aktiveve të sistemit financiar mbizotërohet nga bankat, aktivet e të cilave zënë rreth 93% të aktiveve të sistemit. Gjatë periudhës, pesha e sektorit bankar u ngjit në 92.5% të PBB-së. Në zgjerimin e veprimtarisë së sektorit bankar ndikoi kryesisht zgjerimi i veprimeve ndërbankare. Në terma të treguesve të shëndetit financiar, sektori bankar u karakterizua nga nivele më të larta kapitalizimi, përfitueshmërie dhe likuiditeti. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar vlerësohet i ulët, ndërkohë që, performanca e sektorit bankar mbetet me rëndësi kritike për aktivitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit jobankar. Në strukturën e aktiveve të sektorit jobankar, investimet në titujt e borxhit të qeverisë zënë një peshë të konsiderueshme dhe kanë ardhur në rritje gjatë vitit 2017.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të veprimtarisë

Në lidhje me rreziqet e veprimtarisë me të cilat përballet sektori bankar, Banka e Shqipërisë vlerëson si më poshtë.

a) *Përmirësimi i cilësisë së kredisë gjatë periudhës ka ulur rrezikun e kreditit.* Në fund të vitit 2017, kreditë me probleme treguan një rënie vjetore prej 27.5% ose 30.2 miliardë lekësh. Si rezultat, raporti i kredive me

probleme zbriti me 5.1 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë, duke shënuar nivelin 13.2%. Në uljen e kredive me probleme, kontributi i veprimeve të bankave që lidhen me arkëtimin dhe ristrukturimin e kredive, ka qenë më i lartë në krahasim me kontributin e dhënë nga largimi i këtyre kredive nga bilancet e bankave. Ulja e kredive me probleme është shfaqur në të gjitha kategoritë përbërëse, duke përfshirë edhe kredinë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet në kursin e këmbimit. Në kreditë ekzistuese me probleme, cilësia më e dobët shfaqet në kredinë në valutë dhe kredinë për ndërmarrjet. Pakësimi i kredive me probleme është shoqëruar me përmirësimin e masës së mbulimit të tyre me kapital, ndërsa mbulimi me provigjione dhe kolateral ka shfaqur ndryshime të papërfillshme.

Rritja e kontributit të veprimeve që lidhen me ristrukturimin, ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e prirjes rënëse të kredive me probleme përgjatë kohës. Në veprimtarinë e saj mbikëqyrëse, Banka e Shqipërisë do të nxisë bankat ta zhvillojnë këtë proces në mënyrë sa më efektive, që nga ky proces të përfitojnë vetëm subjektet që kanë projekte të vlefshme financiare dhe përqendrimi i kredive me probleme të përshpejtojë rënien. Në kuadër të kredisë së re, është e nevojshme që bankat të ndjekin me vëmendje rritjen e ekspozimit në sektorë të caktuar, për të siguruar plotësimin e kërkesave rregullative për standarde të shëndosha të kredidhënies dhe diversifikim sa më të mirë të portofolit të kredive.

b) *Rreziku i likuiditetit në veprimtarinë bankare mbetet i ulët.* Raportet e aktiveve likuide, në Lek dhe valutë, ndaj detyrimeve afatshkurtra, janë ndjeshëm mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullator. Burimi kryesor i financimit të veprimtarisë së bankave mbeten depozitat, të cilat mbulojnë gati dy herë vëllimin e kredive të sektorit.

Në strukturën e burimeve të financimit të sektorit bankar, vijon rritja e depozitave pa afat dhe e llogarive rrjedhëse, kundrejt rënies së depozitave me afat. Sidoqoftë, rreziku i kësaj strukture financimi paraqitet i kufizuar në kushtet kur depozitat e sektorit bankar mbizotërohen nga kursimet e individëve duke qenë të mirëshpërndara, depozitat me afat ruajnë peshën kryesore në strukturën e depozitave të sektorit bankar dhe ritmi i rënies së tyre në vitet e fundit është ngadalësuar ndjeshëm. Në depozitat me afat, vlera e atyre me maturim mbi dy vjet vijon të rritet. Por, struktura aktuale e burimeve të financimit kufizon aftësinë e sektorit bankar për të financuar projektet afatgjata, të cilat lidhen kryesisht me investimet e familjeve dhe ndërmarrjeve, duke ndikuar negativisht në eficiencën e veprimtarisë së tij.

c) *Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut, ndonëse ka ardhur në rënie gjatë periudhës, mbetet i rëndësishëm.* Rreziku i drejtpërdrejt i kursit të këmbimit, mbetet i kufizuar, në kushtet kur lëvizjet në pozicionet e hapura valutore në bilancet e bankave kanë treguar luhatshmëri të

ulët ndaj sjelljes së tyre afatgjatë. Rreziku i tërthortë i kursit të këmbimit, shfaq një rënie të lehtë në kushtet e uljes së vlerës së kredisë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme në kursin e këmbimit. Në fund të periudhës, kjo kredi zbriti në 24.6% të totalit të kredisë dhe vijon të mbizotërohet nga kredia për ndërmarrjet. Kjo rënie është inkurajuese dhe pritet të ndikohet më tej pozitivisht nga një ndërgjegjësim më i mirë i publikut dhe bankave, në vijim edhe të masave të miratuara nga Banka e Shqipërisë më 7 shkurt 2018, në kuadër të procesit të de-euroizimit.

Në lidhje me ndikimin e lëvizjeve në normën e interesit, sektori bankar mbetet i ekspozuar ndaj luhatjeve të normës së interesit. Sidoqoftë të dhënat e fundit të periudhës tregojnë se ky ekspozim paraqitet relativisht më i kufizuar. Në mjedisin aktual me norma të ulëta të interesit, të dhënat për ecurinë e aktiveve me rrezik dhe për afatet mesatare të maturimit të aktiveve, tregojnë se përgjithësisht sektori bankar nuk ka shfaqur rritje të preferencës për investime me tipare më të larta të rrezikut në dy vitet e fundit. Nga këndvështrimi i administrimit të rreziqeve, kjo sjellje është pozitive. Megjithatë, ajo është e diktuar në një masë të konsiderueshme nga ngadalësimi i ndjeshëm i kreditimit, duke sugjeruar nevojën që analiza e rreziqeve të shtrihet për një afat më të gjatë dhe të përfshijë ndikimin e kësaj sjelljeje në eficiencën e veprimtarisë.

d) *Potenciali i zhvillimit të tregut bankar në vend ka nevojë të zgjerohet.* Ky është një proces me rëndësi, në mënyrë që sektori bankar të mbetet tërheqës për investitorë strategjikë institucionalë dhe që kontributi i tij në zhvillimin ekonomik të vendit të përmirësohet në afat të gjatë. Vlerësimi i bankave që operojnë në treg për potencialet e tregut bankar vendas, mund të perceptohet nga rezultatet e vrojtimit që kryen rregullisht Banka Evropiane e Investimeve me grupet bankare evropiane që operojnë në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Për rajonin, grupet bankare evropiane shprehen më optimiste për zgjerim të ekspozimit të tyre në rajon, gjatë vitit 2018. Duke u përqendruar tek Shqipëria, grupet bankare që operojnë në vend e konsiderojnë potencialin e tregut në drejtim të performancës financiare si mesatar. Gjithashtu, shumica dërrmuese e tyre vlerësojnë se pozicionimi i tyre në treg është i kënaqshëm ose optimal. Vlerësimi i mirë për pozicionimin në treg dhe pritjet mesatare që kanë në drejtim të performancës së tregut shqiptar, sugjerojnë një gatishmëri të moderuar të tyre për t'u angazhuar në veprime që mbështesin zgjerimin e veprimtarisë përmes blerjes së bankave të tjera në vend. Megjithatë, vlerësimi i tyre për tregun shqiptar, në krahasim me një vit më parë, është përmirësuar. Arsye për këtë mund të jenë përmirësimet në rritjen ekonomike dhe stabiliteti makroekonomik, si edhe përmirësimi i cilësisë së kredisë së sektorit bankar, në kushtet e veprimeve aktive të autoriteteve publike dhe të industrisë bankare për këtë qëllim. Si rezultat, treguesit e performancës financiare të sektorit bankar janë përmirësuar. Është e kuptueshme që

tregu shqiptar do të bëhet edhe më tërheqës për bankat evropiane nëse këto procese vijojnë me ritmin e duhur. Me rëndësi në këtë rast mund të jetë edhe përshpejtimi i procesit të adoptimit të standardeve evropiane, në kuadër të veprimtarisë bankare dhe financiare në përgjithësi, duke përmirësuar konkurrueshmërinë e tregut shqiptar për bankat e huaja. Në këtë drejtim, miratimi i ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë" në fund të vitit 2016, përfaqësoi një kontribut konkret. Më tej, Banka e Shqipërisë është duke punuar edhe në drejtim të adoptimit të disa elementeve të rëndësishme që përmban standardi i Bazel III për procesin mbikëqyrës, për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe të rrezikut sistemik.

Rreziqet për stabilitetin financiar

Për vlerësimin e rreziqeve sistemike është analizuar ecuria e treguesve që lidhen me materializimin dhe me akumulimin e rrezikut sistemik, me nivelin e stresit në sistemin financiar dhe me perceptimin e industrisë bankare lidhur me ekspozimin e veprimtarisë bankare ndaj rrezikut sistemik. Gjithashtu, harta e stabilitetit financiar synon të realizojë një qasje të konsoliduar të vlerësimit për rreziqet ndaj stabilitetit financiar.

Harta e stabilitetit financiar, indekset e materializimit dhe akumulimit të rrezikut sistemik, si dhe indeksi i stresit financiar, përgjithësisht tregojnë rreziqe më të kontrolluara për stabilitetin financiar. Kontribut pozitiv në këtë drejtim kanë dhënë: rritja ekonomike; ulja e normës së papunësisë; ulja e raportit të borxhit publik; luhatshmëria e ulët e kursit të këmbimit; dhe përmirësimi i disa treguesve të sektorit bankar që lidhen kryesisht me rezultatin financiar dhe përmirësimin e cilësisë së aktiveve. Nga ana tjetër, kontribut negativ kanë dhënë rritja e vlerës së deficitit buxhetor në fund të vitit dhe ngadalësimi i rritjes së depozitave në sektorin bankar. Përgjigjet e bankave në vrojtimin përkatës, tregojnë se ato perceptuan nivele më të ulëta të rreziqeve sistemike gjatë periudhës, dhe pritshmëritë janë përgjithësisht pozitive.

Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet

Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet vlerësohet duke analizuar gjendjen e tij të kapitalizimit dhe të përfitueshmërisë, si edhe duke provuar përshtatshmërinë e këtyre treguesve në skenarë stresi, nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës.

Në fund të periudhës, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar shënoi nivelin 16.6%, duke qenë 0.6 pikë përqindje më i lartë se niveli i fundit të vitit 2016, dhe dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar për këtë tregues prej 12%. Përmirësimi në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit është diktuar nga rritja më e lartë e vlerës së kapitalit rregullator, në krahasim me

rritjen e aktiveve të peshuara me rrezik të sektorit bankar. Rezultati financiar i sektorit u përmirësua gjatë periudhës. Treguesit e rentabilitetit të sektorit - kthimi mbi aktivet (RoA) dhe kthimi mbi kapitalin (RoE) - rezultuan përkatësisht 1.6% dhe 15.7%, duke qenë përkatësisht 0.9 pikë përqindje dhe 8.9 pikë përqindje më të lartë se një vit më parë. Në performancën financiare të sektorit evidentohet që ndikimin pozitiv e ka dhënë rënia e shpenzimeve për provigjione lidhur me rrezikun e kredisë, duke ritheksuar ndjeshmërinë e sektorit bankar ndaj vijueshmërisë së këtij procesi. Ndërkohë, rezultati financiar nga veprimtaria kryesore e ndërmjetësimit financiar, në formën e të ardhurave neto nga interesat, ka vijuar të bjerë. Rënia e të ardhurave neto nga interesat ka reflektuar rënien e normave të kthimit nga investimet, me ritme më të shpejta se rënia e shpenzimeve përkatëse, në kushtet e operimit për një kohë relativisht të gjatë në një mjedis me norma të ulëta interesi. Pavarësisht rënies me 0.3 pikë përqindje në terma vjetorë, gjatë periudhës, bankat ruajtën treguesin e marzhit neto nga interesat rreth nivelit 3.9%.

Përshtatshmëria e treguesve të mësipërm është verifikuar gjatë ushtrimit të provës së rezistencës, me skenarë që supozonin ndryshime të pafavorshme në treguesit makroekonomikë dhe financiarë për periudhën 2018-2019. Si edhe më parë, pjesë e supozimeve ekstreme, por me një probabilitet të ulët ndodhjeje, në skenarin e rënduar përfshiheshin: tkurrja e ekonomisë; tkurrja e kredisë; rritja e shpejtë e normave mesatare të interesit; dhe nënçmimi i fortë i kursit të këmbimit. Krahas ushtrimit të provës së rezistencës me skenarë makroekonomikë, u kryen edhe disa ushtrime të tjera. Më konkretisht, treguesit e performancës së sektorit bankar u testuan në drejtim të luhatshmërisë së vlerës së pasurive të paluajtshme që bankat kanë marrë në bilancet e tyre, në vijim të zgjidhjes së kredive me probleme dhe të luhatshmërisë së normave të interesit. Gjithashtu, në nëntor 2017, bankat ofruan të dhëna që ishin të nevojshme për realizimin e ushtrimit të provës së rezistencës për rrezikun e likuiditetit.

Në përgjithësi, rezultatet e testeve të mësipërme tregojnë se sektori bankar mbetet i kapitalizuar dhe me performancë të mirë, në skenarët që përmbajnë supozime më pranë realitetit. Gjendja e likuiditetit të sektorit bankar konfirmohet e mirë. Në skenarët më ekstremë, banka të veçanta dhe sektori bankar do të kishin nevojë për rritje të kapitalit.

Mbështetur në këtë analizë, Banka e Shqipërisë vlerëson se gjendja e kapitalizimit dhe e përfitueshmërisë së bankave paraqitet aktualisht e përshtatshme për të përballuar rreziqet e veprimtarisë. Si edhe më parë, nevojitet që bankat të analizojnë dhe testojnë aftësinë e tyre për të përballuar rreziqet e ndryshme, në mënyrë të rregullt, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ mbikëqyrës.

Në vijim, gjeni të detajuar përmbajtjen e raportit të stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017.

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR

Në hyrje të këtij raporti është vendosur "Harta e Stabilitetit Financiar", e cila tregon shpërndarjen e rrezikut tek faktorët që ndikojnë stabilitetin e sistemit financiar. Këta faktorë përfshijnë mjedisin ekonomik rrethues, të brendshëm e të jashtëm, sektorin bankar, si dhe agjentët e ekonomisë reale: qeverinë, bizneset dhe individët.

(1) Për fundin e vitit 2017, **harta e stabilitetit financiar tregon një rritje të lehtë të rrezikut të veprimtarisë bankare për kategori të caktuara të saj, dhe një ulje të rreziqeve që burojnë nga mjedisi ekonomik rrethues.** Zbutja e rreziqeve në mjedisin e përgjithshëm ekonomik, reflekton normat e mira të rritjes ekonomike dhe stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik në vend. Nëse konsiderohet ndërveprimi i kategorive përbërëse të sektorit bankar, ecuria e treguesve reflekton kryesisht një përmirësim të veprimtarisë bankare.

(2) Më konkretisht,

a. në mjedisin e përgjithshëm ekonomik vërehet që:

i. rreziku nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet "mesatar", por në rritje, në vijim të rritjes së nevojave për financim të jashtëm, si rezultat i rritjes së deficitit të llogarisë korrente në fund të vitit,

ii. rreziku që vjen nga "mjedisi i jashtëm" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie gjatë periudhës, ndikuar nga ecuria ekonomike më pozitive e vendeve partnere tregtare, nga përmirësimi i kushteve të tregut të punës në vendet burimore të dërgesave të emigrantëve dhe nga ecuria e indeksit CLI[2]. Ky i fundit dëshmon se ekonomia botërore ka hyrë tashmë në një fazë rritëse të saj;

b. tek agjentët e ekonomisë reale, vërehet që:

i. rreziku nga "individët", vlerësohet "mesatar" dhe në rënie, në sajë të përmirësimit të kredidhënies kundrejt prirjes së saj afatgjatë, përmirësimit të cilësisë së portofolit të individëve, ecurisë së normës së regjistruar të papunësisë dhe rritjes së pritshmërisë së individëve për vitin në vijim,

[2] *OECD CLI – një tregues i përbërë sinjalizues (composite leading indicator): është një ndër indekset kryesore ndërkombëtare që sinjalizon pikat e kthimit në ciklin e biznesit, pra luhatjet e aktivitetit ekonomik rreth nivelit të prodhimit potencial afatgjatë. Rënia e vlerave të indeksit sinjalizon kthesa negative në ciklin e biznesit, pra ngadalësim të aktivitetit ekonomik botëror dhe rritje të rrezikut nga "mjedisi i jashtëm".*

Grafik 1.1 Harta e stabilitetit financiar



*Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

ii. rreziku nga "bizneset", vlerësohet "mesatar" dhe në rënie, në kushtet e përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredisë për këtë kategori, pritshmërive afatshkurtra të bizneseve dhe indeksit të gjendjes së tyre financiare,

iii. për "qeverinë", niveli i rrezikut vijon të vlerësohet "i ulët", por me prirje rritëse, për shkak të zhvillimeve në balancën buxhetore gjatë periudhës, konkretisht kalimi nga gjendja e tepricës pozitive të buxhetit (suficit) në deficit buxhetor;

c. ndërsa, në veprimtarinë e sektorit bankar vërehet që:

i. niveli i rrezikut nga "kapitalizimi dhe përfitueshmëria", vlerësohet "i ulët" dhe në rënie gjatë periudhës. Kapitalizimi i sektorit dhe cilësia e kredisë janë përmirësuar, duke kontribuuar në uljen e rrezikut nga kjo kategori. Gjithashtu, "të ardhurat para tatimit dhe taksave", në raport ndaj "totalit të aktiveve", janë rritur, duke kontribuuar në rënien e rrezikut nga përfitueshmëria. Nga ana tjetër, vijimi i rënies së "të ardhurave neto nga interesat", ka kontribuuar pozitivisht në rritjen e rrezikut të kësaj kategorie,

ii. rreziku nga "likuiditeti dhe financimi" vlerësohet "i moderuar" dhe me prirje të lehtë rritëse. Ky zhvillim reflekton thellimin e hendekut midis aktiveve dhe pasiveve të bankave me afat deri në 3 muaj[3], si dhe një rritje më të ulët të depozitave nga individët. Pavarësisht sa më lart, treguesi i likuiditetit të sektorit mbetet në nivele të kënaqshme, në mbështetje të aktivitetit bankar,

iii. së fundi, vlerësimi i rrezikut që lidhet me "strukturën e sektorit bankar", vijon të mbetet i pandryshuar në nivelin "i ulët", mbështetur nga një diversifikim i mirë i fondeve të financimit dhe përmirësimi i shpërndarjes së kreditimit në sektorin bankar.

Hapësira informuese 1.1 paraqet të gjithë përbërësit e kategorive të Hartës së Stabilitetit Financiar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017, vlerësimet me "notë" për nivelin e rrezikut për secilin përbërës dhe krahasimin me vlerësimin e një viti më parë.

[3] *Brenda kësaj kategorie, e cila përgjithësisht është vlerësuar me rrezik të ulët, thellimi i hendekut është rrjedhojë kryesisht e ndryshimit të përkufizimit të termit për qëllime të analizave më të hollësishme nga autoriteti mbikëqyrës.*

HAPËSIRË INFORMUESE 1.1. PËRBËRËSIT E HARTËS SË STABILITETIT FINANCIAR

Rreziku nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet "mesatar" dhe në rritje, për shkak të rritjes së nevojave për financim të jashtëm.



Rreziku për "individët" vlerësohet "mesatar" dhe në rënie, për shkak të përmirësimit të kredidhënies dhe cilësisë së portofolit të individëve, normës së papunësisë dhe pritshmërive të tyre.



Rreziku për "bizneset" vlerësohet "mesatar" dhe në rënie, në reflektim të përmirësimit të cilësisë së kredisë, pritshmërive të bizneseve dhe indeksit të gjendjes financiare të tyre.



Rreziku që vjen nga "qeveria" vlerësohet i "ulët", por në rritje, për shkak të ndryshimit të shenjës së balancës buxhetore.



Rreziku nga "mjedisi i jashtëm" vlerësohet 'i ulët' dhe në rënie, ndikuar nga përmirësimi i rritjes ekonomike të partnerëve tregtarë dhe ecuria e indeksit CLI total.



Niveli i rrezikut nga "kapitali dhe përfitueshmëria" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie. Rreziku në rritje prej rënies së të ardhurave nga interesi është balancuar nga përmirësimi i treguesve të tjerë, si rënia e kredive me probleme, përmirësimi i nivelit të kapitalit dhe rritja e fitimit para tatimit.



Rreziku që vjen nga "financimi dhe likuiditeti" ka rezultuar në nivelin "i moderuar" dhe në rritje, rrjedhojë e thellimit të hendekut midis aktiveve dhe pasiveve afatshkurta deri në 3 muaj dhe zgjerimit më të ngadaltë të depozitave të individëve.



Rreziku nga "struktura e sektorit bankar" mbetet i ulët dhe i pandryshuar, në kushtet e një diversifikimi të mirë të fondeve të financimit dhe përmirësim të shpërndarjes së kreditimit.



1.1 RREZIKU SISTEMIK[4]

Vlerësimi i ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut sistemik kryhet duke analizuar ecurinë e treguesve që lidhen me: a) materializimin dhe me akumulimin e rrezikut sistemik; b) nivelin e stresit në sistemin financiar; c) perceptimin e industrisë bankare mbi ekspozimin e veprimtarisë së saj ndaj rreziqeve sistemike. Indeksi i materializimit të rrezikut sistemik ofron një vlerësim lidhur me nivelin aktual të rrezikut, ndërsa indekset e akumulimit të rrezikut, të stresit financiar dhe të perceptimit të industrisë bankare rreth tij, fokusohen kryesisht drejt të ardhmes.

(3) Materializimi i rrezikut sistemik ka shfaqur rënie gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë. Në këtë ecuri të indeksit, kanë ndikuar: përmirësimi i cilësisë së kredisë për individët dhe bizneset; rënia e nivelit të papunësisë në vend; si dhe ulja e luhatshmërisë në ecurinë e kursit të këmbimit (Grafik 1.2).

(4) Akumulimi i rrezikut sistemik dhe indeksi i stresit financiar kanë rënë gjatë periudhës. Në ecurinë e indeksit të akumulimit të rrezikut sistemik, ulja e nivelit të borxhit tek individët, rënia e borxhit publik dhe ngushtimi i borxhit të jashtëm kanë dhënë kontributin kryesor në uljen e akumulimit të rrezikut gjatë periudhës dhe në krahasim me një vit më parë. Indeksi i stresit financiar gjithashtu ka treguar rënie, për shkak të ecurisë së përmirësuar të treguesve të sektorit bankar dhe mbiçmimit të monedhës vendase (Grafik 1.3).

Grafik 1.2 Akumulimi dhe materializimi i rrezikut sistemik



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 1.3. Indeksi i Stresit Financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4 *Rreziku sistemik përcaktohet si "mundësia e materializimit të goditjeve që dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar, deri në masën që rritja ekonomike dhe mirëqenia të ndikohen në mënyrë materiale".*

(5) Perceptimi i industrisë bankare ofron një vlerësim përgjithësisht pozitiv dhe në zbutje mbi ecurinë e rreziqeve kryesore sistemike gjatë periudhës. Kështu, rreziku potencial nga "përkeqësimi i ekonomisë së brendshme", perceptohet ndjeshëm më i zbutur, ndikuar nga rritja ekonomike pozitive dhe e qëndrueshme në vend. Perceptimi mbi rrezikun që buron nga procesi i "ekzekutimit të kolateraleve", mbetet relativisht i lartë dhe në rritje gjatë periudhës, diktuar kryesisht nga perceptimi i bankave të mesme dhe të vogla. "Rreziku politik në vend" ka vijuar të mbetet në grupin e rreziqeve kryesore sistemike, por perceptimi ka ardhur në rënie krahasuar me gjysmën e parë të vitit[5]. Aktualisht, bankat e perceptojnë këtë rrezik kryesisht të lidhur me ecurinë e reformave ekonomike dhe klimën e biznesit në vend. Së fundi, rreziqet e lidhura me aktivitetin kreditues vijojnë të klasifikohen ndër rreziqet më të rëndësishme sistemike, por perceptimi mbi to ka vijuar të zbutet, ndikuar veçanërisht nga rënia e dukshme e nivelit të kredive me probleme në sektorin bankar.

Grafik 1.4 Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[5] *Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, perceptimi i sektorit bankar mbi rrezikun politik në vend u rrit ndjeshëm, për shkak të ashpërsimit të klimës politike në prag të zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2017.*

2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE

(6) Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017, zhvillimet në ekonominë botërore kanë qenë pozitive dhe të qëndrueshme. *Zgjerimi i aktivitetit ekonomik* ka qenë me bazë të gjerë dhe i sinkronizuar mes rajoneve. Rritja është mbështetur nga kushtet e favorshme të financimit dhe vijimi i politikave stimuluese, ndërsa rikuperimi i çmimeve të naftës ka ndihmuar rigjallërimin ekonomik të vendeve eksportuese. *Kushtet në tregjet financiare* kanë qenë të favorshme, pavarësisht divergjencave në politikat monetare të bankave kryesore. Banka Qendrore Evropiane ka vijuar të ndjekë një politikë lehtësuese në mbështetje të rritjes ekonomike të rajonit, ndërsa Rezerva Federale, Banka e Anglisë dhe bankat qendrore të një pjese të vendeve të mëdha në zhvillim, kanë ndërmarrë hapa drejt shtrëngimit monetar. *Presionet inflacioniste* në nivel botëror kanë qenë përgjithësisht të ndrydhura, por kanë shfaqur herë pas here prirje rritëse, ndikuar kryesisht nga rikuperimi i çmimeve të naftës.

(7) Aktiviteti ekonomik në vendet e zhvilluara ka vijuar të zgjerohet në mënyrë të qëndrueshme, ndërsa në rajonet në zhvillim ka shfaqur shenja të dukshme rigjallërimi. Mes *rajoneve të zhvilluara*, ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka vijuar të rritet pozitivisht gjatë periudhës, mbështetur nga kushtet e mira të financimit dhe forcimi i kërkesës së brendshme dhe investimeve. Presionet inflacioniste kanë mbetur të ulëta. Kushtet në tregun e punës janë përmirësuar dhe norma e papunësisë ka zbritur në 4.1%. Në Mbretërinë e Bashkuar, aktiviteti ekonomik shënoi rritje modeste në gjysmën e dytë të vitit, pas ngadalësimit të ndjeshëm në gjysmën e parë të tij. Në *rajonet në zhvillim*, rritja ekonomike vijon të kryesohet nga Kina dhe India, ndërkohë që rikuperimi i çmimeve të naftës dhe i lëndëve të para ka mbështetur rigjallërimin e ekonomive që i eksportojnë ato.

(8) Zgjerimi ekonomik i Eurozonës ka vijuar të jetë i qëndrueshëm dhe i balancuar mes vendeve të këtij rajoni. Të gjitha vendet anëtare kanë regjistruar rritje ekonomike vjetore pozitive gjatë T3-2017 dhe kjo prirje parashikohet të shtrihet dhe në T4-2017. Aktiviteti është mbështetur pozitivisht nga rritja e konsumit, e investimeve, si dhe rritja e eksporteve, nën një klimë më të mirë të rritjes ekonomike botërore. Kushtet në tregun e punës kanë vijuar të përmirësohen, duke mbështetur rritjen e të ardhurave dhe konsumin e familjeve. Papunësia në fund të 2017-ës ka rënë në 8.7%. Presionet inflacioniste, pavarësisht prirjes rritëse në fund të vitit, kanë mbetur të ndrydhura, me norma inflacioni nën 2%. Në këto kushte, Banka Qendrore Evropiane ka vijuar të ruajë politikën monetare lehtësuese, në mbështetje të aktivitetit ekonomik të rajonit.

(9) Në sektorin bankar në Eurozonë, aktiviteti kreditues po rikuperon gradualisht. Kredia ndaj biznesit dhe individëve është rritur në mënyrë të qëndrueshme në shumicën e vendeve. Kjo prirje pozitive e vënë re që në fillim të vitit 2014, është rezultat i rënies së ndjeshme të normave të interesit në sajë të politikave lehtësuese të BQE-së dhe rikuperimit të kërkesës për kredi. Presioni i konkurrencës në rritje dhe zbutja e perceptimit mbi rrezikun kanë qenë gjithashtu faktorë nxitës në këto zhvillime. Gjatë periudhës, bankat evropiane kanë vijuar përpjekjet për pastrimin dhe konsolidimin e bilanceve të tyre. Gjithsesi, niveli i kredive me probleme ka mbetur i lartë në vende të caktuara, duke shërbyer si element frenues për kreditimin.

(10) Ekonomia botërore pritet të vazhdojë të rritet pozitivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme gjatë periudhës afatmesme[6], duke u luhatur rreth mesatares afatgjatë. Rritja do të diktohet nga zgjerimi ekonomik i rajoneve të zhvilluara dhe rikuperimi i mëtejshëm i rajoneve në zhvillim, mbështetur nga kushtet më të mira të financimit, vazhdimi i politikave stimuluese dhe rikuperimi i çmimeve të naftës. Presionet inflacioniste pritet të rriten, ndikuar nga forcimi i kërkesës dhe ngushtimi i kapaciteteve të pashfrytëzuara. *Rreziqet ndaj perspektivës së ekonomisë botërore* vlerësohen përgjithësisht të balancuara në afatin e shkurtër. Gjithsesi, rritja e konsiderueshme e vlerës së aktiveve në tregjet financiare, në kushtet e normave dhe primeve tepër të ulëta, ka rritur rrezikun e një korrigjimi të vlerave në të ardhmen. Gjithashtu, normat e ulëta të interesit kanë nxitur kanalizimin e fondeve drejt investimeve me rrezik në kërkim të fitimeve më të larta, duke thelluar imbalancat në tregjet financiare. Së fundi, tensionet gjeopolitike si edhe veprimet proteksioniste në tregti në rajone të caktuara, vijojnë të përbëjnë një rrezik të pranishëm ndaj ecurisë së ekonomisë globale.

(11) Ekonomia e Eurozonës parashikohet të rritet në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve të ardhshme. Transmisioni i politikës monetare në ekonominë reale ka lehtësuar procesin e konsolidimit të bilanceve në ekonomi, gjë që pritet të krijojë hapësirë për rritje të mëtejshme të konsumit dhe shpenzimeve, duke mbështetur rritjen ekonomike të rajonit. Përmirësimi i kushteve në tregun e punës dhe normat e ulëta të financimit do të mbështesin gjithashtu pozitivisht rritjen e kërkesës së brendshme dhe të investimeve, ndërkohë që rigjallërimi i ekonomisë botërore do të nxisë kërkesën e jashtme për eksporte evropiane. *Rreziqet ndaj perspektivës* ekonomike të Eurozonës vlerësohen përgjithësisht të balancuara. Aktualisht, ato konsiderohen më shumë të lidhura me faktorë të jashtëm si zhvillimet në tregjet e këmbimit valutor, qartësimi i marrëdhënieve tregtare me Mbretërinë e Bashkuar pas "Brexit-it", apo ngërçi potencial në marrëdhëniet tregtare me SHBA-në.

[6] *Sipas parashikimit të FMN-së (Janar, 2018), ekonomia botërore do të rritet me 3.9% në periudhën 2018 – 2019.*

Tabela 2.1 Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)				Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi bruto i qeverisë (% PBB)	
	T3'17	T4'17	2017p	2018p	Sht'17	Dhj'17	Sht'17	Dhj'17	T2'17	T3'17
SHBA	3.2	2.6	2.3	2.7	2.2	2.1	4.2	4.1	103.1	103.8
Eurozonë	2.8	2.7	2.4	2.2	1.5	1.4	8.9	8.7	89.0	88.1
- Gjermani	2.7	2.9	2.5	2.3	1.8	1.6	3.7	3.6	65.9	65.1
-Francë	2.3	2.4	1.8	1.9	1.1	1.2	9.6	9.2	99.3	98.4
-Italì	1.7	1.6	1.6	1.4	1.3	1.0	11.1	10.8	134.7	134.1
-Greqi	1.4	1.9	-	-	1.0	1.1	20.8	-	176.1	177.4

Shënim: "-": mungesë informacioni.
Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Eurostat, Fondi Monetar Ndërkombëtar (parashikime, janar 2017), Zyra e Analizave Ekonomike (BEA –Bureau of Economic Analysis).

(12) Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, aktiviteti është zgjeruar më tej gjatë tremujorit të tretë të 2017-ës, por me ritëm të ndryshëm mes vendeve. *Rritja e PBB-së* është përshpejtuar në Shqipëri, Serbi dhe Mal të Zi, dhe ka mbetur e pandryshuar ose drejt ngadalësimit në Kosovë, Bosnje-Hercegovinë dhe në Maqedoni. Aktiviteti ekonomik në nivel rajoni vlerësohet të jetë zgjeruar me 2.8% gjatë periudhës (vit më vit), mbështetur kryesisht nga konsumi privat dhe investimet. Pavarësisht rritjes ekonomike, *kushtet në tregun e punës* vazhdojnë të mbeten sfiduese për të gjithë vendet e rajonit, veçanërisht në drejtim të krijimit të vendeve të reja të punës. Përveç Serbisë, norma e papunësisë ka qenë në rënie në pjesën tjetër të vendeve, gjatë gjysmës së dytë të vitit. Procesi i konsolidimit fiskal duket se është ngadalësuar në disa prej vendeve, duke rezultuar në rritje të deficiteve fiskale, krahasuar me një vit më parë. *Inflacioni i ulët* vijon të mbetet një karakteristikë e përbashkët e rajonit, duke reflektuar çmimet e ulëta të lëndëve të para dhe qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit të monedhave. Në *sektorin bankar*, kreditimi nga bankat ka vijuar të rritet pozitivisht dhe të mbështesë aktivitetin ekonomik të rajonit. Në të gjitha vendet, rritja e kredisë për sektorin e individëve ka tejkaluar atë të biznesit. Shumica e vendeve të rajonit kanë vijuar të reduktojnë nivelin e kredive me probleme, pjesërisht si rezultat i përmirësimit të kuadrit rregullator të trajtimit të tyre dhe fshirjeve të detyruara nga bilancet e bankave.

Tabela 2.2 Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB (reale, % vjetore)			Papunësia (në %)		Borxhi sovran (% e PBB-së)		Rritja e Kredisë (% vjetore)		Rap. i kredive me probleme (në %)	
	T2'17	T3'17	2017p	T2'17	T3'17	T2'17	T3'17	T2'17	T3'17	T2'17	T3'17
B-H	2.9	2.9	-	20.5	-	37.8	-	5.1	6.4	11.1	10.8
Maqedoni	-1.3	0.2	1.7	22.6	22.1	37.9	37.8	2.1	4.8	6.7	6.5
Mal i Zi	5.2	4.7	3.9	15.3	15.1	57.7	56.9	9.3	7.7	8.8	7.4
Kosovë	4.4	4.4	-	-	30.4	-	-	10.3	9.9	3.6	3.6
Serbi	1.4	2.1	2.0	11.8	12.9	65.7	64.6	2.9	-2.1	15.6	12.2

Shënim: "-": mungesë informacioni.
Burimi: Komisioni Evropian, p- parashikimi Nëntor, 2017.

2.1 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE DHE TË LËNDËVE TË PARA

(13) Gjatë periudhës, zhvillimet në tregjet financiare botërore mbeten të favorshme dhe të qëndrueshme, pavarësisht thellimit të divergjencave të politikave mes rajoneve. Vendimet e politikave monetare në rajonet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, kanë adresuar ecurinë ekonomike të vendeve. Kështu, BQE-ja ka vijuar të akomodojë politikën e saj monetare në kushtet e inflacionit nën nivelin e synuar, ndërsa Rezerva Federale ka ndërmarrë hapa të reja drejt shtrëngimit të politikës monetare në fund të vitit[7]. Banka e Anglisë gjithashtu ka ndryshuar drejtimin e politikës së saj, duke realizuar rritjen e parë të normës bazë - në 0.5% - në 10 vitet e fundit, në përgjigje të zhvlerësimit të paundit dhe rritjes së inflacionit. Divergjenca janë vënë re dhe në rajonet e mëdha në zhvillim. Kështu, Kina ka rritur normën e interesit, me qëllim shtrëngimin e kushteve të financimit dhe frenimin e kreditimit, ndërsa në rajone të tjera në zhvillim si India dhe disa vende eksportuese, bankat qendrore kanë akomoduar më tej politikën monetare, si kundërpërgjigje ndaj presioneve të dobëta inflacioniste. Pavarësisht këtyre divergjencave, zhvillimet në tregjet financiare kanë qenë optimiste dhe të mbizotëruara nga besimi se ribalancimi i politikave nga bankat qendrore kryesore do të realizohet shumë gradualisht.

(14) Ecuria e vlerave dhe normave në *tregjet e zhvilluara* ka reflektuar rritjen e qëndrueshme ekonomike të këtyre rajoneve dhe pritjet optimiste për të ardhmen. Kështu, normat e kthimit në tregjet evropiane të titujve të sovranit kanë qenë përgjithësisht të pandryshuara, ndërsa në tregjet amerikane dhe angleze kanë qenë në rritje gjatë gjithë periudhës, ndikuar nga pritjet e tregut mbi ndryshimin e politikës monetare të tyre. Në *tregjet e kapitalit*, zhvillimet kanë qenë pozitive, të karakterizuara nga rritje të vlerave, ngushtim të

Grafik 2.1 Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Grafik 2.2 Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

[7] *Në dhjetor 2017, Rezerva Federale ka rritur intervalin e normës së fondeve federale në 1.25% - 1.50%, si dhe ka ndërmarrë hapa për zvogëlimin e bilancit të saj.*

spread-eve dhe rënie të luhatshmërisë. Në *tregjet në zhvillim*, normat e interesit kanë qenë përgjithësisht në rënie, duke sjellë një përmirësim modest të kushteve të financimit dhe flukseve hyrëse të kapitalit. Çmimet e aksioneve në këto tregje kanë qenë në rritje, mbështetur nga pritjet për një perspektivë të mirë ekonomike të vendeve eksportuese të naftës dhe lëndëve të tjera të para.

(15) Ecuria në tregjet e monedhave ka reflektuar gjerësisht dallimet në fazat e ciklit ekonomik mes vendeve dhe pritjet mbi të ardhmen e politikave monetare. Kështu, gjatë periudhës, Euro është zhvlerësuar kundrejt Dollarit amerikan dhe paundit britanik, si dhe kundrejt monedhave të disa prej vendeve në zhvillim. Nga ana tjetër, Euro është vlerësuar kundrejt monedhave të disa vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim, duke përfshirë këtu frangën zviceriane, jenin japonez, renminbi kinez dhe një pjesë të mirë të monedhave të vendeve evropiane jashtë Eurozonës.

(16) Çmimet e naftës kanë qenë në rritje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017, ndikuar nga një sërë faktorësh, si nga ana e ofertës ashtu edhe e kërkesës. Gjatë periudhës gusht - mes dhjetori 2017, çmimet e naftës bruto janë rritur me rreth 20%, duke arritur në mbi 60 usd/fuçi[8]. Kjo prirje rritëse ka vijuar dhe në muajt e parë të vitit 2018 dhe u mbështet në disa faktorë, ku përfshiheshin pritjet optimiste të tregut mbi ecurinë e ekonomisë botërore, zgjatja e marrëveshjes së vendeve të OPEC-ut për kufizimin e kuotave të prodhimit, tensionet politike në Lindjen e Mesme dhe kushtet e vështira të motit në SHBA në fund të vitit. Rreziqet për rritjen e mëtejshme të çmimit të naftës, lidhen kryesisht me potencialin e madh të prodhimit të saj nga ana e SHBA-së. Çmimet e lëndëve të para kanë qenë në rënie gjatë gjysmës së dytë të vitit, diktuar kryesisht nga rënia e çmimit të produkteve ushqimore.

2.2 ZHVILLIMET NË GRUPET BANKARE TË HUAJA QË OPEROJNË NË SHQIPËRI

(17) Në Tabelën 2.3 paraqiten disa tregues kryesorë të pasqyrave financiare të grupeve bankare zotëruese që operojnë në Shqipëri, në terma relativë, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

[8] *Buletini Ekonomik, BQE, Dhjetor 2017.*

Tabelë 2.3 Zhvillimet në grupet e huaja bankare që operojnë në Shqipëri

Ndryshim (%)	Raiffesen Bank International[1]	Intesa San Paolo[2]	Alpha Bank[3]	Piraeus Bank[4]	National Bank of Greece[5]	Societe Generale[6]
Aktive	3.8%	3.0%	-7.4%	-18.0%	-19.5%	-5.9%
Kredi	1.7%	3.1%	-2.9%	-6.0%	-5.8%	-0.3%
Depozita	4.3%	-1.3%	6.0%	6.0%	1.9%	-2.5%
Provigjione	-68.1%	-49.1%	-11.9%	-10.0%	21%	7.6%
Fitimi neto	...	...	...	...	...	-27.6%
Të ardhura operative	4.0%	1.2%	4.5%	5.0%	0.0%	-25.4%
Të ardhura neto nga interesi	2.2%	-2.5%	2.0%	-5.0%	-5.0%	
Të ardhura neto nga komisionet	7.7%	5.5%	1.7%	55.0%	43.0%	
Shpenzime operative	-0.1%	0.4%	-2.5%	-4.0%	-8.0%	6.1%
Rezultati neto operativ	10.7%	2.0%	-	-	...	-
Raporte						
Kredi me probleme	6.7%	5.5%	37.3%	36.2%	-	4.4%
Marzhi neto nga interesat	2.46%	-	3.1%	2.73%	3.07%	-
Mjaftueshmëria e kapitalit	17.9%	17.9%	17.9%	16.6%	16.8%	17.0%
Aktivet e bankës në Shqipëri ndaj totalit të grupit	1.31%	0.14%	0.91%	0.81%	0.42%	0.05%

[1] Raporti për tremujorin e tretë 2017: http://investor.rbinternational.com
[2] Rezultatet financiare për vitin 2017: http://www.group.intesasanpaolo.com
[3] Rezultatet financiare për tremujorin e tretë 2017: http://www.alpha.gr
[4] Rezultatet financiare për tremujorin e tretë 2017: http://www.piraeusbankgroup.com
[5] Rezultatet financiare për tremujorin e tretë 2017: https://www.nbg.gr
[6] Rezultatet financiare për vitin 2017: http://www.societegenerale.com
Shënim: Shenja (...) tregon ndryshim të theksuar të këtij treguesi (mbi 100%), qoftë në terma pozitivë apo negativë.
Ndërsa shenja (-) tregon të dhëna të padisponueshme për këtë tregues në publikimet e bankës përkatëse.
Burimi: Faqet zyrtare të grupeve bankare.

Treguesit paraqesin një kapitalizim të mirë të të gjithë grupeve bankare dhe një përmirësim të nivelit të të ardhurave në disa prej tyre. Pesha e bankave që operojnë në Shqipëri, në totalin e aktiveve të grupeve bankare të huaja, vijon të mbetet në nivele të ulëta.

HAPËRSIRË INFORMUESE: DISA REZULTATE NGA VROJTIMI I BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE MBI 'HUADHËNIEN E BANKAVE NË VENDET E EVROPËS QENDRORE LINDORE E JUGLINDORE (EQLJ), 6MII 2017 DHE POZICIONIMI I SHQIPËRISË

A. Grupet bankare ndërkombëtare në raport me rajonin EQLJ

*Në vrojtimin më të fundit, i cili përkon me **gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017**, grupet bankare që operojnë në vendet e Evropës Qendrore Lindore e Juglindore (EQLJ), duket se parashikojnë një zgjerim selektiv në këtë rajon, bazuar në pozicionimin e tyre në treg, potencialin e tregut dhe nivelin e të ardhurave nga aktiviteti. **Ekspozimet në nivel grupi ndaj rajonit EQLJ janë reduktuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017**, krahasuar me gjysmën e parë të tij (balanca neto e përgjigjeve ka rënë nga -7% në -13%), ndërkohë që pesha e bankave që kanë rritur ekspozimin ka mbetur e njëjtë. Nga ana tjetër, parashikimi i grupeve për 6 muajt e ardhshëm paraqitet më optimist, ku rreth 33% e tyre presin të rrisin ekspozimet ndaj rajonit, kundrejt 20% që presin reduktim të mëtejshëm të tyre (grafik 2.3).*

Grafik 2.3 Ekspozimi i grupeve bankare ndaj rajonit EQLJ (peshat e përgjigjeve në %)



*parashikim.

Shënim: Balanca neto është llogaritur si diferencë midis peshës së përgjigjeve "rritje ekspozimi" dhe peshës së përgjigjeve "ulje ekspozimi".

Burimi: Banka Evropiane e Investimeve.

Grafik 2.4 Strategjitë afatgjata (mbi 12 muaj) ndaj rajonit EQLJ



Burimi: Banka Evropiane e Investimeve.

Përsa i përket ***strategjive afatgjata (mbi 12 muaj)*** *(Grafik 2.4), duket se grupet bankare po rivlerësojnë strategjitë e tyre vend pas vendi në rajonin EQLJ. Kështu, siç rezulton nga përgjigjet e institucioneve të anketuara, për 6-mujorin e dytë 2017, rreth 50% e grupeve deklarojnë se kanë strategji afatgjatë për zgjerim (totali i "zgjerim selektiv i aktivitetit në disa vende" dhe "zgjerim i aktivitetit") të veprimtarisë në rajon. Nga ana tjetër, rreth 20% e grupeve bankare ku përfshihen edhe grupet bankare greke, por jo vetëm, shprehen se mund të reduktojnë aktivitetin e tyre në rajon në afatin e gjatë (totali i "reduktim aktiviteti" dhe "reduktim selektiv i aktivitetit").*

Kërkesa për kredi në rajon vlerësohet përgjithësisht në rritje, ndërsa standardet e kreditimit vlerësohet të jenë lehtësuar gjatë periudhës së vrojtuar. *Gjithsesi, bankat perceptojnë se në rajonin EQLJ ka ende një hendek të dukshëm midis kërkesës së lartë për kredi dhe ofertës ende të ndrydhur. Shumica e grupeve bankare të përfshira në vrojtim, vlerësojnë se treguesit e përfitueshmërisë mesatare të rajonit, në raport me aktivet (ROA) dhe kapitalin (ROE), janë më të larta se ato mesatare të grupit.*

B. Pozicionimi i Shqipërisë në raport me rajonin EQLJ

Për 6-mujorin e dytë 2017, shumica e grupeve të huaja bankare që operojnë në vendin tonë (rreth 71%), e vlerësojnë pozicionimin e tyre në treg si të "kënaqshëm", ndërsa 14% e shohin si "optimal" (grafik 2.5). Nga ana tjetër, 71% e grupeve e konsiderojnë Shqipërinë si një treg me potencial "mesatar" dhe me përfitueshmëri më të ulët se grupi, për shkak edhe të procesit ende të papërfunduar të pastrimit të bilancit të bankave (grafik 2.6.).

Grafik 2.5 Potenciali i tregut në 6MII-2017 (peshat e përgjigjeve, në %)



Burimi: Banka Evropiane e Investimeve.

Grafik 2.6 Pozicionimi i bankave në treg (peshat e përgjigjeve, në %)



Burimi: Banka Evropiane e Investimeve.

Shumica e filialeve të bankave në Shqipëri vlerësohen me përfitueshmëri më të ulët se grupet bankare mëma, gjatë 6 muajve të kaluar. Procesi i trajtimit të kredive me probleme duket se ka ndikuar negativisht përfitueshmërinë e bankave.

Aktualisht, pozicionimi i kënaqshëm i grupeve bankare të huaja dhe vlerësimi i tyre për potencialin e tregut, sugjeron një gatishmëri relativisht të ulët për t'u zgjeruar në tregun shqiptar përmes përthithjeve apo bashkimeve. Nga ana tjetër, përparimi në drejtim të pastrimit të bilancit të bankave, pritet të sjellë përmirësim të treguesve të përfitueshmërisë dhe të shoqërohet me përmirësim të potencialit të tregut.

Gjithsesi, krahasuar me rezultatet e këtij vrojtimi një vit më parë (6MII 2016), ku grupet bankare e konsideronin Shqipërinë një treg me potencial të kufizuar dhe përfitueshmëri të ulët krahasuar me pjesën tjetër të rajonit EQLJ, duket se këndvështrimi i bankave është disi më optimist (grafikët 2.7 dhe 2.8).

Grafik 2.7 Potenciali i tregut shqiptar në 2 vitet e fundit



Burimi: Banka Evropiane e Investimeve.

Grafik 2.8 Pozicionimi i grupeve bankare në tregun shqiptar



Burimi: Banka Evropiane e Investimeve.

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË VEND

(18) Aktiviteti ekonomik vendas vijoi të përmirësohet edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit, ndonëse me ritëm më të ulët rritjeje krahasuar me tremujorët paraardhës të vitit. Rritja vjetore në fund të tremujorit të katërt shënoi vlerën 3.36%[9], me kontribut pozitiv thuajse nga të gjitha degët e sektorit të shërbimeve dhe të prodhimit, ku veçohen kryesisht: "tregti, hotele dhe restorante", "transport", "ndërtim" dhe "industri, energji dhe ujë". Kërkesa agregate u mbështet në zgjerimin e konsumit final të popullatës dhe në formimin e kapitalit fiks, në kushtet kur konsumi final i qeverisë u ul, ndryshe nga zhvillimet e shënuara përgjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2017. Në tregun e punës, norma e papunësisë vijon prirjen rënëse që prej muajit dhjetor të vitit 2015, duke u ulur në nivelin prej 13.4%[10].

(19) Në vijim të presioneve të përmbajtura të inflacionit, politika monetare ka mbetur lehtësuese gjatë periudhës, ndonëse nuk pati ndryshime të normës bazë të interesit. Megjithëse të dhënat e disponuara sugjerojnë se aktiviteti ekonomik, punësimi dhe besimi i agjentëve ekonomikë kanë ardhur në përmirësim, këto zhvillime ende nuk janë pasqyruar në vlerat e inflacionit. Kështu, në dhjetor të vitit 2017, inflacioni vjetor arriti në nivelin 1.8%, me rënie si në terma gjashtëmujorë, ashtu edhe vjetorë[11]. Banka e Shqipërisë vlerëson se vijimi i rritjes ekonomike dhe ankorimi i mirë i pritjeve inflacioniste, do të krijojnë premisat e duhura për rritjen e inflacionit dhe kthimin e tij në objektiv në afat të mesëm.

(20) Në fund të vitit 2017, teprica buxhetore ishte negative për rreth 31 miliardë lekë, me një rritje prej gati 4.3 miliardë lekësh kundrejt një viti më parë. Në terma relativë, vlerësohet se deficiti buxhetor u rrit 0.25 pikë përqindje gjatë 2017-ës, në nivelin 2.15% e PBB-së. Në thellimin e deficitit buxhetor ndikoi rritja e shpenzimeve buxhetore me ritëm më të lartë se rritja e të ardhurave[12]. Financimi i deficitit u bë kryesisht nga fondet e huaja, duke ulur nevojën për huamarrje të qeverisë në tregun e brendshëm. Luhatshmëria në treguesin e deficitit buxhetor në afat të shkurtër është e pritshme, por procesi i konsolidimit fiskal vlerësohet i nevojshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike në terma afatgjatë. Nevoja për realizimin e shpenzimeve

---

[9] *Nga vlerësimet paraprake të INSTAT-it, rritja reale vjetore e aktivitetit ekonomik vendas vlerësohet në 3.84%.*

[10] *Norma e papunësisë shënonte nivelin prej 14.2% në T4-2016 dhe 13.9% në T2-2017.*

[11] *Më konkretisht, në dhjetor 2016 dhe qershor 2017, norma vjetore e inflacionit ishte përkatësisht 2.2%.*

[12] *Të ardhurat vjetore shënuan një vlerë kumulative prej rreth 431 miliardë lekësh (5.7% rritje vjetore), ndërsa shpenzimet e përgjithshme shënuan vlerën prej rreth 461 miliardë lekësh (6.4% rritje vjetore).*

buxhetore dhe veçanërisht të atyre kapitale, në përputhje me objektivat, mbetet sërish sfidë për planifikimin dhe realizimin e buxhetit.

(21) Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi pozitiv dhe me zgjerim të mjeteve valutore gjatë tremujorit të fundit të vitit 2017. Pas një ecurie në rënie deri në T3-2017, gjatë tremujorit të fundit të vitit, deficiti i llogarisë korrente u zgjerua ndjeshëm në terma vjetorë, duke u ngjitur në nivelin 295 milionë euro në fund të 2017-ës ose rreth 117 milionë euro më i lartë. Në këtë ecuri, kontributin kryesor e dha zgjerimi i mëtejshëm i deficitit tregtar në mallra, ndjekur nga rënia e tepricës pozitive (suficitit) në llogaritë e shërbimeve dhe të ardhurave parësore. Thellimi i deficitit tregtar në mallra është rrjedhojë e importeve të larta në energjinë elektrike dhe produktet farmaceutike, si edhe i rënies së eksporteve të naftës dhe produkteve të saj. Flukset hyrëse në llogarinë e të ardhurave dytësore u rritën me 13% kundrejt një viti më parë, duke arritur në 253 milionë euro. Brenda kësaj kategorie, dërgesat e emigrantëve zënë rreth 68% të totalit dhe vlerësohet të kenë rezultuar në një fluks hyrës prej rreth 172 milionë eurosh. Fluksi i detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën vlerësohet në 359 milionë euro, thuajse i dyfishuar kundrejt një viti më parë. Investimet e huaja direkte (IHD) përbëjnë dhe masën më të madhe të detyrimeve financiare. Fluksi hyrës neto i IHD-ve shënon vlerën prej 232 milionë eurosh rreth 2% më i ulët se një vit më parë. Sektori i energjetikës, ai i hidrokarbureve dhe ndërmjetësimi financiar vijojnë të japin dhe kontributin kryesor në rritjen e tyre. Së fundi, detyrimet në formën e investimeve të tjera shënuan një zgjerim me 123 milionë euro, ndërkohë që një vit më parë kjo kategori shënonte një rënie me 60 milionë euro.

4. POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

(22) Gjysma e dytë e vitit dëshmoi për një orientim më të lartë të individëve drejt kursimit. Zgjerimi i bazës së depozitave, kryesisht në monedhë të huaj, dha kontributin kryesor në zgjerimin e pozicionit kreditor të individëve gjatë periudhës[13]. Edhe gjendja e likuiditetit të bizneseve shfaqet më e përmirësuar në kushtet kur bizneset kanë ngushtuar pozicionin e tyre debitor gjatë periudhës, në sajë të rritjes së depozitave në Lek.[14]. Në *terma vjetorë*, ndryshe nga prirja gjashtëmujore, individët shfaqin një ngushtim të lehtë të pozicionit kreditor me kontribut nga pozicioni kreditor në monedhën vendase[15]. Ndërsa, bizneset regjistrojnë sërish ngushtim të pozicionit debitor, falë dhe rënies së kredisë në monedhë të huaj[16]. Procesi i fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave, u shoqërua me një nivel të lartë të shlyerjeve dhe ristrukturimeve në sektorin bankar, duke sjellë rrjedhimisht edhe një përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së kredisë në tërësi dhe veçanërisht të kredisë së pambrojtur në valutë.

4.1 POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

(23) Gjatë periudhës, pozicioni kreditor i individëve u ngjit në nivelin 781 miliardë lekë, me kontribut kryesor nga zgjerimi i pozicionit në monedhë të huaj[17]. Ndonëse ritmi i rritjes së kredisë ishte më i lartë se ai i depozitave, baza më e gjerë e këtyre të fundit ndikon në drejtim të kahut të lëvizjes së pozicionit neto. Kredia për individë mbeti e orientuar drejt monedhës vendase, duke kontribuuar në ngushtimin e pozicionit kreditor në Lek[18]. Nga ana tjetër,

[13] *Pozicioni kreditor shënon një zgjerim me rreth 2.0% gjatë periudhës, ndikuar kryesisht nga rritja e nivelit të depozitave me 2.2%. Depozitat në monedhë të huaj dhe Lek u rritën me përkatësisht 3.9% dhe 0.4%. Njëkohësisht, rritje shënoi edhe kreditimi i individëve me rreth 2.8%. Brenda këtij portofoli, kredia në Lek u rrit me 4.4%, përkundër rritjes me vetëm 0.8% të asaj në monedhë të huaj;*

[14] *Pozicioni debitor gjatë periudhës u ngushtua me 5.8%, kryesisht si rrjedhojë e ngushtimit të pozicionit në Lek (8.5%), falë rritjes së depozitave në këtë monedhë (13.3%). Ndërkaq, kredia ra lehtësisht me 0.6%, ndikuar nga rënia e kredisë në monedhë të huaj me 1.8%, përkundër rritjes me 1.2% të kredisë në monedhën vendase.*

[15] *Në terma vjetorë, regjistrohet një ngushtim prej vetëm 0.3% i pozicionit kreditor të individëve falë ngushtimit të atij në monedhën vendase me 3.1%, përkundër zgjerimit të atij në monedhë të huaj me 2.2%.*

[16] *Ngushtimi i pozicionit debitor në terma vjetorë ishte rreth 11% dhe u ndikua kryesisht nga ngushtimi i pozicionit në monedhë të huaj me 15.4%. Rënia e kredisë dhe depozitave në monedhë të huaj - 8.3% dhe 0.9%, përkatësisht - u shoqërua me rritje të kredisë dhe depozitave në monedhën vendase: përkatësisht me 3.3% dhe 10.5%.*

[17] *Pozicioni kreditor në monedhë të huaj u zgjerua me rreth 4.5%, rrjedhojë e rritjes së depozitave në valutë me 3.9%.*

[18] *Pozicioni kreditor në Lek u ngushtua me rreth 1.0%, rrjedhojë e rritjes së kredisë në Lek me 4.4%.*

bizneset kanë ngushtuar pozicionin e tyre debitor ndaj sektorit bankar në nivelin 149 miliardë lekë. Ndikimi pozitiv ka ardhur nga të gjitha monedhat[19], ku kontributin kryesor e ka dhënë rritja e depozitave të bizneseve në Lek.

(24) Zhvillimet e periudhës që lidhen me **individët rezidentë**, dëshmojnë se kursimet e tyre u rritën, kryesisht në formën e depozitave në valutë dhe investimeve në obligacione, ndërkohë që investimet në bono thesari u ngushtuan, duke ulur dhe peshën e tyre në totalin e portofolit të investimeve të individëve. Ndërsa, në terma vjetorë, kursimet e individëve rezidentë u rritën kryesisht në formën e depozitave në Lek dhe investimeve në fonde investimi.

Grafik 4.1 Pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve, miliardë lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabela 4.1. Aktivet e individëve rezidentë në sistemin financiar

	2010		2013		2016, dhjetor		2017, qershor		2017, dhjetor	
	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %
Depozita në Lek	357.6	49.8	449.5	43.7	454.3	40.3	465.1	42.1	467.2	40.7
Depozita në valutë	304	42.3	418.4	40.7	476.4	42.3	432.8	39.2	469.5	40.9
Bono thesari	56.7	7.9	70.6	6.7	65.2	5.8	67.3	6.1	63.6	5.5
Obligacione	0.37	0.05	39.8	3.9	64.5	5.7	67.9	6.1	72.1	6.3
Fondet e investimeve*	-	-	50.3	4.9	65.4	5.8	70.8	6.4	73.5	6.4
Fondet e pensioneve private vullnetare*	0.12		0.43	0.04	1.2	0.1	1.3	0.1	1.6	0.1
Portofoli i individëve	718.8	100	1,029	100	1,127	100	1,105	100	1,147	100

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe AMF.

4.1.1 KREDITIMI I INDIVIDËVE DHE RREZIKU I KREDISË

(25) Gjatë periudhës, zgjerimi i kredisë për individë me gati 2.7%[20], i atribuohet tërësisht monedhës vendase, në kushtet kur kredia në valutë ka mbetur thuajse në të njëjtat nivele. Si rrjedhim, pesha e kredisë në Lek për individët është ngjitur në 59.3%, rreth 1.1 pikë përqindje më e lartë se në qershor 2017. Tek kredia në valutë për individët, vlera e kredisë së pambrojtur në valutë ka vijuar të bjerë, si në terma gjashtëmujorë ashtu edhe vjetorë, duke ulur ekspozimin ndaj lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit. Pesha e kredisë së pambrojtur në valutë ndaj tepricës totale të kredisë në valutë dhënë individëve zbriti në 51.9%, krahasuar me 53.1% dhe 53.9% në qershor 2017 dhe dhjetor 2016[21]. Rreth 77% e kredisë së pambrojtur për individë përbëhet nga "kredi për blerje shtëpie", e cila gjatë harkut kohor njëvjeçar

[19] *Ngushtimi i pozicionit debitor ishte përkatësisht 8.5% dhe 3.7% për monedhën vendase dhe atë të huaj.*

[20] *Në terma vjetorë, rritja e kredisë për individët ishte 5.5%.*

[21] *Në të njëjtin kah janë dhe zhvillimet në peshën e kredisë së pambrojtur në valutë kundrejt tepricës totale të kredisë dhënë individëve. Ky raport paraqet rënie në terma vjetorë dhe gjashtëmujorë. Konkretisht, ajo arrin në nivelin 23.4% në dhjetor 2017, kundrejt vlerës 23.7% në qershor 2017 dhe 25.7% në dhjetor 2016.*

ka rënë me 2.3 pikë përqindjeje. Sipas afatit të maturimit, në kredinë totale për individë, nuk vërehen ndryshime thelbësore strukturore gjatë periudhës[22]. Kredia afatmesme dhe ajo afatgjatë paraqesin një rritje minimale me 0.1 pikë përqindjeje përkatësisht ndaj gjysmës së parë të vitit, ndërsa kredia afatshkurtër ra me 3 pikë përqindjeje gjatë të njëjtës periudhe.

Grafik 4.2 Struktura e kredisë për individë sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.3 Ndryshimi vjetor i raportit të kredive me probleme për individët, pikë përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(26) Përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë për individët ka vijuar me kontribut kryesor nga procesi i shlyerjes së kredive, krahas edhe fshirjes së atyre të humbura nga bilancet e bankave. Raporti i kredive me probleme për individët zbriti në 7.6%, rreth 2.6 pikë përqindjeje më i ulët se viti i kaluar. Për kredinë me probleme në valutë, përmirësimi është vërejtur në portofolin total dhe në atë të pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit. Raporti i kredisë me probleme në valutë për individët zbriti në nivelin 8.7%, duke shënuar një rënie vjetore dhe gjashtëmujore prej përkatësisht 3.2 pikë përqindjeje dhe 2.4 pikë përqindjeje. Raporti i kredive me probleme për kredinë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet në kursin e këmbimit zbriti më tej në nivelin 9.8%[23]. Për lekun, raporti i kredive me probleme zbriti në 6.9%, gati 1.1 pikë përqindje dhe 1.7 pikë përqindje më pak se përkatësisht niveli i qershorit 2017 dhe i dhjetorit 2016.

[22] *Zhvillimet e mësipërme konfirmohen edhe përsa i takon zhvillimeve vjetore.*
[23] *Ky raport shënonte vlerat 10.6% dhe 11.2% në fund të qershorit 2017 dhe dhjetorit 2016.*

(27) Individët rezidentë kanë përftuar kredi me ritme të përshpejtuara, përkatësisht 2.8% dhe 5.5% në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë. Brenda këtij portofoli, ashtu si edhe në gjashtëmujorin e kaluar, kontributi kryesor vjen nga zgjerimi i kredisë për "mallra jo të qëndrueshëm" dhe për "pasuri të paluajtshme". Kjo e fundit nuk regjistron ndryshime thelbësore në peshë (63.2%) dhe vijon të përbëjë dhe zërin kryesor brenda kredisë totale dhënë kësaj kategorie të individëve.

HAPËSIRË INFORMUESE 4.1. REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E FAMILJEVE

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së familjeve kryhet çdo gjashtë muaj mbi një kampion rastësor prej 1,209 familjesh, rreth 56% e të cilave jetojnë në zonat urbane dhe 44% në zonat rurale të vendit.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2017, ***numri i të punësuarve*** *në kampionin e vrojtuar ka shënuar rritje në terma vjetorë, mbështetur kryesisht nga punësimi në sektorin shtetëror.* ***Niveli i të ardhurave*** *të familjeve ka shënuar rënie gjatë gjashtëmujorit, ndërsa niveli i shpenzimeve ka vijuar prirjen rritëse, duke rezultuar në ngushtim të balancës financiare (të ardhura-shpenzime). Rreth 28% e familjeve deklarojnë se kanë hua për të paguar dhe kjo peshë ka mbetur e njëjtë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por në rënie krahasuar me një vit më parë.*

Në 37% të rasteve të huamarrjes, familjet i janë drejtuar burimeve formale (banka dhe institucione jobankare) në formën e produkteve të kredisë dhe në 63% të rasteve i janë drejtuar burimeve joformale, kryesisht para në dorë. Ndryshe nga struktura e frekuencës së rasteve të huamarrjes, ***shpërndarja e tepricës*** *së saj tregon që rreth 82% e saj është siguruar nga burime formale dhe 18% nga burime joformale dhe kjo strukturë është zhvendosur në favor të huamarrjes formale krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe një vit më parë. Sipas frekuencës së rasteve të huamarrjes, tre* ***qëllimet kryesore të huamarrjes*** *mbeten: për konsum (42% e rasteve të huamarrjes), blerje/riparim prone (26% e rasteve) dhe zhvillim biznesi (12% e rasteve). Gjatë periudhës së vrojtuar, peshat e rasteve të huamarrjes për konsum dhe blerje prone kanë shënuar rënie. Në tepricën e huamarrjes, rreth 46% e tepricës së huasë deklarohet për 'blerjen/riparimin e një prone', 31% për 'zhvillimin e një biznesi' dhe vetëm 6% për 'qëllime konsumi'. Në përbërje e tepricës* ***sipas monedhës*** *rezulton se 92% e saj deklarohet në Lek dhe vetëm 8% në euro.*

Familjet huamarrëse vlerësojnë rënie të ***kështit të huasë*** *gjatë periudhës referuese, duke reflektuar prirjen rënëse të normës së ponderuar të interesit të kredisë për individët. Shumica e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se* ***aftësia e tyre paguese*** *nuk ka ndryshuar gjatë periudhës, ndërsa pjesa tjetër deklarojnë kryesisht përkeqësim. Shumica e familjeve (rreth 72%) nuk presin ndryshim të aftësisë paguese në gjysmën e parë të vitit 2018, ndërsa pjesa tjetër, (pra ata që presin "përkeqësim" dhe ata që presin "përmirësim"), kanë rezultuar në numër të barabartë.*

Mundësia për të marrë hua *gjatë pjesës së parë të vitit 2018 ka rezultuar pothuaj në nivelin e mesatares afatgjatë por me prirje të lehtë rritëse, çka mund të sinjalizojë një gjallërim të kërkesës për kredi nga sektori i individëve.*

4.1.2 KREDITIMI I BIZNESEVE DHE RREZIKU I KREDISË

(26) **Kredia për bizneset** përbën 65% të tepricës së kredisë dhënë **nga sektori bankar dhe regjistron një rënie të lehtë vjetore.** Brenda këtij portofoli, peshën kryesore e zë kredia për biznesin rezident, me 86%. Kjo e fundit, ndonëse regjistron një tkurrje në terma vjetorë me 2.4%, ka shënuar një rritje të lehtë kundrejt gjashtëmujorit të kaluar prej 0.5%. Gjatë periudhës në analizë, zgjerimi më i madh ndodhi në tepricën e kredisë për "kredi kufi" dhe "blerje pajisjesh"[24]. Ndërsa, zhvillimet vjetore flasin për një rënie të stokut të kredisë kryesisht në kategorinë për "kapital qarkullues". Teprica e kredisë për bizneset jorezidente u ngushtua si në terma gjashtëmujorë ashtu dhe vjetorë[25].

(27) **Në strukturën e kredisë totale për bizneset vërehet rritje e mëtejshme e kredisë në Lek.** Pesha e kredisë në valutë në totalin e kredisë së bizneseve zbriti në 61.3%, ose 1.4 pikë përqindje më pak se një vit më parë. Pesha e kredisë së pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit ndaj totalit të kredisë për bizneset zbriti gjithashtu në nivelin 24.7%[26]. Në strukturën e kredisë së pambrojtur të bizneseve, peshat e kredisë "për tregti", "për zhvillim të pasurive të paluajtshme" dhe "për zhvillim biznesi" janë përkatësisht 46.4%, 10.5% dhe 14.2%.

Grafik 4.4 Struktura e kredisë për bizneset sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(28) **Në stokun e kredisë për bizneset,** përqendrimi tek **bizneset e mëdha dhe të mesme, është rritur.** Peshat e kredisë për këto biznese janë ngjitur përkatësisht në 60.2% dhe 23.8% të totalit të kredisë për bizneset, ndërsa

[24] *Më konkretisht, "kredia kufi" dhe "kredia për blerje pajisjesh" regjistrojnë një rritje gjashtëmujore prej përkatësisht 4.1 miliardë lekësh.*

[25] *Për më shumë, lutemi referojuni zhvillimeve në tepricën e kredisë në seksionin 8.3.1 të raportit.*

[26] *Pesha e saj në qershor 2017 dhe dhjetor 2016, është përkatësisht 26.4% dhe 27.0% e totalit të kredisë për bizneset.*

pesha e kredisë për bizneset e vogla ka rënë në 16.0%[27]. Gjatë periudhës, biznesi i vogël dhe i mesëm ka vijuar të rrisë peshën e kredisë afatgjatë, ndërsa biznesi i madh vijon të jetë i orientuar drejt kredisë afatmesme, duke regjistruar ndryshime të vogla në rënie në peshën e asaj afatgjatë. **Sipas monedhës së kreditimit**, vërehet se biznesi i vogël ka ulur peshën e kreditimit në monedhë vendase në favor të asaj të huaj, ndërsa biznesi i mesëm dhe ai i madh kanë zgjeruar kredinë në Lek.

Grafik 4.5 Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(29) Cilësia e portofolit të kredisë për bizneset, pothuaj në të gjithë përbërësit e saj, shënon një përmirësim të ndjeshëm, gjatë periudhës dhe në terma vjetorë. Në dhjetor të vitit 2017, raporti i kredive me probleme për bizneset (RKP) shënoi nivelin 16.9%, nga 19.5% në qershor 2017 dhe 23.0% një vit më parë. RKP-ja për kredinë në valutë ka ndjekur të njëjtën prirje, duke zbritur në 16.6% në fund të periudhës, ose 7.7 pikë përqindje nën nivelin e një viti më parë. Cilësia e portofolit të kredisë së pambrojtur në valutë shënoi gjithashtu përmirësim të ndjeshëm, kryesisht vjetor, ndikuar si nga procesi i shlyerjes së kredive, ashtu edhe ato të ristrukturimeve dhe fshirjes së kredive të humbura nga bilancet. Në fund të periudhës, raporti i kredive me probleme për këtë kategori zbriti në 13.8%, nga 15.1% në fund të qershorit dhe 22.2% një vit më parë. Edhe RKP-ja e portofolit të kredisë në Lek u ul në 19.6% në dhjetor të vitit 2017, ose rreth 1.7 dhe 2.7 pikë përqindje më e ulët përkatësisht kundrejt vlerave të qershorit 2017 dhe dhjetorit 2016.

Grafik 4.6. Ndryshimi vjetor i raportit të kredive me probleme për bizneset, në pikë përqindjeje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[27] *Këto vlera shënonin përkatësisht: 57.3%; 22.0%; dhe 20.7%, në dhjetor të 2016-ës; ndërsa në qershor të 2017-ës, ato ishin përkatësisht: 56.9%; 22.5% dhe 20.7%*

HAPËSIRË INFORMUESE 4.2. REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E NDËRMARRJEVE

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së ndërmarrjeve kryhet prej tetë vitesh, me një frekuencë gjashtëmujore. Duke filluar nga gjashtëmujori i parë të vitit 2016, ky vrojtim është hedhur në terren me një kampion të zgjeruar prej rreth 1200 ndërmarrjesh të përmasave të mëdha, të mesme e të vogla, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin, dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Në këtë vrojtim, ndërmarrjet pyeten për ecurinë e veprimtarisë se tyre, nevojat për financim dhe ngarkesën me borxh, marrëdhënien me bankat etj.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017, ndërmarrjet vlerësojnë se **konkurrenca** *dhe gjetja e tregut janë faktorët të cilët përfaqësojnë sfidat kryesore për veprimtarinë e tyre, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla. Problematikat lidhur me* **aksesin në financim,** *dhe* **kostot e financimit** *janë vlerësuar në rënie për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.*

Në lidhje me performancën, **ecuria e shitjeve** *vijon të vlerësohet në rritje gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2017, për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, dhe në rënie për ndërmarrjet e vogla. Në linjë me ecurinë e shitjeve, ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kanë vlerësuar rritje të* **rezultatit financiar** *dhe* **zgjerim të veprimtarisë** *gjatë periudhës. Në përgjithësi, pritshmëritë pozitive të ndërmarrjeve mbi shitjet, rezultatin financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë, vijojnë të japin sinjale optimiste për ecurinë e tyre në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.*

Gjatë periudhës, më shumë se gjysma e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura e **kanë financuar veprimtarinë e tyre përmes shitjeve. Huamarrja, si burim më vehte apo i kombinuar,,** *është përdorur nga 26.5% e ndërmarrjeve të mëdha, 23.5% e ndërmarrjeve të mesme dhe 15.7% e ndërmarrjeve të vogla.*

Rreth 42.3% e totalit të ndërmarrjeve (443 ndërmarrje gjithsej) pohojnë që kanë një **hua për të paguar**, *me peshë në rritje, krahasuar me rezultatet e vrojtimit të kaluar. Rezultati vlen për të tre grupet e ndërmarrjeve, por disi më i theksuar për ndërmarrjet e mesme. Rreth 91.3% e totalit të ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se u janë drejtuar* **bankave** *për të siguruar hua. Kjo peshë arrin në 93.3% për totalin e* **burimeve formale** *(banka dhe institucione financiare jobanka) dhe është rritur gjatë periudhës.*

Qëllimet kryesore të huamarrjes janë **kryerja e investimeve afatgjata** *dhe* **përballimi i shpenzimeve korrente**. *Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, rezulton se pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për të kryer investime afatgjata është rritur në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha, ndërkohë që ka shënuar rënie për ndërmarrjet e mesme. Rreth 78.7% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 83.8% e atyre të mesme dhe 80.6% e atyre të mëdha, e konsiderojnë* **të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes** *për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2017, kjo peshë rezulton në rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.*

Huamarrja e ndërmarrjeve kryhet vetëm në **monedhën vendase** *për 47.1% të totalit të ndërmarrjeve të vogla huamarrëse, 48.9% të ndërmarrjeve të mesme dhe 29.3% të ndërmarrjeve të mëdha. Huamarja në* **monedhën evropiane** *zë peshën kryesore për ndërmarrjet e mëdha, përkatësisht për 56.3% të tyre. Për ndërmarrjet e vogla kjo huamarrje zë 44.2%, ndërsa për ato të mesme 42.6%. Huamarrja* **në Dollarë amerikanë** *zë një peshë të vogël, duke mos i kaluar 2.9% të totalit (ndërmarrjet e vogla).* **Huamarrja e re** *gjatë gjashtëmujorit deklarohet vetëm nga 4.9% e ndërmarrjeve të vogla, 12.4% e ndërmarrjeve të mesme dhe 10.6% e ndërmarrjeve të mëdha.*

Vlera e përgjithshme e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për 79.8% të ndërmarrjeve huamarrëse. Të analizuara sipas madhësisë, rezulton që **ngarkesa e borxhit** *është më e lartë tek ndërmarrjet e vogla, ku rreth 21.1% e tyre deklarojnë se vlera e huasë është e barabartë ose më e madhe se vlera e kapitalit. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (81.9%) deklarojnë se* **pagesa e huasë ndaj të ardhurave** *arrin deri në 20% dhe kjo peshë është rritur krahasuar me periudhën e kaluar. Barra e pagesës së huasë duket se rëndon më tepër tek ndërmarrjet e vogla, ku numri i ndërmarrjeve që raportojnë se pagesa e huasë e kalon 20% të të ardhurave zë rreth 27.4% të totalit të grupit.*

HAPËSIRË INFORMUESE 4.2.1. VLERËSIMI I PERSISTENCËS NË PLANIFIKIMIN E HUAMARRJES

Qëllimi i kësaj hapësire informuese është të vlerësojë persistencën e planifikimit të huamarrjes për ndërmarrjet. Bazuar në të dhënat e vrojtimit "Mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve", për ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar qëllimin e tyre për të marrë kredi në periudhën e ardhshme, vlerësohet nëse ato kanë arritur ta marrin ose jo kredinë.

Të dhënat shtrihen në harkun kohor 6MII 2010 - 6MII 2017, duke marrë në konsideratë 14 periudha. Për secilin çift periudhash të njëpasnjëshme, përzgjidhen ndërmarrjet të cilat janë aktive në përgjigje në të dy kampionet, bazuar në NIPT-et e tyre. Për secilën prej tyre, vërehen përgjigjet e dhëna në periudhën "t" mbi planifikimin për të marrë një kredi bankare në gjashtëmujorin e ardhshëm dhe krahasohen me përgjigjen në periudhën "t+1", për të vlerësuar nëse realisht ndërmarrja ka marrë kredi.

Tabela në vijim prezanton, në formë matrice, alternativat e mundshme të kombinimit të dy pyetjeve mbi planifikimin e huamarrjes në periudhën "t" dhe realizimin e saj në periudhën "t+1". Vlerat e mundshme të vlerësimit luhaten nga "-1" në rast se ndërmarrja planifikon huamarrjen dhe nuk e realizon atë, në vlerësimin "1" në rast se nuk planifikon huamarrje, por gjithsesi merr kredi.

Tabelë 4.2. Matrica përmbledhëse e planifikimit të huamarrjes

Aktuale / Pritje	Ka marrë një kredi në 6M aktual	Nuk ka marrë një kredi në 6M aktual
Planifikon të marrë një kredi në 6M e ardhshëm	0.5	-1
Nuk planifikon të marrë një kredi në 6M e ardhshëm	1	-0.5

Për secilën periudhë është ndërtuar një mesatare e vlerësimit të koeficientëve sipas tabelës më lart, duke përfituar **Indeksin e Persistencës në Planifikim të Huamarrjes** *,për periudhën 2011-2017.*

Rezultatet tregojnë se mesatarja e treguesit për secilën periudhë është në nivele negative. Në periudhën e parë të vrojtimit, gjatë vitit 2011, treguesi rezulton rreth -0.8 (afër vlerës -1), çka nënkupton se ndërmarrjet të cilat planifikonin të merrnin kredi, nuk e kanë marrë atë. Bazuar në të dhënat e Aktivitetit Kreditues, në fillim të vitit 2011, bankat shtrënguan standardet e kreditimit me prirjen për t'i mbajtur të tilla

Grafik 4.7 Indeksi i persistencës në planifikimin e huamarrjes së ndërmarrjeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

deri në fund të vitit. Në lidhje me periudhën e dytë, pas vitit 2012, përgjithësisht vërehet një përmirësim gradual i treguesit, edhe pse ai mbetet negativ. Që prej 6MII 2014 e në vazhdim, vlera e tij luhatet midis -0.4 dhe -0.5, duke nënkuptuar se përgjithësisht ndërmarrjet nuk planifikonin të merrnin kredi dhe nuk e kanë marrë atë. Ky zhvillim reflekton praninë e një kërkese të dobët për kredi, por edhe vlerësimin më të saktë për një pjesë të rëndësishme të ndërmarrjeve, se niveli aktual i huamarrjes është i mjaftueshëm për zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

Për sa i përket vlerësimit të shpërndarjes së përgjigjeve të ndërmarrjeve brenda periudhës, është ndërtuar Indeksi Theil. Ky indeks është përdorur për të matur shkallën e shpërndarjes së përgjigjeve midis alternativave të mundshme të huamarrjes, dhe jep informacion mbi përqendrimin e përgjigjeve të ndërmarrjeve në njërën nga alternativat e dhëna.*

Indeksi Theil *llogaritet sipas formulës së mëposhtme:*

$$T_T = T_{a=1} = \frac{1}{N}\sum_{i=1}^{N}\left(\frac{x_i}{\bar{x}} \cdot \ln\frac{x_i}{\bar{x}}\right)$$

ku **N** *është numri i alternativave të përgjigjeve të pyetjes dhe* x_i *është pjesa e përgjigjeve të një alternative.*

Indeksi Theil merr vlera nga 0 në 1. Vlera më e vogël 0 nënkupton një shpërndarje të barabartë të përgjigjeve sipas të gjitha alternativave të pyetjes, duke treguar një pasiguri të lartë. Vlera më e lartë 1 përftohet nëse të gjitha ndërmarrjet kanë zgjedhur vetëm një alternativë, duke shprehur kështu pasigurinë më të ulët të mundshme.

Grafik 4.8 Indeksi Theil



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Siç vërehet në grafikun e mësipërm, mesatarja e këtij indeksi qëndron në nivelin 0.32, duke reflektuar heterogjenitet në përgjigje dhe praninë e pasigurisë së ndërmarrjeve në vlerësimin e mundësisë së huamarrjes. Në përgjithësi, indeksi luhatet pranë mesatares së tij historike për disa periudha, duke veçuar periudhën 6MII 2014 - 6MII 2015. Më tej, ndërmarrjet shprehin një pasiguri më të ulët krahasuar me periudhat e mëparshme, që prej 6MI 2016 e në vazhdim, duke shënuar një përmirësim të këtij treguesi. Në periudhën e fundit të vlerësimit, pra 6MII 2017, vlera e këtij treguesi shënon 0.43, duke treguar kështu një përqendrim më të lartë të përgjigjeve në njërën prej alternativave. Këto rezultate janë në përputhje edhe me treguesin e persistencës së planifikimit të huamarrjes, të ndërtuar më lart, i cili paraqitet i qëndrueshëm brenda të njëjtit harku kohor.

Procesi i huamarrjes *nga bankat vlerësohet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", ndërsa* ***rëndësia e marrëdhënies me bankat*** *vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme", për të tre grupet e ndërmarrjeve.*

Më shumë se gjysma e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura (53.6%) kanë deklaruar se ***nuk ka asnjë mundësi që të kërkojnë një kredi bankare*** *në gjashtëmujorin e ardhshëm. Kjo peshë rezulton në rritje për të treja grupet e ndërmarrjeve. Për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve ka pasur një rënie të peshës së atyre që pohojnë se* ***ka pak mundësi që të marrin një kredi*** *në periudhën pasardhëse.*

** Në vrojtim, ndërmarrjet pyeten: Sa është mundësia që ndërmarrja juaj të marrë një kredi bankare në 6 muajt e ardhshëm (rretho vetëm një)?*

1. *Nuk ka asnjë mundësi*
2. *Ka pak mundësi*
3. *Ka shumë mundësi*
4. *Është e sigurt*

4.2 TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

(30) Sektori bankar është i ekspozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë ndaj zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme[28] që përfshijnë ecurinë e ofertës dhe kërkesës, vëllimin e shitjeve dhe ecurinë e çmimeve në treg. Sipas të dhënave të INSTAT-it për fundin e vitit 2017, në tregun e pasurive të paluajtshme u raportua një rritje e qenësishme e sipërfaqes dhe numrit të lejeve të ndërtimit për objekte banimi. **Të dhënat e sektorit bankar për periudhën tregojnë një nivel pothuaj të pandryshuar të tepricës së kredisë për pasuri të paluajtshme, të shoqëruar me rënie të lehtë të normave të interesit të kësaj kredie dhe përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së saj.** Raporti i kredive me probleme për këtë lloj kredie ra në 7%, nga 8.3% në qershor 2017 dhe 8.8% një vit më parë. Teprica e kredisë për ndërtim ka shënuar rritje me 2% kundrejt muajit qershor 2017, por ra me 1% ndaj një viti më parë. Pesha e kësaj kredie zë 14% të tepricës së kredisë së bizneseve, duke mbetur dukshëm poshtë nivelit prej rreth 20% të regjistruar gjatë harkut kohor 2007–2011.

(31) Në fund të periudhës, **bankat raportuan një rritje minimale të kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme**, në nivelin 50.5% nga 50% gjashtë muaj më parë. Brenda kësaj ndarjeje, 63% e kredisë për individë dhe 46% e kredisë për biznese është e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme. Ky raport ka ardhur në rënie për individët dhe në rritje për bizneset.

Nga vrojtimi i aktivitetit kreditues të Bankës së Shqipërisë gjatë tremujorit të fundit të vitit 2017, rezultoi se kërkesa e individëve për kredi për pasuri të paluajtshme ka shfaqur rritje të dukshme, ndërkohë që kushtet për miratimin

28 Ekspozimi në këtë rast përfaqësohet nga kredia e dhënë për, ose e garantuar me pasuri të paluajtshme; kredia dhënë firmave të sektorit të ndërtimit; si edhe nga portofoli i pasurive të paluajtshme që është krijuar tek bankat, si rezultat i marrjes së kolateralit në pronësi, në vijim të procesit të ekzekutimit të detyrimit.

e kredisë raportohen të lehtësuara për individët dhe më të shtrënguara për bizneset[29].

Grafik 4.9 Kredia për blerje të pasurisë së paluajtshme dhe kosto e pagesës së kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.10 Raporti i kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(32) Norma mesatare e ponderuar e interesit për kredi për pasuri të paluajtshme[30] shënoi 4.4%, në rënie të lehtë gjatë periudhës, në linjë me prirjen rënëse të viteve të fundit[31]. Në të njëjtën linjë, kostoja relative e pagesës së kredisë[32] për blerje pasurie të paluajtshme ka rënë, duke reflektuar kushte më të lehtësuara për blerjen e pronave të paluajtshme nga këndvështrimi i huamarrësit.

[29] *Sipas Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues, T4 2017, bankat vlerësojnë se kërkesa e individëve për kredi është rritur lehtë për kredinë për blerje banese (balanca neto rezultoi pozitive, në 26.6%).*

[30] *Për të llogaritur këtë normë, bëhet peshimi i normës së interesit të kredisë për blerje pasurish të paluajtshme dhënë individëve me normën e interesit të kredisë për investime në pasuri të paluajtshme dhënë bizneseve.*

[31] *Mesatarja e normës së interesit për pasuri të paluajtshme gjatë viteve 2008-2013 ishte 8.7%.*

[32] *Kostoja relative e pagesës për blerje pasurie të paluajtshme është vlerësuar si diferencë midis normës së interesit të kredisë për pasuri të paluajtshme dhe normës mesatare të rritjes së çmimit të banesave për katër tremujorët e kaluar. Në rast se kjo diferencë vjen në rritje, atëherë kostoja relative vlerësohet në rritje dhe anasjelltas.*

HAPËSIRË INFORMUESE 4.3 PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË VROJTIMIT "TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME" DHE ECURIA E INDEKSIT TË ÇMIMIT TË BANESAVE PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2017

Vlerësimi i situatës në tregun e pasurive të paluajtshme bëhet përmes vrojtimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 agjentë imobiliarë (që tregtojnë pasuri të paluajtshme) dhe shoqëri ndërtimi, të cilët përfaqësojnë rreth 75-80% të popullatës së këtyre subjekteve për nga madhësia e aktivitetit. Banka e Shqipërisë realizon hartimin e pyetësorit si edhe hedhjen dhe përpunimin e rezultateve, ndërkohë që Instituti i Statistikave mbulon intervistimin në terren, proceset kryesore të kampionimit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar.

Në vrojtim, në përgjigje të pyetjes "Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjashtëmujorin) e mëparshme?", balanca neto e përgjigjeve prej -1.6%, tregon se numri i agjentëve që kanë dhënë përgjigje negative (më keq) dhe numri i atyre që dhanë përgjigje pozitive (më mirë) ishte pothuajse i njëjtë. Kjo vlerë e balancës, edhe pse negative, tregon një **përmirësim të dukshëm të vlerësimit të agjentëve për situatën e tregut, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar,** *kur balanca regjistroi -11.6%.*

Siç pritet, i njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje gjatë periudhës, paraqet një vlerësim dukshëm më pozitiv. Balanca neto e përgjigjeve mbi situatën e përgjithshme nga ana e subjekteve që kanë raportuar shitje është +34%.

Në fund të periudhës, **Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi shënoi një rritje të lehtë** *me 0.6%, në* **krahasim me nivelin e periudhës bazë që është viti 2013, dhe ra me 0.6% ndaj gjashtëmujorit të mëparshëm.** *Vëllimi i shitjeve të raportuara në zonën qendrore të Tiranës ishte shumë më i lartë se periudhat e mëparshme, ndërkohë që Indeksi i Çmimit për Tiranën ra me 1.4% ndaj periudhës bazë dhe u rrit me 0.7% ndaj periudhës paraardhëse. Për zonat bregdetare, agjentët kanë raportuar çmime mesatare 30% më të ulëta se në periudhën bazë dhe 7% më të ulëta se gjashtëmujori i kaluar. Për zonat e tjera*, agjentët kanë raportuar një rritje mesatare të çmimeve të shitjes me 5%, kundrejt periudhës së kaluar dhe rreth 20% më të larta se periudha bazë.*

Agjentët **raportojnë numër më të ulët banesash të regjistruara në librat e tyre***; balanca neto mes atyre që raportojnë rritje të numrit të banesave të regjistruara dhe atyre që raportojnë rënie të numrit të tyre, ishte -9.6%, nga një vlerë e lehtë pozitive periudhën e kaluar. Për pronat tregtare, balanca neto është gjithashtu negative (-17.9%, nga -3.8% në periudhën e kaluar). Numri i pronave të pashitura, si për banesat, ashtu edhe për godinat tregtare, ka shënuar rënie; balanca neto ishte pozitive, duke treguar më pak prona të pashitura, për herë të tretë rresht që nga koha e fillimit të vrojtimit, pavarësisht se me vlera më të moderuara në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar.*

Koha mesatare e shitjes së pronave në rang vendi raportohet të jetë mesatarisht 12.2 muaj ose rreth 2.3 muaj më e gjatë se në gjashtëmujorin e kaluar. *Për Tiranën, subjektet e intervistuara kanë raportuar një kohë mesatare shitjeje prej 8.2 muajsh. Kjo kohë shitjeje ishte më e shkurtër krahasuar me 9.5 muaj të raportuar në gjashtëmujorin e kaluar. Për zonën e bregdetit koha e shitjes është rritur ndjeshëm nga 11.7 muaj në rreth 19.3 muaj dhe e njëjta ecuri vlen edhe për zonat e tjera; subjektet kanë raportuar rritje të qenësishme të kohës së shitjes në krahasim me periudhën paraardhëse; nga 9.7 muaj në 14 muaj.*

Sipas agjentëve, rreth 80% e pronave për banim dhe e atyre për përdorim tregtar, të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. *Kjo shifër shënon rritje të lehtë në krahasim me vlerën prej 72% të raportuar në periudhën paraardhëse. Pjesa e çmimit të shitjes së pronës që është mbuluar me kredi (LTV) vlerësohet rreth 61%, më e ulët nga 64% në krahasim me periudhën e mëparshme.*

Agjentët kanë pritshmëri pozitive për ecurinë e tregut në territorin ku ata veprojnë për të ardhmen afatshkurtër dhe janë ndjeshëm më optimistë për periudhën më afatgjatë (deri në dy vjet). *Numri i pronave që pritet të regjistrohen për shitje gjatë periudhës në vazhdim, pritet të shënojë rënie. Agjentët presin rritje të çmimeve të pronave të paluajtshme. Balanca neto ishte pozitive (9.2%), duke reflektuar optimizëm nga ana e agjentëve. Kjo balancë ka vlerë të përafërt me atë të raportuara gjatë periudhës së kaluar (11.4%).*

** "Zona të tjera" përfshin të gjitha zonat përveç Tiranës dhe zonës së bregdetit.*

5. TREGJET FINANCIARE

5.1 TREGU I LETRAVE ME VLERË

(33) Gjatë periudhës, borxhi i emetuar në Lek nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ishte rreth 127 miliardë lekë, gati 32% më i ulët në krahasim me borxhin e emetuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, dhe 7% më i ulët në krahasim me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2016. Struktura e borxhit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në monedhën Lek, vijon të mbizotërohet nga bonot e thesarit (70%). Në fund të vitit, norma mesatare e ponderuar e interesit të borxhit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në Lek, ishte rreth 3%, duke ruajtur pothuajse të njëjtën vlerë me atë të fundit të gjashtëmujorit të parë dhe duke qenë rreth 0.5 pikë përqindjeje më e lartë ndaj një viti më parë. Gjatë periudhës, norma mesatare e interesit për bonot e thesarit ka rënë, ndërsa ajo për obligacionet është rritur.

Grafik 5.1 Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5.2 Përbërja e borxhit të emetuar gjatë 6MII 2015 - 6MII 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(34) Emetimet dhe norma mesatare e interesit të borxhit afatshkurtër të qeverisë shënuan rënie në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Emetimet e titujve të borxhit të qeverisë në formën e bonove të thesarit ishin rreth 90 miliardë lekë, ose rreth 32% më të ulëta se në gjashtëmujorin e kaluar dhe 12% më pak se një vit më parë. Brenda borxhit afatshkurtër, bonot me afat maturimi 12-mujor përbëjnë rreth 90% të totalit. Norma mesatare e interesit të bonove të thesarit për të tre maturitetet (3, 6 dhe 12 muaj) ka shënuar 2.4%, duke rënë lehtë nga gjashtëmujori i mëparshëm, dhe duke u rritur me 0.8

pikë përqindjeje ndaj gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016. Brenda periudhës, normat e interesit kanë pasur një ecuri rritëse, duke u ngjitur nga niveli 2.2% në korrik 2017, në rreth 2.7% në ankandet e fundit të vitit 2017. Në disa ankande të bonove të thesarit, kryesisht në ato të emetimeve 6-mujore, oferta për investim ka qenë më e ulët nga kërkesa për huamarrje ose shuma e shpallur nga qeveria.

Grafik 5.3 Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për 6MII 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5.4 Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për 6MII 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(35) Vlera e borxhit afatgjatë të qeverisë të emetuar gjatë periudhës ka qenë gjithashtu më e ulët në krahasim me një gjashtëmujor më parë, ndërsa normat e kthimit janë rritur për të gjitha maturitetet e emetuara në këtë periudhë. Emetimet e titujve të borxhit në formën e obligacioneve ishin rreth 37 miliardë lekë, ose 33% më pak se në gjashtëmujorin e kaluar, por 6% më shumë ndaj të njëjtës periudhe të një viti më parë. Rreth 85% e vëllimit të obligacioneve të emetuara përbëhet nga obligacionet me afat maturimi 2- dhe 5-vjeçar, me normë interesi të fiksuar. Norma mesatare e peshuar e interesit të obligacioneve në Lek për periudhën ishte 4.5%, ose 0.3 pikë përqindjeje më shumë se në gjashtëmujorin e kaluar dhe 0.4 pikë përqindjeje më shumë se një vit më parë. Rritja e normës së peshuar të interesit të obligacioneve në Lek për tre gjashtëmujorë rradhazi nuk rezultoi në kërkesë më të lartë për investim në këta tituj. Në disa ankande, oferta për investim ka qenë më e ulët sesa kërkesa për huamarrje.

Grafik 5.5 Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e bonove të thesarit në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5.6 Vëllimi dhe norma mesatare e obligacioneve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(36) Në fillim të vitit, qeveria riemetoi në tregun e brendshëm borxh afatmesëm në Euro, në formën e obligacioneve 2-vjeçare. Ky ishte emetimi i vetëm në Euro për gjysmën e dytë të vitit 2017, dhe përfaqëson rreth 4.2% të borxhit të brendshëm të emetuar gjatë periudhës. Borxhi në Euro i emetuar ishte rreth 39.6 milionë Euro dhe norma e kthimit ishte rreth 0.8%.

Grafik 5.7 Huamarrja e brendshme në Euro



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.2 TREGU NDËRBANKAR

(37) Gjatë periudhës, vëllimi mesatar i transaksioneve në tregun ndërbankar shënoi rritje në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, ndërkohë që normat e interesit qëndruan pranë nivelit të normës bazë të interesit. Mbajtja e pandryshuar e normës bazë gjatë periudhës, ka favorizuar stabilizimin në nivele të ulëta të normave të interesit në tregun ndërbankar. Bankat kanë tregtuar përgjithësisht në vëllime më të ulëta, me norma interesi që kanë qenë vazhdimisht nën ose pranë nivelit të normës bazë, duke reflektuar një situatë të qëndrueshme të likuiditetit. Në gjashtëmujorin e dytë, norma mesatare e interesit për transaksionet ndërbankare me afat 1-ditor tregoi rritje të lehtë ndaj mesatares së gjashtëmujorit të kaluar, duke shënuar nivelin 1.24%. Norma mesatare e interesit për transaksionet 7-ditore ishte 1.28%, pothuaj e pandryshuar nga norma mesatare e gjashtëmujorit të parë të vitit. Vëllimi mesatar i huamarrjes 1-ditore shënoi një rritje prej 19% ndaj gjashtëmujorit të

Grafik 5.8 Normat e interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5.9 Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

kaluar. E njëjta ecuri u konstatua edhe në vëllimin mesatar të transaksioneve 7-ditore, në rritje me 18% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Rritje të lehtë gjatë kësaj periudhe ka regjistruar edhe huamarrja me afat maturimi 1-mujor, megjithatë ky instrument përdoret rrallë dhe në vëllime më të vogla, në krahasim me instrumentet e huamarrjes me afat më të shkurtër.

5.3 TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

(38) Gjatë periudhës, kursi i këmbimit të Lekut ndaj Euros mbeti pothuaj i pandryshuar, duke shfaqur një dobësim shumë të lehtë (0.05%), dhe u forcua ndaj Dollarit amerikan (5.1%). Në terma mesatarë gjashtëmujorë, në krahasim me një vit më parë, monedha vendase është forcuar ndaj të dyja monedhave të lartpërmendura: 1.4% ndaj Euros dhe 9.3% ndaj Dollarit amerikan.

6. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE

(39) Gjatë periudhës, infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet, duke mbështetur qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe zbatimin e politikës monetare. Në terma të aktivitetit të procesimit, në sistemin AIPS u kleruan 63,885 pagesa me një vlerë prej 4,097 miliardë lekësh, gjatë

Grafik 6.1 Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH për gjashtëmujorin e dytë 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë.

periudhës. Numri i transaksioneve është rritur me 3.45%, ndërsa vlera e transaksioneve ka pësuar një rënie prej 6.36%, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit. Paralelisht, në sistemin e pagesave me vlerë të vogël AECH, gjatë periudhës, janë kleruar 294,068 pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 177,000 lekësh. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit, aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar rritje si në numër ashtu edhe në vlerë transaksionesh, me përkatësisht 13.4% dhe 13.7%.

(40) Në lidhje me instrumentet e pagesave, janë kryer rreth 7 milionë pagesa me një vlerë totale prej 2,350 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje të numrit të transaksioneve me 10% krahasuar me

Grafik 6.2 Ecuria e instrumenteve të pagesave në sasi dhe në vlerë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

gjashtëmujorin e parë të vitit. Transfertat e kreditit vijojnë të mbizotërojnë në instrumentet e pagesave, por pesha e këtij instrumenti ka rënë, për shkak të rënies në numër dhe në vlerë të këtyre instrumenteve në formën "letër". Nga ana tjetër, është vënë re një rritje e numrit dhe vlerës së transfertave të kreditit në formën "joletër"[33], si dhe një rritje e numrit dhe vlerës së transaksioneve të kryera me karta.

[33] *Internet banking dhe mobile banking.*

7. SISTEMI FINANCIAR

(41) Veprimtaria e sistemit financiar është zgjeruar gjatë periudhës. Raporti i aktiveve të sistemit financiar[34] ndaj PBB-së vlerësohet të jetë rritur me 0.5 pikë përqindje gjatë periudhës, duke u ngjitur në 102.6%. Rritja e peshës së sistemit financiar ndaj PBB-së ka ardhur si pasojë e zgjerimit të aktiveve të pothuaj të gjitha segmenteve përbërëse të sistemit, ndër të cilat mund të veçohen institucionet financiare jobanka, shoqëritë e sigurimit dhe fondet e investimeve. Rritja relative e këtyre tre segmenteve të marra së bashku, ishte më e lartë se rritja e PBB-së. Struktura e aktiveve të sistemit financiar mbizotërohet nga bankat, aktivet e të cilave zënë rreth 93% të aktiveve të sistemit. Gjatë periudhës, pesha e bankave në sistemin financiar ka shënuar rritje.

Tabelë 7.1 Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite

Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës	Sistemi financiar	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Banka e Shqipërisë	Sektori bankar	84.7	89.6	90.5	91.7	91.3	94.9	92.5
	Institucione jobanka	2.5	2.7	2.5	2.7	2.7	2.9	2.9
	SHKK dhe Unionet e tyre	0.7	0.8	0.8	0.8	0.7	0.6	0.5
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.5	1.6	1.6	1.7	1.9	2.1	1.9
	Fondet e pensionit	0.01	0.02	0.03	0.04	0.1	0.1	0.1
	Fonde Investimi		1.21	3.7	4.5	4.7	4.4	4.7
Ndërmjetësimi financiar		89.41	95.93	99.13	101.44	101.3	105.1	102.6

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

(42) Në fund të periudhës, pesha e aktiveve të sektorit bankar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) u vlerësua në 92.5%. Kjo peshë ka ardhur në rritje gjatë periudhës, e ndikuar nga zgjerimi i veprimeve ndërbankare dhe tkurrja e fondit të provigjioneve. Në terma të treguesve të shëndetit financiar, sektori bankar u karakterizua nga nivele më të larta kapitalizimi, përfitueshmërie dhe likuiditeti. Sektori jobankar ka ruajtur peshën ndaj PBB-së dhe në veprimtarinë e tij kanë kontribuuar pozivitisht pothuajse të gjitha segmentet përbërëse. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar vlerësohet i ulët, ndërkohë që, performanca e sektorit bankar mbetet me rëndësi kritike për aktivitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit jobankar. Në strukturën e aktiveve të sektorit jobankar, investimet në titujt e

Grafik 7.2 Rritja vjetore e aktiveve të segmenteve përbërës të sistemit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

[34] *Sistemi financiar përbëhet nga bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK), shoqëritë e sigurimit, fondet e pensioneve suplementare, si dhe fonde të investimit. Në analizën e këtij kapitulli, konsideroni që bilanci i shoqërive të sigurimit dhe institucioneve financiare jobanka i përket tremujorit të tretë të vitit 2017 dhe për subjektet e tjera raportimi i përket fundit të vitit 2017.*

borxhit të qeverisë zënë një peshë të konsiderueshme dhe kanë ardhur në rritje gjatë vitit 2017.

7.1 ZHVILLIMET NË SEKTORIN JOBANKAR

Institucionet që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë

(43) Gjatë tremujorit të tretë të vitit, Institucionet Financiare Jobanka (IFJB) shënuan zgjerim të aktivitetit dhe tregues të mirë të performancës financiare. Konkretisht, rritja e aktiveve u mbështet kryesisht nga zgjerimi i aktivitetit kreditues dhe i zërit "arka dhe llogari të tjera të arkëtueshme" ("të tjera"), ndërkohë që investimet në banka ruajtën nivelet e një tremujori më parë. Rezultati financiar i IFJB-ve ishte pozitiv, por më i ulët se një vit më parë. Kapitalizimi i veprimtarisë mbetet i kënaqshëm, megjithatë cilësia e aktiveve ka ardhur në rënie. Gjatë periudhës, sistemi financiar përmbante 28 IFJB të angazhuara kryesisht në fushën e mikrokredisë, kreditimit, qirasë financiare, faktoringut dhe parasë elektronike. Peshën kryesore e zënë IFJB-të që kryejnë aktivitet kreditues, ndjekur nga ato të pagesave dhe transfertave. Aktivet e IFJB-ve shënuan 45 miliardë lekë, në rritje me 5.2% ndaj gjysmës së parë të vitit 2017, dhe 7.3% në terma vjetorë. Peshën kryesore në strukturën e aktiveve e zënë "veprimet me klientë" që përfaqësojnë aktivitetin kreditues, ndjekur nga investimet në banka, në formën e depozitave dhe llogarive rrjedhëse. Rreth 84% e portofolit të kredisë së IFJB-ve përbëhet nga kredia e marrë nga bizneset, të cilat veprojnë kryesisht në sektorin e tregtisë (22%) dhe bujqësisë (14%). Rezultati financiar i IFJB-ve ishte pozitiv për rreth 1.2 miliardë lekë, dhe shënoi një rënie të lehtë ndaj një viti më parë (1.3 miliardë lekë).

Grafik 7.3 Struktura e IFJB-ve sipas llojit të aktivitetit që kryejnë



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 7.4 Struktura e aktivit të IFJB-ve



Burimi: Banka e Shqipërisë

(44) Ecuria e aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit ka qenë pozitive gjatë periudhës, por në krahasim me një vit më parë aktiviteti i tyre është tkurrur. Rritja në aktivet e shoqërive të kursim-kreditit gjatë periudhës është përcaktuar nga rritja në llogaritë rrjedhëse, depozitat dhe kredinë neto, ndërkohë që edhe portofoli i bonove të thesarit të mbajtura nga këto subjekte ka ardhur duke u zgjeruar. Rezultati financiar i SHKK-ve ishte pozitiv (0.08 miliardë lekë) dhe ndjeshëm më i lartë ndaj një viti më parë. Kreditë për anëtarët dhe investimet në banka përfaqësojnë zërat kryesorë të aktivit të këtyre institucioneve. Gjatë periudhës, në treg operuan 13 shoqëri aktive të kursim-kreditit.

Grafik 7.5 Struktura e aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Institucione që mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

(45) Aktiviteti i shoqërive të sigurimit u zgjerua gjatë periudhës. Aktivet e 12 shoqërive të sigurimit[35] shënuan rritje me 1.6%, duke u ngjitur në 30.3 miliardë lekë. Rritja e investimeve në formën e depozitave me afat në banka dhe në titujt e borxhit të qeverisë përcaktuan sjelljen e aktiveve të shoqërive të sigurimit. Shoqëritë e sigurimit raportuan rezultat financiar pozitiv dhe në rritje në terma vjetorë.

Grafik 7.6 Struktura e aktiveve të shoqërive të sigurimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në veprimtarinë e sigurimeve, të ardhurat nga primet (që paguhen paraprakisht) përdoren për pagesat e detyrimeve dhe mbulimin e kostove që mund të rrjedhin kur ndodh ngjarja për të cilën është kryer sigurimi. Primet e shkruara bruto[36], që përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit të shoqërive të sigurimit, u zgjeruan me 5.4% në terma vjetorë. Pjesa më e madhe e vlerës së primeve të shkruara bruto përbëhet nga primet e sigurimeve të "jojetës" me rreth 92.6%, kundrejt 7.4% të sigurimeve të "jetës".

Treguesi i depërtimit të tregut të sigurimeve, i matur si raporti i primeve ndaj PBB-së, është rreth 1%, ndërkohë që mesatarja e vendeve të rajonit shkon në 2.24% dhe mesatarja e Evropës arrin në 7.4%. Treguesi i humbjeve ose raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara bruto u rrit në 34.1% nga 27.6% një vit më parë. Vlera e dëmeve të paguara bruto u rrit me 15.8% në terma vjetorë në nivelin 5.5 miliardë lekë.

[35] *8 shoqëri sigurimi të jojetës, 3 shoqëri sigurimi të jetës dhe 1 shoqëri risigurimi.*
[36] *AMF, Buletini Statistikor "Tregu i Sigurimeve: Viti 2017", publikuar më 25 janar 2018.*

(46) Aktiviteti i fondeve të investimit[37] u zgjerua, si rezultat i rritjes së investimeve në banka dhe në titujt e borxhit të qeverisë. Fondi i investimeve është një sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur, e krijuar në bazë të një kontrate, nëpërmjet ofertës publike të kuotave[38]. Aktivet e fondit investohen sipas parimit të diversifikimit të rreziqeve. Norma e kthimit nga pjesëmarrja e investitorëve në fondet e investimit është zakonisht më e lartë se ajo e depozitave në banka, duke reflektuar profilin më të lartë të rrezikut[39], që ka pranuar investitori për pjesëmarrjen në fond. Në sistemin financiar shqiptar operojnë aktualisht 3 fonde investimi. Aktivet e këtyre fondeve investohen kryesisht në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në Lek dhe të tjera në Euro.

Grafik 7.7 Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.8 Struktura e investimeve të fondeve të pensioneve private suplementare



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Sipas të dhënave paraprake të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në fund të vitit 2017, vlera neto e aktiveve të fondeve të investimit vlerësohet në rreth 72.7 miliardë lekë ose sa rreth 4.7% e PBB-së së vendit.

(47) Edhe fondet e pensioneve private suplementare[40] kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre gjatë periudhës. Në Shqipëri veprojnë 3 fonde pensionesh private vullnetare. Në fund të vitit 2017, aktivet e këtyre fondeve shënuan vlerën 1.7 miliardë lekë ose 30.5% më shumë se një vit më parë. Aktiviteti i fondeve të pensionit mbizotërohet nga investime në titujt e borxhit të qeverisë. Vlera e këtyre investimeve ishte rreth 1.6 miliardë lekë ose 30.7% më shumë në terma vjetorë. Sipas raportimeve të fundit, numri i anëtarëve të fondeve të pensionit ishte rreth 21 mijë.

[37] *AMF, "Të dhëna të përgjithshme të fondeve të investimeve", 31 dhjetor 2017.*
[38] *Ligji, nr.10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", AMF.*
[39] *Investimet në një fond investimi garantohen vetëm nga performanca e fondit, siç tregohet në dokumentin e prospektit për investitorët.*
[40] *AMF, Raporti Statistikor "Tregu i Pensioneve Private Vullnetare", 31 dhjetor 2017, publikuar më 13 shkurt 2018.*

7.2 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE EKSPOZIMEVE TË SEKTORIT JOBANKAR

(48) Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar në vend mbetet i ulët. Ky ekspozim, në krahun e aktivit të bankave përfaqësohet nga huatë dhe pjesëmarrja në kapital në institucionet financiare jobankare, ndërsa në krahun e detyrimeve paraqitet në formën e fondeve të mbledhura prej tyre (llogarive të ndryshme). Në total, ky ekspozim zë vetëm 2% të vlerës së aktiveve të sektorit bankar.

(49) Nga ana tjetër, ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë. Në total, ky ekspozim përbën 17.8% të aktiveve të sektorit jobankar, nga 20.9% në fund të vitit 2016. Rënia e normave të interesit në treg ka nxitur institucionet e sektorit jobankar të investojnë në produkte me kthime më të larta si titujt e borxhit të qeverisë, gjë që ka rezultuar në rënie të peshës së investimeve të këtyre subjekteve në produkte bankare. Pavarësisht kësaj ecurie, në nivel individual, shoqëritë e sigurimit dhe institucionet financiare jobanka shfaqin ekspozim më të madh ndaj sektorit bankar, pasi vendosjet e tyre në formën e depozitave dhe të tjera, përbëjnë përkatësisht 32.2% dhe 21.3% të aktiveve përkatëse. Fondet e pensioneve dhe shoqërive të kursim-kreditit paraqesin gjithashtu ekspozim në rritje ndaj

Grafik 7.9 Ekspozimi i institucioneve kryesore jobankare ndaj sektorit bankar, në raport me totalin e aktiveve të tyre



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përpunime nga Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.10 Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në titujt e qeverisë, ndaj totalit të aktiveve të tyre



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përpunime nga Banka e Shqipërisë.

sektorit bankar.

(50) Institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit, duke qenë aktive në kredidhënie, janë kryesisht të ekspozuara ndaj rrezikut të kredisë. Në shtator të vitit 2017, raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave të jobankave arriti në 12.5% nga 11.6% në fundin e vitit 2016, ndërsa për SHKK-të treguesi i cilësisë së kredisë u përmirësua, duke shënuar 4.8%, nga 6.7% në fund të vitit 2016.

(51) Rreziku i tregut është një rrezik që prek investimet e fondeve të investimeve dhe fondeve të pensioneve private suplementare. Për fondet e investimeve, *rreziku i tregut*, i ardhur kryesisht nga luhatja e normave të interesit, përbën rrezikun kryesor të veprimtarisë, së bashku me rrezikun e likuiditetit. Aktivet e fondeve investohen në instrumente financiare, çmimi i të cilave mund të ndryshojë çdo ditë. Në strukturën e investimeve të tyre, rreth 80% e totalit i takon bonove të thesarit dhe obligacioneve të qeverisë. Lëvizjet e normës së interesit janë të lidhura në mënyrë të zhdrejtë me vlerën e këtyre titujve. Në rastin e një rritjeje në normat e interesit, një rivlerësim i portofolit të titujve që mbajnë fondet e investimit, do të rezultonte në një rënie të vlerës së këtij portofoli dhe anasjelltas. Me rëndësi në këtë rast është kohëzgjatja e investimeve, duke kuptuar që sa më e gjatë ajo aq më e ndjeshme është vlera e fondit, si rezultat i lëvizjeve në normën e interesit.

(52) Fondet e pensioneve private suplementare mbështeten në plane me kontribute të përcaktuara (dhe përfitime sipas performancës). Në këto raste, ndikimi i normës së interesit është më i kufizuar, në krahasim me rastin kur fondet do të ishin me përftime të përcaktuara. Në totalin e investimeve të tyre, peshën mbizotëruese (gati 100%) e zënë investimet në bono thesari dhe obligacione të qeverisë dhe, në periudha të caktuara, depozitat bankare. Burimi kryesor i të ardhurave të fondeve të pensioneve private suplementare janë interesat e përftuara nga këto investime.

8. ZHVILLIMET NË SEKTORIN BANKAR

(53) Gjatë periudhës, sektori bankar zgjeroi veprimtarinë me kontributin kryesor nga veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare, si edhe nga tkurrja e fondit të provigjioneve për rrezikun e kreditit. Sektori bankar u karakterizua nga një nivel i mirë kapitalizimi, likuiditeti dhe përfitueshmërie. Vijimi i procesit të largimit të kredive të humbura nga bilancet e bankave dhe niveli i rritur i shlyerjeve e ristrukturimeve, kanë ndikuar në uljen e nivelit të huave me probleme. Pavarësisht këtij zhvillimi, rreziku i kreditit duhet të vijojë të vlerësohet me kujdes. Ekspozimi ndaj rreziqeve të tregut paraqitet në nivele të kufizuara, por ka nevojë të monitorohet në vijimësi.

8.1 ECURIA E AKTIVITETIT BANKAR

(54) Gjatë periudhës, sektori bankar zgjeroi veprimtarinë, por ritmi i rritjes ishte më i ulët në terma vjetorë. Aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 4%, duke arritur në nivelin 1,445 miliardë lekë. Ecuria e aktiveve u përcaktua nga rritja e zërave "Veprime me thesarin dhe ndërbankare"[41] dhe "Veprime me klientët"[42], si dhe nga tkurrja e ndjeshme e fondit të provigjioneve për rrezikun e kreditit. Kontribut pozitiv, por modest, në ecurinë e aktiveve, dhanë "Veprimet me letrat me vlerë"[43], kryesisht me subjektet jorezidente. Në anën e pasivit, zërat kryesorë vijojnë të mbeten "Veprimet me klientë", që përfaqësojnë aktivitetin depozitues, dhe "Burimet e përhershme", që përfaqësojnë fondet e veta (kapitalin) të bankave. Zotërimet e sektorit bankar në titujt e borxhit të qeverisë shqiptare përfaqësojnë rreth 22% të totalit të aktivit, nga 23% që ishin një gjashtëmujor më parë. Në portofolin e titujve të qeverisë, pjesa e bonove të thesarit u zgjerua më tej.[44] Në terma vjetorë, norma e rritjes së totalit të aktiveve

[41] *Veprimet me thesarin dhe ndërbankare shënuan rritje gjashtëmujore me rreth 30 miliardë lekë, në nivelin 483 miliardë lekë. Kontributin kryesor në zgjerimin e këtij zëri e dha rritja e transaksioneve të bankave me Bankën Qendrore në formën e llogarive rrjedhëse. Ato u rritën me rreth 19 miliardë lekë, në nivelin 150 miliardë lekë. Kontribut pozitiv gjithashtu ka dhënë zgjerimi i veprimeve ndërbankare në formën e llogarive rrjedhëse dhe depozitave, të cilat u zgjeruan respektivisht me 4 dhe 7 miliardë lekë, në nivelet 61 miliardë lekë dhe 119 miliardë lekë.*

[42] *Veprimet me klientë u zgjeruan me rreth 5 miliardë lekë, në nivelin 598 miliardë lekë. Veprimet me klientë rezidentë u rritën me rreth 8 miliardë lekë, ndërsa ato me klientë jorezidentë ranë me rreth 5 miliardë lekë.*

[43] *Investimet në letrat me vlerë ruajtën pothuajse nivelet e një gjashtëmujori më parë. Ato u zgjeruan me vetëm 180 milionë lekë, në nivelin 357 miliardë lekë. Këto investime ishin kryesisht në formën e letrave me vlerë të vendosjes, me jorezidentët në valutë.*

[44] *E gjithë rritja e investimeve në titujt e borxhit të qeverisë erdhi nga zgjerimi i portofolit të bonove të thesarit. Në gjysmën e dytë të vitit 2017, portofoli i bonove të thesarit u zgjerua me rreth 3 miliardë lekë, krahasuar me muajin qershorin të 2017-ës, duke arritur në nivelin 64 miliardë lekë, ndërkohë që portofoli i obligacioneve shënoi rënie të lehtë dhe ka një vlerë prej 255 miliardë lekësh.*

të sektorit bankar shënoi vlerën 2.8%. Zgjerimi i aktiveve në terma vjetorë u mbështet nga investimet ndërbankare dhe tkurrja e fondit të provigjioneve, ndërkohë që veprimet me letrat me vlerë dhanë kontribut negativ në rritjen vjetore të aktiveve.

Tabelë 8.1 Struktura e bilancit të bankave, dhjetor 2017

Aktivi	% e aktiveve	Ndryshimi vjetor,%	Pasivi	% e pasiveve	Ndryshimi vjetor,%
I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	33.4	4.5	I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	5.3	24.1
II. Veprime me klientët (Kredia)	41.4	0.2	II. Veprime me klientët (Depozita)	80.4	0.8
Nga e cila: për sektorin publik	2.2	13.2	Nga të cilat: të sektorit publik	1.9	-6.4
Nga e cila: për sektorin privat	39.1	-0.8	Nga të cilat: të sektorit privat	78.8	0.9
III. Veprimet me letrat me vlerë	24.7	-3.1	III. Veprimet me letrat me vlerë	0.6	23.2
IV. Fonde rezervë të krijuara	-4.03	-26.8	IV. Detyrime të tjera	1.04	14.3
V. Të tjera*	4.5	11.2	V. Burimet e përhershme	12.4	7.3
			Nga të cilat: Borxhi i varur	1.5	-1.2
			Nga të cilat: Kapitali aksioner	10.2	7.7
Totali i aktiveve	100	2.8	Totali i pasiveve	100	2.8

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

* *Tek zëri "Të tjera" në bilanc përfshihen "Mjete të tjera", "Mjete të qëndrueshme" dhe "Interesa të përllogaritura".*

(55) Portofoli i kredisë[45] së sektorit bankar është zgjeruar me rreth 1% në terma gjashtëmujorë dhe ka mbetur pothuajse i pandryshuar ndaj një viti më parë, në nivelin rreth 600 miliardë lekë. Përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë, rezultat i procesit të vazhdueshëm të fshirjes së huave të humbura dhe shlyerjeve, ka sjellë rënie të fondit të provigjionimit për periudhën.

(56) Financimi i aktivitetit bankar sigurohet kryesisht nga depozitat, të cilat përbëjnë rreth 80% të totalit të aktiveve. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat kanë vijuar të përcaktojnë zgjerimin e bazës së depozitave, ndonëse zgjerimi i tyre ka qenë me ritme më të ulëta. Ndryshimi i strukturës së burimeve të financimit drejt atyre afatshkurtra, ndikon në aftësinë e sektorit bankar për ndërmjetësimin financiar drejt projekteve më afatgjata. Sidoqoftë, varësia nga burimet afatshkurtra të financimit (llogari rrjedhëse dhe depozita pa afat, që aktualisht përfaqësojnë 42% të bazës së depozitave[46]), zbutet nga fakti që 83% e vëllimit të depozitave mbahet nga individët, dhe, në tërësi, maturiteti i mbetur i pasiveve ka ardhur në rritje, për shkak të rritjes së nivelit të depozitave me afat maturimi mbi 1 vit. Bankat kanë ruajtur raportin e përdorimit të kapitalit të tyre për financimin e veprimtarisë, duke respektuar kërkesat përkatëse të kuadrit rregullativ.

(57) Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një përqendrim i lartë për disa nga aktivitetet e tij. Në grafikun e 8.1 majtas, tregohen produktet bankare (në aktiv dhe në pasiv të bankave), për të cilat sektori bankar paraqet një përqendrim të moderuar ose të ulët. Midis këtyre produkteve, kredia në Lek dhe kredia për bizneset kanë regjistruar një rritje të shkallës së përqendrimit

[45] *Pa përfshirë interesat e përllogaritura.*

[46] *Në dhjetor 2017, pesha e llogarive rrjedhëse ishte rreth 33%, ndërsa e depozitave pa afat rreth 9%. Një vit më parë këto pesha ishin përkatësisht 32% dhe 8%.*

gjatë vitit 2017. Në grafikun 8.1 djathtas, tregohen aktivitetet për të cilat sektori bankar shfaq një përqendrim më të lartë, kryesisht në anën e aktivit të bilancit të sektorit bankar. Niveli më i lartë i përqendrimit vërehet në aktivitetin e huadhënies për institucionet financiare. Koeficienti i lartë i përqendrimit reflekton aktivitetin e një numri të kufizuar bankash me institucione financiare jorezidente.

Grafik 8.1 Treguesi Herfindahl për produktet kryesore bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë.

8.2 POZICIONI I SEKTORIT BANKAR NDAJ JOREZIDENTËVE

(58) Gjatë periudhës, sektori bankar ka ngushtuar lehtë pozicionin kreditor me subjektet jorezidente. Në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të parë, pozicioni neto me subjektet jorezidente, në fund të vitit 2017, ishte disi më i vogël, duke shënuar rreth 295 miliardë lekë. Detyrimet ndaj jorezidentëve zënë rreth 6% të totalit të aktiveve dhe përfaqësohen, në masën më të madhe, nga "Veprimet me klientët" ose nga depozita të jorezidentëve në bankat vendase, si edhe nga "Burimet e përhershme" ose fondet e veta. Veprimet ndërbankare në formën e depozitave dhe huave nga institucionet financiare jorezidente, kanë shënuar rritje gjatë periudhës, ndërsa linjat e kredisë nga bankat mëma kanë rënë. Në anën e aktiveve të sektorit bankar, pretendimet ndaj jorezidentëve zënë rreth 26% të totalit të aktiveve. Gjatë gjashtëmujorit këto pretendime shënuan një rritje të lehtë dhe në fund të vitit, ato shënonin nivelin 380 miliardë lekë. Në fund të periudhës, rritja vjetore e aktiveve me jorezidentët ka shënuar ngadalësim të konsiderueshëm, duke rënë në 1%, nga rreth 16% një vit më parë. Kontributin kryesor në rënien e ritmit të rritjes së pretendimeve ndaj jorezidentëve e ka dhënë tkurrja e investimeve në tituj të emetuar nga subjekte jorezidente dhe ulja e kredisë dhënë jorezidentëve. Nga ana tjetër, rritja në zërin "Veprime ndërbankare" me jorezidentët ka ndikuar në rritjen e pretendimeve të përgjithshme ndaj jorezidentëve.

Grafik 8.2 Kontributi i zërave në rritjen vjetore të aktiveve me jorezidentët (në pp)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.3 Përbërësit e detyrimeve jorezidente



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(59) Masat me natyrë kundërciklike të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në maj të vitit 2013, kanë ndikuar në zbutjen e ritmit të rritjes së investimeve të sektorit bankar pranë subjekteve jorezidente. Në fund të vitit 2017, rritja vjetore zbriti në nivelin më të ulët historik prej 1%, krahasuar me 25% që shënonte në maj 2013. Viti 2017 u karakterizua nga luhatje të konsiderueshme në ritmin e investimeve me jashtë. Rritja e investimeve me jashtë shënoi nivele relativisht të larta gjatë gjysmës së parë të vitit (rreth 22% në janar 2017), por kjo prirje u zbut ndjeshëm gjatë dy tremujorëve të fundit. Pesha e aktiveve me jorezidentët, të cilat janë objekt i masave kundërciklike[47], u ngjit në 81% të totalit të aktiveve me jorezidentët, nga 80% një vit më parë. Brenda grupit të aktiveve me jorezidentët, të cilat janë objekt i masave të sipërpërmendura, vërehet një zgjerim i veprimeve me thesarin dhe ndërbankare prej 17%, ku kontributin kryesor e ka dhënë rritja e zërit "Depozita me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare" prej 42% në terma vjetorë. Nga ana tjetër, ritmi vjetor i rritjes së aktiveve me jorezidentët, që nuk janë objekt i masave kundërciklike, u ngushtua me 7%.

8.3 ZHVILLIMET NË KREDITIM

8.3.1 TEPRICA E KREDISË

(60) Gjatë periudhës, teprica e kredisë në bilancin e sektorit bankar shënoi një rritje të lehtë. Në fund të muajit dhjetor të vitit 2017, teprica e kredisë në bilancin e sektorit bankar shënoi nivelin 600 miliardë lekë[48], duke qenë rreth 0.6% më e lartë (ose 3.6 miliardë lekë), në krahasim me nivelin e qershorit

[47] *Aktivet jorezidente në valutë që janë objekt i masave lidhen kryesisht me investimet në letrat me vlerë dhe veprimet me thesarin dhe ndërbankare.*

[48] *Përfshirë edhe interesat e përllogaritura. Pa to, teprica e kredisë vlerësohet në rreth 598 miliardë lekë.*

2017. Ndaj një viti më parë, teprica e kredisë u rrit lehtë, me rreth 1 miliardë lekë. Në këtë zhvillim, ka ndikuar pozitivisht vëllimi më i lartë i kredive të reja, ndërsa veprimet për uljen e stokut të kredive me probleme (shlyerjet, ristrukturimi dhe fshirja e kredive të humbura), si edhe efekti i kursit të këmbimit, i reflektuar në vlerësimin e Lekut ndaj monedhave USD dhe Euro, kanë dhënë efekt negativ në rritjen e tepricës së kredisë. w

Tabelë 8.2 Ecuria e kredisë

	Treguesi dhe njësia	Vlera (miliardë lekë)	Pesha ndaj totalit të kredisë %		Ndryshimi	
	Periudha	12/2017	12/2017	12/2016	Vjetor	Gjashtëmujor
Sipas valutës	Kredia në Lek	262	44%	41%	5%	2%
	Kredia në valutë	339	56%	59%	-4%	-1%
Sipas subjekteve	Sektori publik	32	5%	5%	13%	7%
	Biznese	390	65%	67%	-3%	-1%
	Individë	178	30%	28%	6%	3%
Sipas produktit	Afatshkurtër	186	31%	32%	-2%	1%
	Afatmesëm	110	18%	20%	-1%	-8%
	Afatgjatë	305	51%	48%	6%	4%
	Teprica e kredisë	601	100%	100%	0.2%	0.6%

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(61) Sipas monedhës, kontribut pozitiv në ecurinë e kredisë ka dhënë vetëm kredia në Lek. Në fakt, stoku i kredisë në Lek u rrit gjatë periudhës me 2.2% (ose 5.4 miliardë lekë), ndërsa stoku në valutë u tkurr me rreth 1% (ose 1.9 miliardë lekë). Për shkak të peshës së konsiderueshme të kredisë në valutë (56%), zhvillimet në kursin e këmbimit luajnë një rol të rëndësishëm në kundërvlerën nominale të saj në monedhën vendase. Për tepricën e llogaritur në dhjetor të vitit 2017, vlerësimi i kursit të këmbimit të Lekut ndaj valutave kryesore ka ndikuar në pakësimin e vlerës së raportuar të kredisë me rreth 0.7 miliardë lekë. Duke përjashtuar këtë efekt, kredia në valutë do të ishte zgjeruar

Grafik 8.4 Ecuria e kredisë sipas afatit, rritje vjetore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.5 Ecuria e kredisë sipas monedhës, rritje vjetore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

me 0.5% (nga rënia prej 0.6%)[49]. Në terma vjetorë, efekti i kursit të këmbimit për monedhat USD dhe Euro vlerësohet përkatësisht -4.8 miliardë lekë dhe -4.6 miliardë lekë. Në mungesë të efektit të kursit të këmbimit, rritja vjetore e tepricës së kredisë do të ishte rreth 2% (nga 0%) dhe e kredisë në valutë -1% (nga -4%).

(62) Sipas afatit të maturimit, kredia me maturitet afatgjatë, e cila përfaqëson më shumë se gjysmën e tepricës së kredisë, ka dhënë kontributin kryesor pozitiv në ecurinë e tepricës së kredisë gjatë periudhës. Në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të parë të 2017-ës, kredia afatmesme ishte e vetmja në tkurrje me 8%, ndërkohë që stoku i kredisë afatshkurtër dhe asaj afatgjatë u rrit me përkatësisht 1% dhe 4%. Në harkun kohor të një viti, kredia afatshkurtër dhe ajo afatmesme ranë përkatësisht me 2% dhe 10%, ndërsa kredia afatgjatë u rrit me 6%.

(63) Kredia për bizneset, e cila zë peshën kryesore në tepricën e kredisë (rreth 65%), është ngushtuar gjatë periudhës me rreth 1%, duke zbritur në 390 miliardë lekë. Pavarësisht se fluksi i kredisë së re mbizotërohet nga kredia për bizneset, rënia e tepricës së kredisë për to ka ardhur nga zvogëlimi i stokut të kredive me probleme, si rrjedhojë e fshirjeve të kredive të humbura, shlyerjeve të kredive me probleme dhe ristrukturimit të kredisë. Kredia për bizneset rezidente, e cila përbën 86% të kredisë dhënë bizneseve, është zgjeruar gjatë periudhës me rreth 0.5% (ose rreth 1.6 miliardë lekë), ndërsa kredia për bizneset jorezidente u ngushtua me 9% dhe, në fund të periudhës, shënoi nivelin rreth 53 miliardë lekë. Kredia e dhënë per sektorin publik zë vetëm 5.4% të kredisë së përgjithshme, por kjo kredi u rrit me rreth 2 miliardë lekë gjatë gjashtëmujorit. Në terma vjetorë, kredia për bizneset është ngushtuar me 3% (rreth 12.2 miliardë lekë) dhe kjo ecuri ka reflektuar veprimet për mbledhjen dhe ristrukturimin e kredive, si edhe për largimin nga bilanci të kredive të humbura. Kredia për sektorin publik është rritur me 13% (ose me 3.8 miliardë lekë). Gjatë 6 muajve të fundit, janë fshirë rreth 4.5 miliardë lekë kredi të klasifikuara si "të humbura", të marra nga bizneset.

(64) Kredia për individët u rrit me 3% (ose me 4.6 miliardë lekë), mbështetur nga zgjerimi i kredisë së re për subjektet rezidente. Në ecurinë e kësaj kredie ka ndikuar kredia për individët rezidentë që zë 95% të kredisë totale për individët, ndonëse rritje ka shënuar edhe kredia për individët jorezidentë. Në ecurinë e kredisë për individët, kredia konsumatore u zgjerua me 8% dhe ajo hipotekare[50] me 2%. Në terma vjetorë, teprica e kredisë totale për individë është zgjeruar me rreth 6% (ose 9.3 miliardë lekë). Zgjerimi i kredisë për individët është ndikuar nga mbështetja me kredi të re, kryesisht për konsum dhe blerje banese.

---

[49] *Efektet e kursit të këmbimit për Euron dhe Dollarin amerikan kanë ecur në kahe të ndryshme. Efekti i Dollarit amerikan ka rezultuar më i madh, duke dhënë efekt total negativ në rritjen e kredive (dhe depozitave).*

[50] *Kjo kredi zë rreth 63% të tepricës së kredisë së marrë nga individët rezidentë.*

Grafik 8.6 Ecuria e kredisë sipas qëllimit të përdorimit, rritje vjetore (boshti djathtas) dhe ndryshimi mujor i stokut (boshti majtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(65) Sektori bankar ka vijuar të japë kredi për subjektet jorezidente (biznese dhe individë), por pesha e saj ka rënë në 11% të tepricës së kredisë së sektorit bankar në muajin dhjetor të vitit 2017, nga 11.3% një vit më parë. Teprica e kredisë për jorezidentët shënoi nivelin 64.4 miliardë lekë, dhe u ngushtua me rreth 7% gjatë periudhës dhe 5% ndaj një viti më parë. Kontributin kryesor në këtë rënie e ka dhënë kredia për bizneset jorezidente (83% e totalit të kredisë për jorezidentët), e cila është tkurrur me 9% gjatë periudhës dhe 8% ndaj një viti më parë. Pothuajse e gjithë kredia e dhënë për jorezidentët është në valutë, dhe kryesisht në monedhën Euro. Në përgjithësi, kredia për jorezidentët është orientuar në afate më të gjata maturimi, me peshën kryesore në afatin e mesëm (51%) dhe të gjatë (me 25%).

Grafik 8.7 Ecuria e kredisë për jorezidentët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

8.3.2 KREDIA E RE

(66) Gjatë periudhës, vëllimi i kredisë së re ishte në nivele të mira. Vlera e kredisë së re ishte rreth 140 miliardë lekë, rreth 10% më e lartë se gjashtëmujori i parë i vitit 2017, por më pranë niveleve të së njëjtës periudhe të vitit të kaluar. Vlera e kredisë së mbledhur (shlyerjet) ishte 2.3% më e lartë ndaj gjashtëmujorit të kaluar dhe rreth 8.6% më e ulët, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Raporti i përdorimit të kredisë (kredi e mbledhur ndaj kredisë së re) shënoi nivelin 95%, nga 103% në fund të muajit qershor të vitit 2017 dhe 104% një vit më parë. Rënia e raportit të përdorimit të kredisë ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e rritjes së fluksit të kredive të reja.

(68) Kontributin kryesor pozitiv në ecurinë e kredisë së re, e dha ajo për sektorin privat. Kredia e re për bizneset ishte më e lartë, si në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar (5%), ashtu edhe në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë (13%). Rritja ka ardhur si pasojë e rritjes së fluksit të kredisë në formën "kredi kufi" dhe të kredisë për "blerje pajisjesh". Gjatë periudhës, kredia e re për individët ishte 1.1 miliardë lekë më e vogël se ajo e dhënë në gjashtëmujorin e parë të vitit, dhe në nivele të ngjashme me atë të një viti më parë. Rënia është ndikuar nga ecuria e kredisë së re për blerje banesash, ndonëse ajo ruan peshën kryesore në kredinë e re për individët. Kredia e re për sektorin publik vijon të përbëjë një pjesë shumë të vogël të totalit të kredisë së re, ndonëse gjatë periudhës ishte rreth dy herë më e lartë krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit.

Grafik 8.8 Kredia e re sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(69) Sipas monedhës dhe afatit të maturimit, kontributin kryesor në rritjen e kredisë së re, gjatë periudhës, e dha kredia në Euro dhe kredia afatgjatë. Gjatë periudhës, kredia e re në valutë ishte rreth 20% më e madhe, në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit. Rreth 84% e kredisë së re në valutë ishte kredi në monedhën Euro, ndërkohë që kredia e re në USD ishte më e ulët gjatë periudhës. Kredia e re në Euro ishte rreth 26% më shumë (ose 12.4 miliardë lekë) se vëllimi i dhënë në gjashtëmujorin e parë të vitit dhe gati 33% më shumë se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Kredia e re në Lek zuri gati gjysmën e fluksit të përgjithshëm të kredisë së re, dhe rezultoi në nivele të ngjashme me gjashtëmujorin e parë të vitit. Në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, kredia e re në Lek ishte rreth 17 miliardë lekë më e ulët. Sipas afatit të maturimit, kredia e re afatgjatë (42% e totalit) u rrit me 36% (14.8 miliardë lekë), ndërsa ajo afatshkurtër (53% e totalit) u rrit me 8.5% (5.8 miliardë lekë). Kredia e re afatmesme ishte 10.2 miliardë lekë, ose pothuajse dy herë më pak në krahasim me periudhën e kaluar.

Grafik 8.9 Shpërndarja e kredisë së re sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

8.3.3 RREZIKU I KREDISË

(70) Gjatë periudhës, stoku i kredive me probleme ka rënë në mënyrë të ndjeshme. Në dhjetor të vitit 2017, stoku arriti në rreth 80 miliardë lekë, duke shënuar një tkurrje prej 14.5% në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të parë të vitit. Ndaj një viti më parë, kreditë me probleme janë tkurrur me rreth 30 miliardë lekë, ose me 28%. Rënia e stokut të kredive me probleme ka ardhur si pasojë e ristrukturimit të këtyre kredive, shlyerjes së kredive në klasa të ndryshme të portofolit me probleme dhe fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, nga bilancet e bankave janë fshirë rreth 4.5 miliardë lekë kredi të humbura[51], kryesisht të marra nga bizneset

Grafik 8.10 Raporti i kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.11 Kontributi në ndryshimin gjashtëmujor të stokut të kredive me probleme (mld lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[51] *Duke filluar nga janari 2015, bankat janë të detyruara nga kërkesat rregullative për të ndërmarrë procesin e pastrimit të bilanceve – fshirjen e kredive që gjenden në kategorinë "e humbur" për më shumë se 3 vjet. Gjithsej, që nga fillimi i procesit të fshirjes, janë fshirë 47.8 miliardë lekë kredi të humbura.*

dhe në valutë. Kredia e ristrukturuar gjatë kësaj periudhe kapi vlerën prej 10 miliardë lekësh. Nga kjo vlerë, rreth 7 miliardë lekë i përkisnin portofolit me probleme, ndërkohë që pjesa tjetër lidhej me portofolin cilësor të kredisë. Për vitin 2017, shlyerjet për totalin e portofolit të kredisë së sektorit bankar shënuan vlerën 70 miliardë lekë. Nga teprica e kredive me probleme vetëm, gjatë muajit dhjetor, janë shlyer 11.6 miliardë lekë.

(71) Rënia e stokut të kredive me probleme është shoqëruar me përmirësimin e treguesit të cilësisë së portofolit. Në fund të vitit, raporti i kredive me probleme (RKP) shënoi 13.2% nga 15.6% në qershor të 2017-ës dhe 18.2% një vit më parë. Brenda strukturës së kredive me probleme, si rezultat i ristrukturimeve, shyerjeve dhe kredisë së re, tepricat e kredive që bëjnë pjesë në kategoritë në "ndjekje" dhe "nënstandard" janë tkurrur me përkatësisht 14% dhe 17%; ndërkohë që, kredia në klasën "standard" u zgjerua me rreth 6%. Kredia e klasifikuar "e humbur", e cila zë peshën kryesore ose rreth 58% të kredive me probleme, është ngushtuar me 17% (rreth 10 miliardë lekë). Rënia ka ardhur kryesisht si pasojë e largimit të një pjese të kredive të humbura nga bilanci.

Grafik 8.12 Struktura e kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.13 Portofoli i kredive me probleme sipas grupeve bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(72) Në përmirësimin e cilësisë së kredisë, kontributin kryesor e kanë dhënë bankat e mesme dhe të vogla. Në vlerë absolute në fund të vitit, në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të parë, kreditë me probleme për këto grupe u ngushtuan me 5 dhe 4.5 miliardë lekë, ndërsa RKP-ja e tyre zbriti në 12.8% dhe 11.9%, nga 15.5% dhe 24.6%.

(73) Cilësia e kredisë paraqitet më e dobët për kredinë në valutë, kredinë për bizneset dhe kredinë me afat të gjatë maturimi. Në fund të vitit 2017, cilësia e kredisë për secilën nga këto segmente shënoi përkatësisht 14.7% (valuta), 16.9% (biznesi) dhe 15.1% (afati i gjatë). Të gjithë këta tregues kanë shënuar rënie gjatë periudhës.

Grafik 8.14 Huatë me probleme në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(74) Cilësia e kredisë së pambrojtur në valutë ka ardhur në përmirësim të vazhdueshëm që prej fillimit të vitit 2015. Raporti i kredive me probleme për këtë kategori kredie ra në nivelin 12.5%, nga 13.8% në fund të gjashtëmujorit të parë, ndikuar nga rënia më e shpejtë e stokut të kredive me probleme, në krahasim me tkurrjen e tepricës së kredisë së pambrojtur. Gjatë periudhës, teprica e kredisë së pambrojtur me probleme u ngushtua me rreth 13%. Sipas valutave, ndikimin kryesor në përmirësimin e cilësisë së pambrojtur e dha kredia në Euro. Raporti i cilësisë për kredinë e pambrojtur në Euro u përmirësua me 1.7 pikë përqindjeje, duke rënë në nivelin 12.9%, ndërsa për portofolin në USD u përkeqësua me rreth 1.4 pikë përqindjeje, duke u ngjitur në nivelin 9.2%.

Grafik 8.15 Ecuria e treguesve të cilësisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(75) Sipas qëllimit të përdorimit, peshën kryesore në stokun e kredive me probleme, brenda kredisë së pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, e zë kredia për "investime në pasuri të paluajtshme" (57%), e cila gjatë periudhës u tkurr me 15%. Kjo lloj kredie klasifikohet në tre kreditë me nivelin më të lartë të raportit të kredive me probleme (rreth 15.1%), së bashku me kredinë dhënë për zhvillim biznesi (21.6%) dhe kredinë dhënë bizneseve për zhvillimin e pasurive të paluajtshme - rezidenciale (16.9%). Gjatë periudhës, vetëm RKP-ja për kredinë për zhvillim biznesi shënoi rritje. Nivelin më të ulët të RKP-së, nga kategoria e kredive të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit, e ka kredia konsumatore me 4.5%.

Grafiku 8.16 Ecuria e cilësisë së kredisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, sipas qëllimit të përdorimit (majtas) dhe ecuria e kredive me probleme për subjektet jorezidente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(76) Cilësia e kredisë për subjektet jo-rezidente, ndonëse mbetet në nivele të mira, shënoi rënie gjatë periudhës. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, teprica e kredisë për jorezidentët u tkurr me rreth 7%, duke arritur në nivelin 64 miliardë lekë në fund të vitit, ndërkohë që kredia me probleme u rrit me 4.4%, duke arritur në 2.5 miliardë lekë. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, RKP-ja për kreditë e dhëna për jorezidentët u rrit në 3.9%, nga 3.3% një vit më parë.

8.3.4 FAKTORË ZBUTËS TË RREZIKUT TË KREDISË

(77) Megjithë rënien e kredive me probleme, rënia edhe më e shpejtë e nivelit të provigjioneve për rrezikun e kredisë, ka sjellë zvogëlimin e raportit të mbulimit me provigjione të kredive me probleme me 0.7 pikë përqindjeje gjatë periudhës. Raporti i mbulimit me provigjione vijon të ruajë nivele të mira (71.7%). Krahasuar me një vit më parë, shumica e bankave të sistemit raportojnë njëkohësisht përmirësim të cilësisë së kredisë dhe nivel më të lartë të mbulimit me provigjone.

(78) Rënia e stokut të kredive me probleme neto[52], gjatë periudhës, ka sjellë përmirësimin e mbulimit të tyre me kapital. Raporti i kredive me probleme neto ndaj tepricës së kredisë është ngushtuar me 0.5 pikë përqindjeje në nivelin 3.7%, gjatë periudhës. Një vit më parë ky raport shënonte 5.3%. Në të njëjtën kohë, si rrjedhojë e ekspozimit më të ulët ndaj rrezikut të kredisë përmes ngushtimit të tepricës së kredive me probleme neto, raporti "kredi me probleme neto/kapital rregullator" ra në 15.7%, nga 18.6% në qershor të vitit 2017. Një vit më parë ky raport shënonte 23.1%.

Grafik 8.17 Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(79) Mbulimi me kolateral i kredisë, kryesisht me pasuri të paluajtshme, mbetet në nivele të mira. Në fund të vitit 2017, *mbulimi me kolateral*[53] shënonte nivelin 76.4% nga 71.6% në gjysmën e parë të vitit dhe 71% një vit më parë. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë rreth 66% të kredive të kolateralizuara dhe 50% të tepricës së kredisë. *Cilësia e kredisë së kolateralizuar* është përmirësuar gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë, dhe RKP-ja shënoi nivelin 13.3%. Kredia e kolateralizuar me "para në dorë" ka nivelin më të ulët të kredive me probleme (0.13%), ndërsa ajo e kolateralizuar me "pasuri të paluajtshme – tokë" ka nivelin më të lartë të kredive me probleme (18.3%). RKP-ja për këtë lloj kredie ka ardhur në rënie. *Cilësia e kredisë së pakolateralizuar*, e cila zë rreth 23% të tepricës së përgjithshme të kredisë, ka ardhur duke u përmirësuar, duke u reflektuar në rënien e RKP-së në nivelin 16.4%, nga 19.8% një vit më parë.

Grafik 8.18 Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme sipas llojit të kolateraleve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[52] *Kreditë me probleme neto përfaqësojnë vlerën e kredive me probleme që mbetet pasi zbriten provigjionet për këto kredi.*

[53] *Kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), para në dorë etj.*

8.4 DEPOZITAT DHE RREZIKU I LIKUIDITETIT

(80) Teprica e depozitave u rrit me 2.4% ose 27.2 miliardë lekë gjatë periudhës, duke u ngjitur në nivelin 1,166 miliardë lekë. Kontributin pozitiv në këtë rritje e dhanë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat. Depozitat me afat mbetën pothuajse të pandryshuara në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të parë, por shënuan rënie në krahasim me fundin e vitit të kaluar. Në terma vjetorë, norma e rritjes së depozitave ishte 0.7%.

(81) Gjatë periudhës, teprica e depozitave në Lek shënoi një rritje prej 1.7% ose rreth 9 miliardë lekë, ndërsa teprica në valutë u rrit me rreth 3% ose 18.2 miliardë lekë. Në ecurinë e depozitave, efekti neto i kursit të këmbimit të Lekut ndaj Euros dhe Dollarit amerikan ishte pakësues për rreth 1.7 miliardë lekë[54]. Duke qenë se depozitat e individëve mbizotërojnë në stokun total të depozitave (mbi 80%), rritja e tyre dhe rritja e depozitave në valutë ishin dy kategoritë me ndikimin më të madh në zgjerimin e bazës së depozitave gjatë periudhës.

(82) Depozitat në valutë, sipas transaksioneve në monedhat origjinale të tyre[55], rezultojnë të jenë rritur në total me rreth 21 miliardë lekë. Në terma vjetorë, efekti i kursit të këmbimit për monedhat USD dhe Euro vlerësohet përkatësisht -9.3 miliardë lekë dhe -8.7 miliardë lekë. Në mungesë të efektit të kursit të këmbimit, rritja vjetore e bazës totale të depozitave do të ishte 2.3% (nga 0.7%) dhe e depozitave në valutë do të ishte 4% (nga 1%).

(83) Normat e interesit të depozitave kanë vijuar të bien dhe kjo rënie është reflektuar në një tkurrje të mëtejshme të depozitave me afat dhe në rritje të peshës së llogarive rrjedhëse e të depozitave pa afat.

Tabelë 8.3 Tregues kryesorë të depozitave në sektorin bankar

	Treguesi dhe njësia	Vlera (miliardë lekë)	Pesha ndaj totalit të depozitave (%)		Ndryshimi	
	Periudha	12/2017	12/2017	12/2016	Vjetor	Gjashtëmujor
Sipas monedhës	Depozitat në Lek	549	47.1%	47.2%	0.5%	1.7%
	Depozitat në valutë	617	52.9%	52.8%	0.9%	3%
Sipas subjekteve	Sektori publik	27	2.3%	2.5%	-6.4%	-0.8%
	Biznese	168	14.4%	14.1%	3.3%	4.8%
	Individë	970	83.2%	83.4%	0.5%	2.1%
Sipas produktit	Llogari rrjedhëse	383	32.9%	32.3%	2.5%	4.2%
	Depozita pa afat	107	9.1%	7.9%	16.8%	12.5%
	Depozita me afat	655	56.2%	57.8%	-2.1%	0.05%
	Stoku i depozitave	1,166	100.%	100.%	0.7%	2.4%

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(84) Gjatë periudhës, depozitat e individëve dhe të bizneseve u rritën me përkatësisht 2.1% dhe 4.8%. Në rritjen e depozitave të individëve me

[54] *Nëse do të përjashtohej efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit, rritja e depozitave në valutë, gjatë periudhës, do të ishte 3.5%.*

[55] *Kjo përjashton efektin e ndryshimit të kursit të këmbimit dhe pasqyron vetëm lëvizjet neto (hyrje – dalje) të depozitave sipas valutave origjinale.*

gati 20 miliardë lekë, kontributin kryesor e ka dhënë rritja e depozitave në valutë me gati 17 miliardë lekë. Në rritjen e depozitave të bizneseve, ecuria e depozitave në Lek ka dhënë kontributin e vetëm pozitiv. Tek depozitat në Lek të bizneseve, rritja kryesore me gati 7.4 miliardë lekë ka qenë në formën e llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat. Në terma vjetorë, depozitat e individëve dhe të bizneseve u rritën me përkatësisht 0.5% dhe 3.3%.

Grafik 8.19 Kontributi në ecurinë e depozitave dhe rritja vjetore e tyre



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(85) Sipas afatit të maturimit, depozitat me afat vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore në vlerën totale të depozitave. Ndonëse në terma absolutë rezultuan të pandryshuara, pesha e depozitave me afat në stokun e depozitave zbriti në 56.2%[56]. Nga ana tjetër, stoku i llogarive rrjedhëse dhe i depozitave pa afat u zgjerua përkatësisht me rreth 15 dhe 12 miliardë lekë gjatë periudhës.

Grafik 8.20 Rritja vjetore e depozitave sipas llojit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[56] *Nga muaji tetor i vitit 2013, kur rritja vjetore e depozitave me afat filloi të regjistronte norma negative, depozitat me afat kanë rënë në vlerë me 17.2% dhe pesha e tyre ndaj totalit të depozitave zbriti nga 77% në 56.2%.*

(86) Rritja e depozitave është përqendruar në grupin e bankave të mëdha (G3), dhe në masë më të vogël, në bankat e mesme (G2). Depozitat në bankat e mëdha u rritën me 19 miliardë lekë, ndërsa ato të bankave të mesme me rreth 7 miliardë lekë. Bankat e vogla paraqitën ndryshime minimale. Përqendrimi i depozitave sipas Indeksit të Herfindahl-it qëndron poshtë niveleve të moderuara[57] (1,455 pikë), gjë që flet për një treg bankar konkurrues, në drejtim të mbledhjes së depozitave të publikut.

(87) Gjatë periudhës, fluksi i depozitave të reja me afat në sektorin bankar ishte 282 miliardë lekë ose rreth 16% më i lartë, në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm. Pesha e depozitave të reja me afat në totalin e depozitave të reja ka qëndruar e pandryshuar nga gjashtëmujori i kaluar, në rreth 16%, por ka rënë ndjeshëm, kundrejt gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016, me 19%. Në kategorinë e depozitave të reja me afat, vërehet një zhvendosje e lehtë drejt maturiteteve më afatgjata, për të treja monedhat.

(88) Për të tre monedhat kryesore, fluksi i depozitave të reja ishte ndjeshëm më i lartë, në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit, dhe normat e interesit treguan luhatshmëri të ulët. Depozitat e reja në Lek dhe në Euro u zgjeruan me rreth 25% përkatësisht, dhe ato në USD rreth 14%. Gjatë periudhës, normat mesatare të interesit për depozitat e reja me afat në të tre monedhat kanë ruajtur përgjithësisht nivelet e periudhës paraardhëse, duke shënuar luhatje shumë të vogla. Norma mesatare për depozitat e reja me afat në Lek ishte rreth 0.9%, ndërsa ato për depozitat në USD dhe në Euro ishin përkatësisht 0.36% dhe 0.2%.

Grafik 8.21 Përbërja e depozitave të reja me afat sipas monedhës dhe afatit të maturimit, flukset gjashtëmujore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[57] *Vlerat e indeksit të Herfindahlit deri në 1500 tregojnë një treg konkurrues, vlerat 1500-2500 tregojnë një konkurrueshmëri të moderuar, dhe vlerat mbi 2500 një përqendrim të lartë.*

8.4.1 RREZIKU I LIKUIDITETIT

(89) Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar vlerësohet në nivele të kënaqshme. Treguesit e likuiditetit në Lek dhe valutë mbeten mbi nivelet minimale rregullative. Burimi kryesor i financimit mbeten depozitat, të cilat mbulojnë gati dy herë vëllimin e kredive të sektorit. Në dhjetor të 2017-ës, raporti "hua/depozita" shënoi 51.6%, duke mos shënuar ndryshim ndaj një viti më parë dhe duke rënë lehtë ndaj nivelit të muajit qershor të 2017-ës. Sipas monedhës, ky raport shënon 48% për monedhën vendase dhe 55% për valutën. Në krahasim me një vit dhe një gjashtëmujor më parë, raporti "hua/depozita" është rritur për monedhën Lek dhe ka rënë për valutën. Rritja për raportin në Lek ka ardhur si pasojë e rritjes më të madhe relative të kredisë në Lek ndaj depozitave në Lek, ndërsa rënia për raportin në valutë ka ardhur si pasojë e tkurrjes së kredisë në valutë dhe rritjes së depozitave në valutë.

(90) Nivelet e aktiveve likuide në bilancet e bankave vijojnë të mbeten të larta, duke reflektuar ecurinë poshtë potencialit të aktivitetit kreditues. Në fund të muajit dhjetor të 2017-ës, raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar ishte 30% ose rreth 1 pikë përqindje më i ulët ndaj një gjashtëmujori më parë. Ecuria e treguesit tjetër të likuiditetit - "aktive likuide/totali i detyrimeve afatshkurtra" – shënoi një rënie të lehtë me 0.3 pikë përqindjeje, duke arritur në nivelin 40.8%. Ndonëse bankat po operojnë në kushtet e një likuiditeti të bollshëm, hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve, sipas segmenteve të maturitetit kontraktual të mbetur, në raport me totalin e aktiveve në afatin e shkurtër, konsiderohet në nivele të larta dhe në rritje, kundrejt periudhave të kaluara.

Grafik 8.22 Tregues të likuiditetit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.23 Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve*



*Janë përfshirë edhe aktivet dhe detyrimet jashtë bilancit.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

(56) Gjatë periudhës është vërejtur një rënie në diferencën midis maturimit mesatar të aktiveve dhe të detyrimeve. Në fund të dhjetorit, kjo diferencë ishte

rreth 17.3 muaj, nga 19.1 muaj në qershor të 2017-ës, kur u shënua vlera më e lartë e kësaj diference që nga viti 2010. Maturiteti i mbetur i depozitave, të cilat përfaqësojnë kategorinë më të rëndësishme të detyrimeve, është rritur në 7.5 (nga 6.7) muaj, gjatë periudhës. Maturiteti i mbetur i kredisë ka mbetur thuajse i pandryshuar në 45.5 muaj (nga 44.8 muaj në dhjetor të vitit 2016), duke reflektuar dhe prirjen e bankave për të krediturar për periudha më afatgjata.

Grafik 8.24 Maturimi mesatar i mbetur



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(57) Vlera e linjave të financimit nga grupet bankare zotëruese zë një peshë shumë të ulët në burimet e financimit të sektorit bankar. Gjatë periudhës, totali i vlerës së këtyre linjave shënoi 6.7 miliardë lekë, nga 8.7 miliardë në fund të periudhës së kaluar. Për bankat që disponojnë linja kredie me grupet bankare zotëruese në fund të periudhës, shkalla e përdorimit të tyre shënoi 12%, nga 16.3% në qershor të vitit 2017.

8.5 RREZIQET E TREGUT DHE AI OPERACIONAL

8.5.1 RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

(91) Gjatë periudhës, pozicioni i hapur neto valutor i sektorit bankar, në raport me kapitalin rregullator, nuk tregoi lëvizje të rëndësishme. Në fund të vitit 2017, pozicioni i hapur neto valutor "në blerje" i sektorit bankar ishte sa 6.7% e kapitalit rregullator, duke qenë 1.1 pikë përqindje më i lartë sesa ai i regjistruar në fund të gjashtëmujorit të parë dhe 0.4 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Ecuria e treguesit për sektorin bankar është diktuar kryesisht nga grupi i bankave të mëdha. Në fund të periudhës, bankat e mëdha shfaqën një pozicion të hapur valutor "në blerje", ndërsa bankat e mesme dhe ato të vogla treguan një pozicion "në shitje". Vlerat e pozicioneve ishin relativisht të kufizuara, duke sugjeruar një ekspozim të ulët të sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtëpërdrejtë të kursit të këmbimit.

Grafik 8.25 Pozicioni i hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(59) Në fund të vitit 2017, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit ishte më i ulët, krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të parë dhe me një vit më parë. Në

fund të dhjetorit, treguesi i mospërputhjes valutore[58] për të gjitha monedhat rezultoi sa 17.7% e totalit të aktiveve, nga 18.4% e totalit të aktiveve një gjashtëmujor dhe një vit më parë. Rënia në vlerën e indeksit erdhi si pasojë e rritjes më të shpejtë të aktiveve në valutë (+4%), në krahasim me pasivet në valutë (+3%), dhe ngadalësimit të kredisë në valutë. Sipas monedhave, rënia e indeksit për monedhën evropiane me 0.4 pikë përqindjeje në nivelin 17.4% të totalit të aktiveve, diktoi ecurinë e treguesit të përgjithshëm për sektorin bankar.

Grafik 8.26 Mospërputhja valutore sipas përbërësve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.27 Mospërputhja valutore sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(92) Për të tri grupet bankare, ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit ka shënuar rënie gjatë periudhës. Duke qenë se indeksi i mospërputhjes valutore është i lidhur me nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, konstatohet se grupi i bankave të mëdha ka nivelin më të ulët të ekspozimit ose një shkallë më të lartë të mbulimit të detyrimeve valutore me aktive në valutë, ndërkohë që bankat e mesme kanë ekspozimin më të lartë ose mbulimin më të ulët të detyrimeve valutore me aktive në valutë. Për këto grupe, indeksi i mospërputhjes valutore, në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2017, ishte përkatësisht 14.4% dhe 25.1%, ndërkohë që për bankat e vogla indeksi shënoi vlerën 16.9%. Theksojmë se, në 5-vjeçarin e fundit, ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit ka ardhur në rënie për grupin e bankave të mesme dhe bankave të mëdha, ndërsa shkalla e ekspozimit për bankat e vogla ka pasur luhatshmëri më të madhe, në krahasim me ekspozimin për dy grupet e tjera.

[58] *Treguesi i mospërputhjes valutore mat shkallën e mbulimit të pasiveve të sektorit bankar në valutë me aktivet në valutë, të netuara me kredinë rezidente në valutë. Një vlerë e ulët e raportit të këtij treguesi ndaj aktiveve tregon ekspozim të ulët ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit. Për llogaritjen e treguesit të mospërputhjes valutore referohuni Raportit të Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.*

Grafik 8.28 Mospërputhja valutore sipas grupeve dhe monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.29 Mospërputhja valutore sipas grupeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

8.5.2 RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

(93) Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit, si në nivel grupesh bankare ashtu edhe sektori, vlerësohet në nivele të ulëta, 1.55% e kapitalit rregullator[59], duke reflektuar qëndrueshmëri të sektorit bankar ndaj goditjeve të menjëhershme të normave të interesit.

Rreziku i riçmimit është mundësia që banka të pësojë humbje financiare, si rezultat i mospërputhjes së maturitetit midis instrumenteve me norma fikse të interesit (FIR) dhe i riçmimit të normave të interesit për instrumentet me norma të ndryshueshme interesi (VIR)[60]. Treguesi i matur për llogaritjen e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit është pozicioni total neto i peshuar me koeficientët përkatës. Ky pozicion, sipas aktit përkatës të Bankës së Shqipërisë[61], nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 20% të kapitalit rregullator. Në fund të periudhës, ky pozicion shënonte vlerën negative prej 1.55%, i diktuar kryesisht nga pozicioni negativ i zërave të bilancit me normë fikse interesi prej 3.3% ndaj kapitalit rregullator. Një gjashtëmujor më parë, ky pozicion rezultoi pozitiv në nivelin 0.4% të kapitalit rregullator. Në kushtet kur pozicioni neto total është negativ - që do të thotë që vëllimi i detyrimeve për të cilat paguhen interesa e tejkalon vëllimin e pretendimeve për të cilat arkëtohen interesa - sektori bankar do të ekspozohej ndaj një rritjeje të menjëhershme të normave të interesit.

59 *Treguesi i mësipërm është shprehur në vlerë absolute.*

60 *Në FIR dhe VIR përfshihen flukset monetare të pritshme të aktivit (me normë fikse – FIR; dhe variabël - VIR), siç janë mardhëniet me BQ-në, marrëdhënet ndërbankare, huatë dhe paradhëniet, letrat me vlerë (përveç atyre të tregtimit) dhe interesat pjesëmarrëse. Këto flukse netohen nga flukset monetare të pasivit (me normë fikse dhe variabël) siç janë: banka qendrore; reverse/repo; marrëdhëniet ndërbankare; veprimet me klientët (depozitat); veprime me administratën publike; detyrimet nga bono dhe letra të tjera me vlerë; fondet rezervë specifike; dhe borxhi i varur.*

61 *Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 33, datë 30.04.2013 "Për miratimin e Udhëzimit 'Mbi Administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës.'"*

(94) Sipas afatit të maturimit, vërehet se pozicioni neto i peshuar afatmesëm është zgjeruar në -6.1% të kapitalit rregullator, ndërkohë që hendeku afatgjatë është zgjeruar me 0.3 pikë përqindje, duke arritur në 5.3% të kapitalit rregullator. Gjithashtu, vërehet se për zërat e bilancit me norma variabël të interesit shfaqen pozicione të peshuara pozitive në të gjitha maturitetet, ndërsa peshën kryesore e mban maturiteti afatshkurtër që arrin në 1.6% të kapitalit rregullator. Ndërsa, zërat e bilancit me norma fikse të interesit, shfaqin vlera pozitive për pozicionin neto të ponderuar afatgjatë (5.2%) dhe vlera negative për pozicionet e ponderuara afatshkurtra dhe afatmesme (përkatësisht 2.3 dhe 6.3%).

Grafik 8.30 Rreziku i riçmimit për normat fikse (FIR) dhe variabël (VIR) të interesit, në % ndaj kapitalit rregullator



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(95) **Pozicioni neto i peshuar sipas monedhave tregon se pozicioni i peshuar në monedhën evropiane (-3.2%) ka qenë përcaktues në pozicionimin e treguesit për sektorin bankar.** Siç vërehet edhe në grafikun sipas monedhës dhe grupeve, bankat e mëdha dhe bankat e mesme shfaqin pozicione neto të peshuara negative në Euro. Për pozicionin e peshuar në monedhën vendase, bankat e vogla dhe ato të mesme mbajnë pozicione pozitive, ndërsa bankat e mëdha nuk shfaqin pozicione të rëndësishme në Lek.

Grafik 8.31 Hendeku sipas maturitetit, në % ndaj kapitalit rregullator



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(96) Në pozicionet sipas madhësisë së bankave vërehet se grupi i bankave të mëdha dikton ecurinë e treguesit për sektorin. Bankat e vogla dhe të mesme shfaqin pozicione neto të peshuara pozitive

Grafik 8.32 Pozicioni neto i peshuar ndaj kapitalit rregullator, sipas monedhave dhe madhësisë së bankave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.33 Pozicioni neto i peshuar sipas madhësisë së bankave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

ndaj kapitalit rregullator, pra mbajnë më tepër mjete sesa detyrime të ndjeshme ndaj ndryshimeve të normës së interesit. Bankat e mëdha kanë një pozicion të kundërt, pasi ato mbajnë më tepër detyrime sesa mjete të ndjeshme ndaj ndryshimeve të normave të interesit. Pavarësisht pozicionimit të grupeve bankare, ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit, si në nivel grupesh ashtu dhe sektori, qëndron në nivele të ulëta, duke reflektuar qëndrueshmëri të sistemit bankar ndaj goditjeve të menjëhershme të normave të interesit.

(97) Sektori bankar nuk ka treguar preferencë të theksuar për rritjen e aktiviteteve me rrezik, në mjedisin ekzistues me norma të ulëta interesi. Në grafikun 8.34 tregohet ecuria e aktiveve me rrezik të sektorit bankar, duke nisur që nga viti 2007. Aktivet me rrezik përcaktohen sipas rregullores përkatëse të Bankës së Shqipërisë, dhe reflektojnë cilësinë e një ekspozimi nga këndvështrimi i rrezikut. Përtej rritjes relativisht të shpejtë në periudhën 2007-2010, ritmi i rritjes së aktiveve me rrezik të sektorit bankar në periudhën 2011-2015 ka qenë më i ngadaltë, ndërsa në periudhën 2016-2017, rritja e aktiveve me rrezik ka ndaluar. Në ecurinë e aktiveve me rrezik të sektorit bankar ka ndikuar ngadalësimi i ndjeshëm i aktivitetit të kreditimit, në vijim të rritjes së kredive me probleme, si edhe preferenca për investime në aktive më likuide me koeficient rreziku më të ulët. Duke nisur nga viti 2013, ecuria e aktiveve me rrezik është përcaktuar edhe nga ndryshimet në koeficientët e rrezikut si pjesë e ndryshimeve rregullative të Bankës së Shqipërisë, për masat kundërciklike.

Përgjithësisht, aktivet me rrezik më të lartë shoqërohen edhe me normën më të lartë nominale të kthimit nga investimi. Në kushtet kur aktivet me rrezik në

Grafik 8.34 Aktive të peshuara me rrezik/totali i aktiveve (%)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.35 Afati mesatar i maturimit të mbetur të aktiveve dhe detyrimeve të sektorit bankar (në muaj)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

përgjithësi nuk janë rritur, një formë e sipërmarrjes së rrezikut nga ana e bankave për të siguruar qëndrueshmërinë e normave të kthimit nga investimi, është edhe zgjatja e afatit të maturimit të investimit. Grafiku 8.35 paraqet afatin mesatar të mbetur të maturimit të aktiveve dhe të detyrimeve të sektorit bankar në muaj. Përgjithësisht, vërehet e njëjta ecuri si për aktivet me rrezik. Duke nisur nga vitit 2010 e këtej, sektori bankar nuk ka treguar një parapëlqim për zgjatje të afatit të maturimit të investimeve të tij.

8.5.3. RREZIKU OPERACIONAL

(98) Në fund të vitit 2017, humbjet operacionale të sektorit bankar nuk tejkalojnë kërkesën për kapital për rrezikun operacional dhe pesha e tyre është e ulët.

Rreziku operacional, sipas përkufizimit rregullativ, përfaqëson rrezikun që subjekti të pësojë humbje, si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme dhe të sistemeve, gabimeve njerëzore, apo i ngjarjeve të jashtme. Në fund të vitit 2017, kërkesa për kapital për rrezikun operacional shënoi nivelin 6.7 miliardë lekë, duke shënuar rënie, krahasuar me gjysmën e parë të vitit dhe me një vit më parë. Në rënien e treguesit kanë ndikuar 2 faktorë:

i. *së pari*, mënyra e llogaritjes së kërkesës për kapital, ku 12 banka të sektorit përdorin metodën e treguesit të thjeshtë[62] dhe 4 banka përdorin metodën standarde[63];
ii. dhe së dyti, rënia e vazhdueshme në 3 vitet e fundit e rezultatit neto nga interesat dhe jointeresat.

Humbjet operacionale për vitin 2017, shënuan nivelin e 0.7 miliardë lekëve. Niveli mesatar i humbjeve operacionale ndaj kërkesës për kapital për sektorin bankar është 10%. Një vit më parë, ky raport rezultoi 7.4%.

8.6 REZULTATI FINANCIAR DHE EFICIENCA E BURIMEVE

(99) Sektori bankar e mbylli vitin 2017 me një rezultat financiar pozitiv prej rreth 22 miliardë lekësh, dukshëm më të lartë se një vit më parë. Arsyeja kryesore për rritjen e rezultatit financiar lidhet me pakësimin e ndjeshëm të provigjioneve për rrezikun e kredisë, ndërkohë që të ardhurat neto nga interesat vijuan të tkurren. Rritja në rezultatin financiar është pasqyruar në rritje të ndjeshme të treguesve mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar: RoA u ngjit në 1.6% dhe RoE u ngjit në 15.7%, nga përkatësisht 0.7% dhe 6.8% një vit më

62 *Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun operacional, sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurat neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient* α *prej 15%.*

63 *Sipas metodës standarde, e cila konsideron treguesin e të ardhurës neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit, sipas linjave të biznesit dhe koeficientëve respektivë të linjave,* β.

parë. Ndryshe nga një vit më parë, kur grupi i bankave të vogla (G1) raportoi humbje financiare, në fund të vitit 2017, të treja grupet e bankave, raportuan rezultat neto pozitiv dhe më të lartë se një vit më parë.

(100) Rënia e të ardhurave nga interesat ka sjellë rënie në marzhin neto nga interesat në vlerën 3.9%, nga vlera 4.2% një viti më parë. Gjatë periudhës, ky tregues ka mbetur pothuaj i pandryshuar. Rënia në marzhin neto nga interesat ka ardhur si pasojë e tkurrjes në rezultatin neto nga interesat në një masë më të madhe nga rënia e kostove të financimit. Rezultati neto nga interesat shënoi rreth 44 miliardë lekë, duke qenë rreth 0.4 miliardë lekë më i ulët ndaj një viti më parë. Në një ambient të përgjithshëm normash të ulëta interesi, si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet për interesa kanë vijuar të shënojnë rënie, por rënia në të ardhurat nga interesat ishte më e madhe, në krahasim me rënien në shpenzimet për interesa. Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera gjithashtu kanë shënuar rënie, si pasojë e humbjeve nga instrumentet financiare, ndërkohë që të ardhurat nga gjobat dhe komisionet shënuan një rritje të lehtë ndaj një viti më parë.

Grafik 8.36 Përbërësit e rezultatit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.37 ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(101) Shpenzimet në formën e provigjioneve për rrezikun e kredisë shënuan një pakësim të ndjeshëm prej rreth 16 miliardë lekësh dhe përfaqësojnë faktorin kryesor të rritjes së fitimit në sektorin bankar. Ulja e provigjioneve është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredisë, si pasojë e tkurrjes së konsiderueshme të tepricës së kredive me probleme. Shpenzimet për mjete të tjera financiare ishin në vlerë negative (rimarrje provigjionesh). Vlera e rimarrjes së provigjioneve ishte rreth 3.3 miliardë lekë më e lartë në krahasim me fundin e vitit të kaluar, gjë që ka dhënë një ndikim shtesë në rritjen e fitimit të sektorit bankar. Pesha ndaj aktiveve të sektorit bankar e aktiveve të bankave që regjistruan humbje financiare ishte rreth 3%; për vitin 2017 vetëm 3 banka

Grafik 8.38 Marzhi neto nga interesi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.39 Treguesit e përfitueshmërisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

të vogla raportuan humbje financiare me vlera shumë të ulëta.

(102) Kostot e veprimtarisë u mbuluan në nivele të mira nga të ardhurat e veprimtarisë. Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave ishte 72% dhe ka shënuar rritje gjatë vitit të fundit pas një luhatshmërie të ulët në periudhat paraardhëse.

Grafik 8.40 Shpenzimet ndaj të ardhurave të veprimtarisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 8.3 PËRAFRIM MBI KOSTON E KAPITALIT (CoE) NË SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR

Kostoja e kapitalit (CoE) i referohet normës së kërkuar të kthimit nga aksioneri për një investim në kapital. Kjo është norma e kthimit që mund të ishte fituar duke investuar të njëjtën shumë në një investim të ndryshëm me rrezik të barabartë. Diferenca e këtij treguesi nga kthimi aktual mbi kapitalin (RoE), është një matje e mjaftueshmërisë së fitimit të një banke nga këndvështrimi i aksionerëve të saj. Sektori bankar shqiptar paraqet nivele të luhatshme të kthimit mbi kapitalin, sipas bankave në vite. Bankat e mëdha përgjithësisht mbajnë nivele më të larta të RoE krahasuar me bankat e vogla.

Literatura e vlerëson koston e kapitalit sipas Modelit të Çmimeve të Aseteve të Kapitalit (CAPM), i cili përdoret për të përcaktuar një normë të duhur teorikisht të kërkuar të kthimit të një aktivi, për të marrë vendime për shtimin e aktiveve në një portofol të mirëdiversifikuar. Sipas CAPM, kostoja e kapitalit e një banke që vepron nën një juridiksion të caktuar llogaritet si shuma e rrezikut të vendit (e matur përgjithësisht sipas vlerësimit të borxhit sovran) dhe rrezikut në nivel banke individuale.

*Në studimin e tij, Aswath Damodaran * ka përdorur të dhëna paneli të shumë vendeve për për të vlerësuar rrezikun e një vendi të shprehur si pikë përqindje mbi kthimin e një aktivi të sigurt, siç është një obligacion qeveritar i SHBA-ve, duke rezultuar në një vlerësim të rrezikut vendor të Shqipërisë prej 5.19%**. Matja më e drejtpërdrejtë e rrezikut të vendit është rreziku i dështimit kur kreditohet qeveria e atij vendi. Megjithatë, për të arritur tek kostoja e kapitalit të bankës, duhet përfshirë edhe primi i rrezikut në nivel banke individuale. Në mungesë të këtyre vlerësimeve në Shqipëri, studime të hershme për vendet e zhvilluara sugjerojnë se primi i rrezikut specifik për bankat është ndërmjet intervalit 3 dhe 10%***. Duke i shtuar vlerësimit të rrezikut të vendit edhe primin e rrezikut të bankës, kostoja e kapitalit për bankat tona është ndërmjet 8.19% dhe 15.19%, me një vlerësim mesatar prej 11.7%****. Kjo nënkupton që kthimet aktuale (RoE) për një pjesë të bankave, të cilat zënë rreth 28.9% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, nuk mbulojnë koston e vlerësuar të kapitalit. Megjithatë, në nivel sektori, kthimi nga kapitali aktualisht (dhjetor 2017) ndodhet në nivele të kënaqshme duke mbuluar dukshëm kostot e kapitalit si në nivel mesatar ashtu dhe në atë maksimal (Grafiku 8.41).*

Grafik 8.41 Ecuria e kthimit nga kapitali RoE e sektorit bankar kundrejt kostos së kapitalit CoE, para dhe pas krize



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kriza ndërkombëtare financiare e vitit 2007, u reflektua edhe në treguesit e shëndetit financiar të vendit tonë, kryesisht përgjatë harkut kohor 2008-2012, ku një nga këta tregues, kthimi nga kapitali (RoE) për sektorin bankar në tërësi, por edhe për disa banka në veçanti, qëndron poshtë nivelit mesatar të CoE-s prej 11.7% dhe poshtë nivelit minimal të kostos së kapitalit prej 8.19%. Ndërkohë, para vitit 2008, sektori bankar dhe një numër i konsiderueshëm bankash kanë një kthim nga kapitali mbi nivelin mesatar të CoE-s, duke pasur hapësira për të zgjeruar veprimtarinë.

Vitet e fundit 2015-2017, pavarësisht se një pjesë e konsiderueshme e bankave kanë një kthim nga kapitali (RoE) shumë pranë nivelit mesatar të CoE-s, ende ka banka të cilat kanë vështirësi në mbulimin e kostove të kapitalit.

Grafik 8.42 Euria e kthimit nga kapitali RoE në nivel banke kundrejt kostos së kapitalit CoE, para dhe pas krize



Sqarim: Topat me ngjyra në grafik përfaqësojnë RoE e bankave individuale në vite.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

* *Aswath Damodaran "Rreziku i vendit: Përcaktuesit, matjet dhe implikimet"- Stern School of Business, 2016*

** *http://pages.stern.nyu.edu/~adamodar/New_Home_Page/datafile/ctryprem.html*

*** *King, M.R., "Kostot e kapitalit për bankat globale: Një perspektivë e CAPM nga 1990 deri 2009", BIS Raporti tremujor, Shtator 2009, http://www.bis.org/publ/ qtrpdf/r_qt0909g.pdf .*

**** *Vlerësimi mesatar i kostos së kapitalit llogaritet nga formula: 5.19% + 0.5*(10+3) % =11.7%.*

8.7 KAPITALIZIMI I VEPRIMTARISË

(103) Kapitalizimi i sektorit bankar në dhjetor të vitit 2017 vlerësohet i mirë dhe ecuria e tij u përcaktua nga rritja e kapitalit rregullator. Rezultati financiar pozitiv dhe në rritje mbetet faktori kryesor që ka diktuar ecurinë e kapitalit rregullator për periudhën. Nga ana tjetër, zgjerimi i aktiveve të peshuara me rrezik për shkak të rritjes së kërkesave për kapital për rrezikun e kredisë ka dhënë kontribut negativ në ecurinë e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Sidoqoftë, niveli i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, qëndron dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar nga kuadri rregullativ mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

(104) Në dhjetor të vitit 2017, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi 16.6%, nga 16.3% që ishte në fund të gjashtëmujorit të parë dhe nga 16% një vit më parë. Në fund të vitit aktivet e peshuara me rrezik ishin rreth 2.5% më të larta krahasuar me muajin qershor të 2017-ës, duke kontribuar në rënien e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit me 0.4 pikë përqindje. Rritja e kapitalit rregullator me 4.2% dha një ndikim prej +0.7 pikë përqindjeje në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

(105) Në nivel grupesh, bankat e Grupit 3 paraqesin normë më të ulët kapitalizimi, ndërsa sipas origjinës së kapitalit, bankat e klasifikuara si "Të tjera"[64] dhe ato me kapital shqiptar kanë norma më të ulëta të mjaftueshmërisë së kapitalit. Në pjesën më të madhe, bankat individuale ruajnë norma të mjaftueshmërisë së kapitalit në intervalin 14-16%. Në fund

[64] *Në këtë grup përfshihen bankat me kapital turk, arab, kuvajtian dhe malajzian.*

Grafik 8.43 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

të vitit 2017 është vënë re një rritje e numrit të bankave që e kanë normën e mjaftueshmërisë së kapitalit në intervalet 18-20% dhe 20-30%, ndërkohë që numri i bankave që e kanë këtë raport në intervalin 16-18% është zvogëluar.

Grafik 8.44 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas madhësisë dhe origjinës së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.45 Shpërndarja e aktiveve të sektorit sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(106) Sektori bankar paraqet ekspozim në rritje përsa i përket disa kategorive të rrezikut të kredisë, por ky ekspozim është përqendruar në kategori me koeficient të ulët rreziku. Aktivet e peshuara me rrezikun e kredisë janë zgjeruar me rreth 20 miliardë lekë krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të parë, duke arritur në nivelin 720 miliardë lekë. Kategoritë që shënuan rritje lidhen me ekspozimet ndaj organeve administrative dhe institucioneve mbikëqyrëse, të cilat kanë një koeficient rreziku prej 20% (Grafiku 8.46). Ndërkohë, kategoritë që shënuan rënie iu përkasin ekspozimeve ndaj koorporatave dhe kredive me probleme, si dhe kredive të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit, të

cilat peshohen me koeficient të lartë rreziku (100%-150%). Bankat e vogla paraqesin ekspozim të lartë për kredi të siguruara me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme; bankat e mesme kanë ekspozim më të lartë për kredinë për koorporata dhe kredinë me probleme; bankat e mëdha, përveç ekspozimeve që kanë bankat e mesme, janë të ekspozuara edhe ndaj organeve administrative dhe institucioneve të mbikëqyrura. Në ndarjen sipas origjinës së kapitalit, vërehet që bankat me kapital shqiptar kanë ekspozim më të lartë për klasën "Kredi për koorporata dhe kredi me probleme" (Grafiku 8.47).

Grafik 8.46 Koeficientët e ponderimit dhe madhësia e klasave kryesore të portofolit të kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.47 Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas madhësisë të aktivitetit dhe origjinës në kapitalit, dhjetor 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(107) Kërkesat për kapital për rrezikun e tregut dhe atë operacional kanë shënuar rënie. Në fund të periudhës kërkesat për kapital për rrezikun e tregut shënuan vlerën 14.3 miliardë lekë, dhe kanë shënuar një rënie të lehtë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Kërkesat për kapital për rrezikun operacional ranë me 1.6 miliardë lekë në nivelin 83 miliardë lekë. Kërkesat për kapital për rrezikun e tregut dhe ato për rrezikun operacional zënë përkatësisht 1.7% dhe 9.6% të totalit të aktiveve të peshuara me rrezik.

(108) Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një raport i ulët i levës financiare, gjë që konfirmon ruajtjen e një niveli të mirë të kapitalizimit. Treguesi i levës financiare[65] në dhjetor të 2017-ës ishte 9.8 herë, nga 10.3 herë një vit më parë. Leva financiare në nivel bankash individuale nuk paraqet zhvendosje të rëndësishme.

Grafik 8.48 Treguesi i levës financiare, në herë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[65] *Treguesi i levës financiare matet si raport i aktiveve ndaj kapitalit aksioner.*

9. VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS[66]

(109) Ushtrimi i provës së rezistencës vlerësoi qëndrueshmërinë e sektorit bankar kundrejt zhvillimeve ekonomike dhe financiare për periudhën e ardhshme dyvjeçare, deri në fund të vitit 2019. Rezultatet dëshmojnë se sektori bankar mbetet i qëndrueshëm. Ndikimi i këtyre supozimeve në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit, evidenton nevojën për kapital shtesë në disa prej bankave individuale, më e ndjeshme kjo në rastin e skenarit të rënduar, ku dhe supozimet janë më ekstreme. Gjithashtu, ushtrimi ka vlerësuar edhe qëndrueshmërinë e sektorit bankar kundrejt luhatjeve në çmimet e pasurive të paluajtshme, në kuadër të kostove shtesë për sektorin që lidhen me pronat e përfituara në vijim të një procesi ligjor. Këtë vit, ushtrimi përfshin edhe vlerësimin e qëndrueshmërisë së sektorit ndaj luhatjeve në normat e interesit, në terma të përfitueshmërisë së tij. Së fundi, edhe prova e rezistencës për situatën e likuiditetit mbështet vlerësimin për një gjendje të kënaqshme likuiditeti të sektorit bankar. Rezultatet e ushtrimit tregojnë se sektori bankar e kalon përgjithësisht me sukses provën e rezistencës së likuiditetit dhe gjendja e likuditetit e reflektuar në rritjen e hyrjeve dhe tkurrjen e daljeve të pritura deri në fund të horizontit 2-vjeçar është përmirësuar.

9.1 VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË NDAJ GODITJEVE MAKROEKONOMIKE

(110) Ushtrimi i provës së rezistencës vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe mjaftueshmërinë e kapitalit për periudhën 2018-2019. Vlerësimi i ndikimit të situatave makroekonomike në gjendjen financiare të sektorit bankar përjashton mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës. Ushtrimi kryhet duke aplikuar tre skenarë: skenarin bazë, skenarin e moderuar dhe atë të rënduar. Dy skenarët e fundit, përmbajnë supozime më ekstreme dhe kanë një probabilitet më të ulët ndodhjeje.

[66] *Prova e rezistencës nuk përfaqëson një mënyrë parashikimi. Në mënyrë të qëllimshme, skenarët përmbajnë zhvillime negative dhe ekstreme, por me një probabilitet të ulët ndodhjeje, për të provuar rezistencën e sektorit bankar ndaj tyre. Megjithëse bankat nxiten që të vlerësojnë kapacitetin e gjendjes së tyre financiare për të përballuar ndikimin e këtyre skenarëve, ato nuk duhet t'i konsiderojnë këta skenarë si ngjarje të pritshme nga ana e Bankës së Shqipërisë për të ardhmen. Skenarët janë të ndryshueshëm përgjatë kohës, në varësi të zhvillimeve ekonomike dhe financiare. Nga ana tjetër, skenarët nuk marrin në konsideratë veprimet që mund të kryejnë bankat dhe autoritetet për të forcuar në vazhdimësi situatën financiare dhe qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve të bankave.*

Grafik 9.1 Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(111) Skenari bazë supozon një rritje ekonomike pozitive përgjatë harkut kohor dyvjeçar të ushtrimit. Në këtë skenar, rritja ekonomike shoqërohet me ritme rritjeje më të larta të kreditimit, mbështetur nga përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së portofolit të kredisë deri në fund të vitit 2019, si rezultat i vijimit të shlyerjeve, ristrukturimeve dhe procesit të fshirjeve të kredive me probleme nga bilancet e bankave.

(112) Në skenarin e moderuar supozohet sërish një rritje ekonomike pozitive, por me ritëm më të ulët se në skenarin bazë; ndërsa, në skenarin e rënduar është supozuar një tkurrje e ekonomisë deri në fund të 2019-ës. Këto zhvillime, të kombinuara edhe me një zhvlerësim të kursit të këmbimit të monedhës vendase, rritje të normave të interesit, si dhe ndalim të kreditimit dhe tkurrje të tij, kanë ndikuar ecurinë e sektorit bankar në terma të kapitalizimit. Cilësia e portofolit në këta skenarë vijon të reflektojë, krahas pastrimit të bilancit, edhe prurjet e reja të kredive me probleme për shkak të supozimeve të pafavorshme. Rrjedhimisht, performanca e portofolit të kredisë paraqitet e përkeqësuar deri në fund të vitit 2019, ku raporti i kredive me probleme rritet me 17.0 pikë përqindje (skenari i moderuar) dhe 21.6 pikë përqindjeje (skenari i rënduar) ndaj nivelit të skenarit bazë. Skenarët e përkeqësuar, në vijim të uljes së cilësisë së kredisë, supozojnë edhe goditje në terma të rrezikut të tregut: rrezikut të normës së interesit, rrezikut të riçmimit të letrave me vlerë, rrezikut të kursit të këmbimit, si dhe atij operacional.

(113) Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit tregojnë se:

a. *Në skenarin bazë*, Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (RMK) të sektorit vjen në rritje, duke regjistruar vlerën prej 17.8% në fund të vitit 2019. Ky zhvillim reflekton përmirësimin e performancës financiare - si

rezultat i rritjes ekonomike, përshpejtimit të kreditimit, - uljen e mëtejshme të kredive me probleme, si edhe ecurinë më të favorshme të kursit të këmbimit. Edhe zhvillimet sipas grupeve bankare dëshmojnë për një ecuri të qëndrueshme të niveleve të tyre të kapitalit.

b. *Në skenarin e moderuar*, RMK-ja e sektorit arrin në nivelin 12.4% në fund të vitit 2018 dhe bie në 10.4% në fund të vitit 2019. Kjo ecuri ndikohet nga supozimet për një ritëm ndjeshëm më të ulët të rritjes ekonomike, ndalimit të kreditimit, rritjes së normave të interesit dhe zhvlerësimit të kursit të këmbimit të lekut. Bazuar edhe në supozimet e mësipërme dhe rezultatet e përftuara, zhvillimet në banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali. Konkretisht, numri i bankave që paraqiten të nënkapitalizuara deri në fund të vitit 2019 është 8 dhe aktivet e tyre përbëjnë rreth gjysmën e aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë arrijnë deri në 19.4 miliardë lekë deri në fund të vitit 2019.

c. *Në skenarin e rënduar*, RMK-ja e sektorit ulet edhe më tej, nën minimumin rregullator të lejuar deri në fund të 2019-ës, në 7.7%. Kjo normë ndikohet nga supozimet për një tkurrje të ekonomisë dhe të kreditimit, rritje e normave të interesit dhe zhvlerësim edhe më i ndjeshëm i monedhës vendase. Nisur nga supozimet tejet të rënduara që përmban skenari, numri i bankave që bien në nënkapitalizim tashmë ngjitet në 10. Aktivet e tyre zënë rreth 80% të aktiveve të sektorit. Zhvillimet makroekonomike ekstreme që përmban skenari ndikojnë në përkeqësimin e ndjeshëm të cilësisë së kredisë, në nivelin e humbjeve në portofolin e letrave me vlerë dhe në rritjen e ekspozimit ndaj rrezikut të tregut dhe atij operacional.

Grafik 9.2 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve të provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht rezultateve të mësipërme, të cilat gjithsesi mbeten supozime, aftësia paguese e sektorit bankar në vend, si dhe kapitalizimi i tij vlerësohen në nivele të mira. Në këtë prizëm, vlen të theksohet fakti se gjatë vitit 2017 kapitali i paguar i sektorit u rrit me rreth 5.3 miliardë lekë dhe treguesit e vjetorizuar të përfitueshmërisë (RoA dhe RoE) janë në nivelet më të larta që nga fundi i vitit 2007.

HAPËSIRË INFORMUESE 9.1 EKSPOZIMI I BANKAVE NDAJ RREZIKUT QË LIDHET ME PRONAT E MARRA NË PRONËSI NË PËRFUNDIM TË PROCESIT PËRKATËS LIGJOR

Procesi i administrimit të kredive me probleme ka përballur bankat me një numër relativisht të lartë rastesh ekzekutimi të kolateraleve dhe marrjeje në pronësi të tyre në përfundim të procesit përkatës ligjor. Për më tepër, rreziku i lidhur me "ekzekutimin e kolateraleve" identifikohet edhe si rreziku më i rëndësishëm aktual edhe nga rezultatet më të fundit të vrojtimit të "Perceptimit të rrezikut sistemik nga industria bankare". Nga pikëpamja e stabilitetit financiar është e rëndësishme të vlerësohet ndikimi që ka mbajtja në bilanc e këtyre kolateraleve në terma të kapitalizimit dhe përfitueshmërisë së veprimtarisë bankare. Kjo, pasi një rënie e çmimit të pasurive të paluajtshme - gjatë periudhës së mbajtjes në bilanc – zvogëlon jo vetëm vlerën e aktivit në bilanc, por edhe të ardhurat që mund të realizohen nga shitja e kolateraleve. Njëkohësisht, një shitje në masë e këtyre kolateraleve nga ana e bankave mund të ushtrojë presion për rënien e çmimeve në tregun e pasurive të paluajtshme. Kjo e fundit ndikon jo vetëm mbi të ardhurat e bankës, por edhe mbi vlerën e pasurive të paluajtshme të pranuara si burim dytësor garancie gjatë procesit kredidhënës, me pasoja në cilësinë e portofolit të kredisë dhe kapitalizimin e sektorit.

Në Shqipëri, deri në vitin 2008, vlerat e pronave të marra në pronësi si ndaj totalit të aktivit të bilancit, ashtu edhe ndaj kapitalit rregullator ishin në nivele të papërfillshme. Gjatë pesëvjeçarit 2012-2017, kur cilësia e kredisë shënoi rënie të ndjeshme, portofoli i këtyre pronave rritet në mënyrë të vazhdueshme, duke shënuar në fund të vitit 2017 rreth 2.1% të totalit të aktivit të sektorit bankar dhe 21.3% të kapitalit rregullator. Tabloja e mësipërme evidenton edhe një herë rëndësinë e monitorimit të këtij fenomeni në kuadër të shëndetit të bankave individuale dhe të sektorit bankar në tërësi.

Bazuar në sa më lart, zhvillimet e viteve të fundit në kuadër të ekzekutimit të kolateralit dhe rrezikut që buron nga akumulimi i tyre në bilanc, adresohen me anë të një skenari shtesë: "Skenari i pasurive të paluajtshme". Në këtë skenar supozimet mbi rritjen ekonomike, kursin e këmbimit, normën e interesit dhe rritjen e kredisë janë të njëjta me ato të skenarit bazë. Por, ndryshe nga ky i fundit, është bërë supozimi se në rast të një shitjeje të menjëhershme të këtyre pronave, sektori do të përjetonte një humbje përgjatë dy viteve të ardhshme, që përllogaritet përkatësisht në 30% dhe 70% të vlerës me të cilën mbahen në bilanc në dhjetor të vitit 2017.*

Grafik 9.3 Ecuria e zërit në aktiv të sektorit bankar që lidhet me pronat e përfituara me proces ligjor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 9.4 Pronë e përfituar me proces ligjor ndaj totalit të aktiveve (majtas) dhe ndaj kapitalit rregullator (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rezultatet tregojnë që ndonëse sektori mbetet i mirëkapitalizuar dhe me fitim në nivel agregat për të dy vitet, në terma të përfitueshmërisë, banka të veçanta pësojnë ulje të rezultatit financiar neto deri në humbje. Më konkretisht, numri i bankave që preken është deri në 6 dhe këto banka përbëjnë 18.3% të aktiveve të sektorit bankar. Pavarësisht kësaj, në këtë skenar për vitin e parë dhe të dytë, vlera e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit arrin në nivele prej përkatësisht 16.3% dhe 18.0%, pra ndjeshëm mbi minimumin e kërkuar rregullator.

* *Vlerat prej 30% dhe 70% humbje përkatësisht për secilin vit të skenarit, janë përcaktuar duke pasur parasysh nivelin minimal të stresit, ku të paktën një bankë do të pësonte humbje në terma të rezultatit financiar, duke prekur rrjedhimisht dhe kapitalizimin e saj.*

HAPËSIRË INFORMUESE 9.2 NDJESHMËRIA E SEKTORIT BANKAR NDAJ LËVIZJEVE NË NORMËN E INTERESIT

Ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj luhatshmërisë së normave të interesit matet kryesisht nëpërmjet ndikimit që lëvizjet e normës së interesit kanë mbi të ardhurat neto nga interesi dhe të ardhurat nga rivlerësimi i titujve.*

Ndjeshmëria e të ardhurave neto nga interesi, analizohet sipas dy skenarëve: Skenari 1 ku normat e interesit rriten njëtrajtësisht gjatë secilit vit të ushtrimit kundrejt normave aktuale, me 1 pikë përqindje çdo vit dhe, Skenari 2, ku normat e interesit vijojnë të mbeten në rënie, edhe pse të lehtë ndaj vlerave faktike të vitit 2017 (0.1-0.2 pikë përqindje).

Për të analizuar efektin që ka një rritje e normave të interesit sipas dy skenarëve të mësipërm, duhet të mbajmë parasysh strukturën e bilancit të sektorit bankar. Më konkretisht, struktura e sektorit bankar në vend regjistron një hendek pozitiv mes aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit me maturim deri në 12 muaj, duke dëshmuar për një ndjeshmëri të shtuar të sektorit ndaj strukturës së aktivit në rastin e një rritjeje të normave të interesit. Kjo pasi, për të njëjtin ndryshim në normën e interesit, aktivi i bilancit do të riçmohet më shumë se pasivi, duke ndikuar

në rritjen e të ardhurave neto nga interesi. Në rastin e rënies së normës së interesit, ndodh e kundërta. Të dhënat faktike tregojnë që në dhjetor të vitit 2017 rezulton një hendek pozitiv prej 552 miliardë lekësh dhe pesha e aktivit që riçmohet brenda një viti është e konsiderueshme (96% e totalit) dhe më e lartë se ajo e pasivit (64%).

Grafik 9.5 Vlerësimi i të ardhurave neto nga interesi për sektorin bankar, sipas skenarëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në skenarin 1, ku normat e interesit supozohet se rriten njëtrajtësisht përgjatë harkut kohor dyvjeçar të ushtrimit, përkatësisht me 1 pikë përqindje, të ardhurat neto nga interesi rriten maksimalisht me 6.1 miliardë lekë deri në fund të vitit 2019, ndaj nivelit 44.2 miliardë lekë që shënonin në dhjetor të vitit 2017. Në skenarin 2, ku normat e interesit fillojnë të bien lehtësisht, të ardhurat neto nga interesi ngushtohen maksimalisht me 2.8 miliardë lekë në fund të vitit 2019, ndaj nivelit të vitit 2017.

*Por lidhja e zhdrejtë mes lëvizjes së normës së interesit dhe vlerës së titullit, sugjeron që rritja e supozuar e normave të interesit ndikon negativisht dhe në terma të rivlerësimit të portofolit të titujve që mban sektori bankar, dhe anasjelltas. Në këtë rast, duke konsideruar të pandryshueshëm të gjithë portofolin e titujve të mbajtur deri në maturim dhe të vlefshëm për shitje në fund të 2017-ës, humbja nga rivlerësimi i titujve për shkak të rritjes së normës së interesit me 1% në vit, vlerësohet maksimalisht në 15 miliardë lekë deri në fund të vitit 2019. Në rastin e rënies së supozuar të normës së interesit në këtë ushtrim, ndryshimi në vlerën e rivlerësuar të titujve, është pozitiv dhe arrin në rreth 13.3 miliardë lekë deri në fund të vitit 2019. Në të dy skenarët e supozuar, vlen të theksohet fakti se humbjet/fitimi maksimal përbën më pak se 0.5% të vlerës totale të portofolit në tituj të sektorit bankar në dhjetor të vitit 2017**.*

Nga krahasimi mes dy skenarëve të mësipërm, mund të thuhet se ndikimi që ka rritja/rënia e mundshme e normave të interesit në rezultatin financiar dhe rrjedhimisht në treguesit e kapitalizimit të sektorit bankar, duket aktualisht e administrueshme, por sidoqoftë ka nevojë të vlerësohet me kujdes dhe në vijimësi nga vetë sektori.

* *Për efekt të analizës së ndjeshmërisë, çdo efekt i tërthortë negativ i rritjes së normës së interesit që lidhet, p.sh., me rënien e cilësisë së kredisë, nuk është konsideruar.*

** *Vlera aktuale e portofolit të titujve të sektorit bankar në dhjetor 2017 është 414,477 miliardë lekë.*

9.2 PROVA E REZISTENCËS SË LIKUIDITETIT

(114) Prova e rezistencës së likuiditetit ka për qëllim të vlerësojë aftësinë e bankave individuale dhe sektorit bankar në përgjithësi për t'iu bërë ballë goditjeve ekstreme, por të mundshme në financimin e veprimtarisë së tyre. Këto prova synojnë të evidentojnë dobësi apo mangësi të sektorit dhe bankave të veçanta në monedha, instrumente dhe horizonte të caktuara kohore; të vlerësojnë gatishmërinë e bankave për të përballuar skenarë ekstremë të mungesës së likuiditetit; si edhe të ndihmojnë autoritetin mbikëqyrës për ndërmarrjen e politikave të posaçme që adresojnë menaxhimin e likuiditetit, duke përfshirë masat që synojnë uljen e ekspozimeve ose krijimin e rezervave specifike.

(115) Prova e rezistencës së likuiditetit realizohet sipas përqasjes "nga lart – poshtë" me të dhëna të raportuara nga bankat dy herë në vit (çdo muaj maj dhe nëntor). Ushtrimi përdor të dhëna mbi flukset e parashikuara hyrëse dhe dalëse të parasë sipas instrumenteve kryesore dhe për një horizont kohor të përbërë nga 8 shporta maturimi që mbulojnë intervalin nga "deri në 1 ditë" deri në "mbi 1 dhe deri në 2 vjet". Prova kryhet për monedhat Lek, Euro dhe USD dhe mbështetet në kushtin që tepricat e likuiditetit në një monedhë nuk mund të përdoren për të plotësuar mungesën e likuiditetit në monedhat e tjera, për shkak të probabilitetit të zhvlerësimit të shpejtë të kursit të këmbimit gjatë krizave të likuiditetit.

(116) Për llogaritjen e hendekut të likuiditetit përdoren koeficientë të përcaktuar për tërheqjet e burimeve të financimit (të depozitave) dhe për riinvestimin e aktiveve (kredive) sipas të gjitha shportave të maturimit. Për burimet e financimit, koeficienti tregon vetëm atë pjesë të shumës së detyrimeve që maturohet në shportën përkatëse, e cila do të tërhiqet dhe nuk do të riinvestohet nga klienti. Për hyrjet e parasë, koeficientët e riinvestimit nënkuptojnë atë pjesë të shumës së të drejtave që maturohet në shportën përkatëse, e cila do të konvertohet në fluks hyrës parash dhe nuk do të riinvestohet nga banka.

(117) Një bankë konsiderohet se dështon në ushtrimin e provës së rezistencës vetëm nëse aktivet likuide të zgjeruara, që shiten me marzhe reduktuese të përcaktuara nga ushtrimi, bien deri në nivelin ku ka nevojë për likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë në formën e "kredisë për mbështetje me likuiditet".

(118) Rezultatet e ushtrimit tregojnë se sektori bankar e kalon përgjithësisht me sukses provën e rezistencës së likuiditetit dhe gjendja e likuiditetit e reflektuar në rritjen e hyrjeve dhe tkurrjen e daljeve të pritura deri në fund të horizontit dyvjeçar është përmirësuar në krahasim me një gjashtëmujor më parë. Skenari që supozon përdorimin e aktiveve likuide të zgjeruara për të mbyllur hendekun e likuiditetit, tregon se për monedhën Lek, ka 2 banka që nuk arrijnë ta mbyllin hendekun deri në intervalin 6 muaj dhe 3 banka që nuk arrijnë të mbyllin hendekun deri në fund të horizontit 2-vjeçar. Për monedhën Euro, numri i

bankave që nuk e kalojnë provën për shporta të ndryshme varion nga 1 në 3, por hendeku i likuiditetit në raport me aktivet e sektorit në Euro është shumë i vogël, ndërsa për monedhën USD, hendeku mbetet negativ për 1 bankë për disa nga shportat e maturimit.

(119) Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, duke iu referuar numrit të bankave që nuk e kalojnë provën, vërehet një rritje e numrit të tyre për monedhat Lek dhe Euro dhe një situatë pothuajse e njëjtë për monedhën USD. Pavarësisht se numri i bankave që vijojnë të regjistrojnë hendek negativ likuiditeti është rritur lehtë[67], madhësia e hendekut të likuiditetit në raport me aktivet e sektorit bankar në secilën monedhë, është mjaft e vogël.

(120) Vlen të theksohet se hendeku i thjeshtë i likuiditetit ose diferenca negative midis hyrjeve dhe daljeve të pritshme të parasë për të tre monedhat ka shënuar tkurrje të ndjeshme në krahasim me një gjashtëmujor më parë për shkak të rritjes në flukset hyrëse në secilën monedhë. Në të njëjtën kohë, flukset e pritshme dalëse për monedhat USD dhe Euro pritet të mos ndryshojnë, ndërkohë që flukset dalëse për monedhën Lek sipas bankave do të jenë më të ulëta. Në të njëjtën kohë, nga ushtrimi rezulton se gjendja e kapaciteteve kundërpeshuese (aktivet likuide të zgjeruara) të sektorit bankar ka mbetur pothuajse e pandryshuar për monedhat Lek dhe Euro dhe ka shënuar një përmirësim të lehtë për monedhën USD.

[67] *Ky rezultat është i ndjeshëm edhe ndaj numrit të bankave pjesëmarrëse në ushtrim, i cili mund të ndryshojë me 1 ose 2 banka nga periudha në periudhë.*

ANEKS I

Tabelë 1. Treguesit e shëndetit financiar

në përqindje	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Treguesit me bazë kapitalin											
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	17.08	17.23	16.17	15.40	15.56	16.17	17.96	16.84	15.72	16.01	16.60
Kapitali i nivelit të parë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	16.01	16.31	15.27	14.52	14.30	14.57	14.88	13.79	13.45	14.10	15.12
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.62	8.57	9.57	9.40	8.69	8.57	8.37	8.58	9.53	9.73	10.17
Cilësia e aktiveve											
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	10.05	21.74	28.24	35.95	52.01	55.62	40.22	38.25	24.28	23.08	15.72
Huatë me probleme (bruto) ndaj huave totale	3.36	6.64	10.48	13.96	18.77	22.49	23.49	22.80	18.22	18.27	13.23
Përfitueshmëria											
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore)	20.74	11.35	4.58	7.58	0.76	3.78	6.43	10.53	13.16	7.15	15.71
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore)	1.57	0.91	0.42	0.72	0.07	0.33	0.54	0.89	1.20	0.69	1.54
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit											
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	1.69	4.30	3.89	5.03	3.94	3.98	4.08	8.49	7.66	7.03	6.68
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit të nivelit të parë	1.80	4.54	4.12	5.33	4.29	4.41	4.92	10.37	8.95	8.00	7.34
Treguesit me bazë aktivet											
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	49.77	42.83	27.65	25.95	26.53	29.37	27.64	31.94	32.26	31.29	30.22
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	73.96	64.86	32.58	30.62	33.15	36.71	34.71	40.36	41.43	40.57	40.79
Depozita të klientëve ndaj totalit të huave	215.45	162.60	154.32	166.39	163.20	171.62	180.83	180.16	187.78	192.84	194.00

Burimi: Banka e Shqipërisë.